

DOSSIER

“Princeshat Zogolli” s’donin pranë gratë e bukura

▶ FAQE 16-17



4 SKENARË PËR STATUSIN

BE: HOLANDA JOSH GJERMANINE TE THOTE “JO!”

▶ FAQE 5



BUXHETI 2014

Cani: Negociata me FMN-BB për 1 miliardë dollarë në 3 vjet

▶ FAQE 2-3

[SHQIPTARJA.com]

LEKË 30

VITI III - NR. 298 - E MARTË - 17-12-2013

NA NDIQNI EDHE ONLINE
www.shqiptarja.com
...origjina e lajmit...

EKSKLUZIVE

“Hipnotizuesi” plak kreu krimin më makabër të viteve të fundit. Aktualisht vuan dënim me 25 vjet, pasi pranoi fajin

SHABAN NORJA

RREFIMI I MONSTRES SE SHIJAKUT



I preu kokën me sëpatë 17-vjeçares, pasi e qëlloi me pistoletë. 81-vjeçari tregon si u afrua me familjarët e viktimës

▶ NE FAQE 11

Editorial

Paratë e spoteve duhet të kthehen: Janë të invalidëve

Që kur letrat e abuzimeve, të bëra për tetë vite qeverisjeje të Qeverisë së Sali Berishës, janë mbi tryezat e pasardhësve të tyre, Prokuroria...

▶ vijon në faqen 20

Satirë politike



NGA ARBEN DUKA

Në ç’përmasa e kemi sot krizën ekonomike?!

(Pjesa e Parë)

Kuptohet që kriza, nuk ndodh në një ditë, atë sot e kemi, peshqesh nga Salitë...

▶ vijon në faqen 21

bashkë me rubrikën “VIP-a dhe Ripa”

Koment



NGA MIRELA BOGDANI*)

Statusi: Një ‘5’ nga Brukseli?

Sot pritet vendimi i Këshillit të Ministrave europianë per statusin kandidat per Shqiperine, i refuzuar tri here. Jo vetem ne historine e vendeve simotra te Ballkanit Perendimor, po dhe...

▶ vijon në faqen 20

GRUPI I PD

Majlinda Bregu qahet për taksat e reja që do paguajë

▶ FAQE 6

KORRUPSIONI

Imamin e “merr” Prokuroria e Tiranës, zhvishen nëntë policë

▶ FAQE 7

NERANXI 1995
... gjithmonë një hap përpara...
Lëndë të para për restorante, piceri, kreperi dhe fast food.



NDËRTIMET PA LEJE

Rama: Shembjet do të pastrojnë bregun deri në Ksamil

▶ FAQE 4

Cyan magenta yellow black

» FINANCAT

TË GJITHË *sektorët kryesorë pësojnë rritje në shifra nominale shpenzimesh, ulet fondi për Mbrojtjen*

Buxheti 2014, fokusi mbi ndihmën sociale e mjedisin

Hiqet TVSH-ja për barnat në prill të vitit të ardhshëm

Ilir Sinanaj
TIRANE

Dje në mbledhjen e kryetarëve të Kuvendit, Ministri i Financave, Shkëlqim Cani, prezantoi buxhetin e vitit 2014. Në fjalën e tij kreu i Financave, u shpreh se "në përgatitjen e buxhetit të ri nuk presim mrekulli, por presim realizëm, disiplinë të fortë fiskale dhe buxhetore, ndryshim mentaliteti në përdorimin e fondeve publike, përgjegjësi dhe transparencë". Ky buxhet ka mbështetjen e plotë të institucioneve finaciare si FMN-ja dh BB-ja, gjë që e bën atë më të sigurtë për të garantuar stabilitetin makroekonomik, si edhe një zhvillim të qendrueshëm. Në bazë të këtij buxheti parashikohen 364 miliardë lekë të ardhura dhe 456 miliardë shpenzime, duke e bërë këtë, buxhetin me shpenzimet më të mëdha në histori, ku 1/4 e tij financohet nga borxhi. Ndërkaq kjo skemë parashikon një dimension social, ku në thelb janë ndihma sociale dhe mjedisi, zëra këto që kanë rritjen më të mëdha të fondeve të krahasuara me buxhetin e vitin 2013. Për zërin "Mbrojta e Mjedisit", në buxhetin e vitit 2014, prashikohet një fond prej 1.5 miliardë



lekë ose 7.6 milionë lekë më shumë se në buxhetin e kaluar. Për zërin "Mbrojten sociale" parashikohen të vihen në dispozicion 127 miliardë lekë ose 8.4 miliardë lekë më shumë se sa në vitin 2013. Gjithashtu një nga prioritetet e këtij buxheti është edhe shlyerja e borxheve ndaj sipërmarrjeve, i cili është një zë i ri për sa i përket hartimeve të buxheteve të viteve të mëparshem, i cili është 35 miliardë lekë. Pritet që borxhet të shlyhen menjëherë sa të fillojë viti 2014.

SHËNDETËSI

Në buxhetin e vitit 2014, për skemën e sigurimeve shëndetësore parshikohet një fond prej 32.9 miliardë lekësh. Sipas të dhënave pritet që skema aktuale e sigurimit shëndetësor të rritet me 3%. Në logaritje është marrë parasysh edhe zbritja e TVSH-së në masën 30% për barnat, e cila do të eliminohet duke filluar nga data 1 prill 2014. Ndër të tjera, fondi prej 1.5 miliardë lekë është vënë në dispozicion për mundësuar shërbime prioritare si furnizim më të mirë me barna për shërbimin e kardiologjisë dhe onkologjisë, si edhe diagnostikimin falas për grup moshën 40-65 vjeçare. Të gjitha këto priten të zbatohen në vitin 2014, duke përmbushur kështu premtimet e Qverisë aktuale.



Detyrimet
Gjithashtu një nga prioritetet e këtij buxheti është edhe shlyerja e borxheve ndaj sipërmarrjeve, i cili është një zë i ri...

SEKTORËT DHE SHPENZIMET E KRAHASUARA

Kategoria	2014	2013	Ndryshimi PB2014-B2013	PB2014	B2013	Ndryshimi PB2014-B2013
Mbrojtja e Mjedisit	1,511,762	752,000	759,762	0.33%	0.18%	0.15%
Argëtimi, Kultura dhe Çështjet Fetare	2,127,500	2,295,625	-168,125	0.46%	0.56%	-0.10%
Mbrojtja	12,211,000	12,464,500	-253,500	2.66%	3.04%	-0.39%
Rendi dhe Siguria Publike	22,540,309	21,965,150	575,159	4.61%	5.51%	-0.90%
Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit	21,180,137	22,563,929	-1,383,792	4.90%	5.36%	-0.46%
Shërbimet e Përgjithshme Publike	26,433,712	23,664,658	2,769,054	5.75%	5.78%	-0.03%
Shëndetësia	38,708,500	37,032,140	1,676,360	7.92%	9.87%	-1.95%
Arsimi	40,041,550	39,093,100	948,450	8.42%	9.04%	-0.62%
Çështjet Ekonomike	36,386,411	40,414,564	-4,028,153	8.71%	9.54%	-0.83%
Shpenzime të tjera të paklasifikuara	131,355,000	90,638,600	40,716,400	27.65%	28.98%	-1.33%
Mbrojtja Sociale	127,069,640	118,709,690	8,359,950	28.58%	22.13%	6.45%

Negociatat, Cani: FMN-BB, 1 mld dollarë në 3 vite

Kreu i Financave hodhi poshtë faktin se gjendja ekonomike ishte e ngjashme me Greqinë

Në A1Report
TIRANE

Megjithë gjëndjen e rënduar finaciare të vendit, Ministri i Financave, Shkëlqim Cani nënvizoi faktin se Shqipëria nuk është në të njëjtën situatë si Greqia, ndërsa u pyet nëse do të kishte masa shtrënguese që do të ndërmerreshin, dhe kështu nuk mund të flitej për austeritet apo masa shtrënguese. Kreu i Financave ishte i ftuar në emisioni "5 Pyetje nga Babaromo", ku foli për marrëdhëniet me FMN-në dhe BB-në, borxhin publik dhe strategjinë që prashikonte hartimi i buxhetit te vitit 2014, për të rimëkëmbur ekonominë. Për sa i përket institucioneve finaciare të FMN-së dhe BB-së, ministri Cani theksoi se ndihma që i nevojitej Shqipërisë nga këto institucione nuk ishte vetëm ekonomike, por edhe morale. Ai e argumentoi këtë, duke thënë se mbështetja e këtyre institucioneve finacire do të rriste besimin për ecurinë ekonomike në Shqipëri përpara investotorëve dhe institucioneve finaciare ndërkombëtare. Në lidhje me borxhin, ministri Cani nuk e fshehu faktin e gjëndjes jo të favorshme të ekonomisë shqiptare, por shprehu bindje dhe besim se do të ndërmerreshin masa për ta menaxhuar atë duke bashkëpunuar me partenrët ndërkombëtar. Kreu i Financave tha se aktualisht po negociohej me FMN-në për marrjen e një borxhi për gjatë një periudhe 3 vjeçare, që do të kapte shifrën e



Shkëlqim Cani

900 deri në 1 miliardë dollarë. Ai theksoi faktin se Qeveria kishte kontaktuar herët me FMN-në dhe kjo kishte bërë që situatë të mos degradonte deri në nivelet e Greqisë. Ministri i Financave, Shkëlqim Cani, nëvizoi faktin se buxheti i vitit 2014 është konceptuar që të rimëkëmbë ekonominë jo duke marrë masa shtrënguese, por duke nxitur veprimtarinë sipërmarrëse. Ai tha se shqiptarët duhet të jenë optimistë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS:

"Dua më shumë fonde, s'jemi konsultuar"

Presidenti i Republikës kërkon më shumë fonde për vitin 2014 se sa i janë akorduar në buxhetin e dorëzuar nga qeveria në Kuvend. Kjo kërkesë është bërë publike me një letër që ky institucioni i ka nisur Kuvendit të Shqipërisë, konkretisht kreut Ilir Meta dhe krerëve të grupeve parlamentare. Institucioni i Presidentit bën të ditur se, ka qenë i gatshëm për të diskutuar, por ky takim nuk është zhvilluar. Sipas Presidencës, "deri në ditën e sotme, pas përcjelljes së propozimeve tona për Ministrinë e Financave për Buxhetin e vitit 2014, nuk kemi marrë asnjë komunikim zyrtar apo shkresor për t'u njohur me tavanet e përcaktuara (alokuara) nga Qeveria Shqiptare për Institucionin e Presidentit të Republikës". Presidenca bën të ditur se, për vitin 2014 për presidencës janë parashikuar 163 milionë lekë, ndërsa në total ky institucion ka kërkuar 203.5 milion lekë. Presidenca thotë se, "duke krahasuar fondet e kërkuara, me fondet e parashikuara vërehet se në shpenzimet e tjera operative, kemi ulje prej 46.8 milion lekë, aërsisht sa gjysma e fondeve të kërkuara zyrtarisht nga Institucioni i Presidentit të Republikës".



SHEMBUJ TË TATIMIT TË PAGAVE TË NDRYSHME SIPAS SISTEMIT TË RI FISKAL

Funksioni	Paga mesatare	Taksa e Sheshtë	Taksa Progresive	Diferenca mujore	Kursimi vjetor	Taksa Efektive
Drejtor ekzekutiv në sektorin privat	300,000	30,000	52,100	22,100	-265,200	17.37%
Drejtor i Përgjithshëm	130,000	13,000	13,000	0	0	10.00%
Drejtor	111,860	11,186	10,642	-544	6,532	9.51%
Mjek	65,102	6,510	4,563	-1,947	23,365	7.01%
Mësues i Shkollës së Mesme	59,780	5,978	3,871	-2,107	25,281	6.48%
Mesues i Shkollës 9-vjeçare	54,750	5,475	3,217	-2,258	27,092	5.88%
Specialistë	54,540	5,454	3,190	-2,264	27,167	5.85%
Infermier i lartë	42,818	4,282	1,666	-2,616	31,387	3.89%
Punonjës mbështetës *(arsim i mesëm ose i ulet)*	36,602	3,660	858	-2,802	33,625	2.34%
sanitar (paga minimale)	30,735	3,074	95	-2,978	35,737	0.31%


Ritje “simbolike” e taksës për 3% e të punësuarve

Janar 2014, 97 për qind e rrogëtarëve më pak tatime

Biznesi i vogël do të paguajë vetëm 7.5% mbi fitimin

Ilir Sinanaj
TIRANE

Ashtu siç e ka bërë të ditur edhe më parë “Shqiptarja.com”, mbi 97% e të punësuarve në Shqipëri do të tatohen më pak me sistemin e ri fiskal, në krahasim me atë aktual me taksën e sheshtë 10%. Rroga deri në 30,000 lekë do të këtë 0% tatim. Të gjithë të punësuarit që kanë rroga mbi 30,000 dhe nën 130,000, do të tatohen vetëm 13% e shumës mbi 30,000. E thënë ndryshe kjo kategori të punësuarish do të tatohen më pak se sa tatohen aktualisht me sistemin e taksës së sheshtë 10%. Më pas të gjitha pagat mbi 130,000 do të taksohen në mënyrë progresive. Tatimi për këtë kategori, sipas sitsemit të ri fiskal, do të jetë 13,000 lekë plus 23 % të shumës mbi 130,000 lekë. Duke marrë parasysh standardin e jetës në vendin tonë dhe çmimet e produkteve në treg, kjo rritje e tatimeve mbetet ”simbolike”, e krahasuar me vende të tjera në Europë. Duke i hyrë statistikave edhe më në detajë 56% e të punësuarve në Shqipëri i përkasin fashës së parë me 0% tatim; mbi 40% e të punësuarve i takojnë fashës së dytë, ku norma efektive e taksës ulet nga 10% në kufijtë 2.4% deri në 9.8%; dhe vetëm më pakse 3% e të punësuarve i përkasin fashës së tretë, të cilëve u rritet norma efektive e taksës.



BIZNESI

Rreth 60 mijë biznese të vogla në Shqipëri duke filluar nga 1 janar 2014, nuk do të paguajnë më taksën e biznesit të vogël, në bazë të zbatimit të paketës së re fiskale. Si rrjedhojë do të shfuqizohet taksa vendore e biznesit të vogël, aktualisht taksë lokale që paguhet nga subjektet me qarkullim vjetor deri në 8 milionë lekë. Efekti negativ në të ardhurat e pushtetit vendor vlerësohet në rreth 2 miliard lekë në vit. Biznesi i vogël me qarkullim vjetor deri në 2 milionë lekë do të paguajë një taksë fikse vjetore prej 25,000 lekë, pavarësisht vendndodhjes. Subjektet e biznesit të vogël (me xhiro vjetore nga 2 në 8 milionë lekë) do të taksohen me 7.5% mbi “fitimin” (mbi të ardhurat e tyre personale) nga 10% aktualisht. Tatim fitimi i pjesës tjetër të biznesit rritet nga 10% në 15. Tatimi prej 10%, në letër më i ulët,argumentohet nga e eksepertwt e hartimit tw buxhetit se në fakt rezulton shumë herë më i lartë. Ky tatim i ulët ka çuar borxhin ndaj biznesit së paku mbi 5% të PBB-së.

AKCIZA

Do të rriten çmimet e produkteve të luksit



— Rritja e tatimeve ka ardhur si një nevojë për të rimëkëmbur financat e vendit dhe ashtu si në çdo vend racional të përballur me një problem të tillë, edhe në Shqipëri parshikohen disa që prekin taksën e akcizës, për disa lloje mallrash të lojit cigare, duhan me të dredhur, pije alkoolike, birra, produkti “graso” etj. Nga rritja e akcizës për duhanin për vitin 2014, parashikohet që në arkën e shtetit të hyjnë 3.5 miliardë lekë të ardhura. Kjo masë ka synon gjithashtu edhe mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve, të cilët përballë çmimeve të lartë të produkteve jo të domosdoshëm, do të kursejnë. Ndërkaq taksa nacionale e qarkullimit do të rritet me 10 lekë për litër. Kjo taksë ka për qëllim, midis të tjerash, edhe mbrojtjen e ambientit.

Debatet në Parlament

Në 28 diskutohet buxheti, Berisha bashkon votën me PS

PD akuzoi dje në Parlament mazhorancën se me këtë projekt-buxhetin e 2014 si dhe Paketën Fiskale po rrënon ekonominë e shqiptarëve. Në fund të seancës, u votua propozimi i kreut të Komisionit të Ekonomisë, Erjon Braçe, i cili kërkoi miratimin e buxhetit në 28 dhjetor.



— **Berisha:** U jepni qytetarëve shqiptarë të paktën dy ditë kohë, ndërkohë që me FMN keni diskutuar dy muaj. Ju po e çoni vendin drejt destabilizimit. Keni marrë një rrevansh që do t`iu kushtojë shumë shtrenjtë. Nuk është kjo që të shumëzoni me zero opozitën.

— **Paloka**: Është shkelur rregullorja edhe në përcaktimin e relatorëve. Keni përcaktuar dy relatorë të PS dhe asnjë për opozitën. Qeveria duke vonuar paraqitjen e buxhetit në Kuvend ka shkelur Rregulloren, duhet ta kishte dorëzuar deri në datën 25 tetor. Argumentet që na u dhanë sot ishte se qeveria kishte takim me FMN.

— **Ruçi:** Është i drejtë pretendimi i opozitës që sivjet buxheti është i vonuar. Mos bëni sikur nuk e dini situatën ekonomike, nuk e sollëm ne, por e gjetëm midis jush. E përzutë FMN në 1996 dhe dihet se ca ndodhi në Shqipëri.



— **Berisha:** Parafolësi foli për buxhetin e vitit 2009 kur ata nuk ndoheshin as në Tiranë dhe jo më në Parlament. Parafolësi mashtroi dhe tha se ne kemi përzënë FMN. Brenda katër muajve me dektretin e gropës aq sa e kishit mbajtur ne në katër vite dhe sillni këtu një buxhet që rrit borxhin tre herë më shumë sesa e kishim rritur ne në katër vite.

— **Bode:** Kjo është unikale nuk ka bërë kurrë vaki që buxheti i shtetit të vijë në mes të dhjetorit. Është i pari buxhet në historinë e Shqipërisë që vjen të miratohet dhe tu thotë shqiptarëve që brenda 1 viti do të marrim 1 miliard borxh.

— **Topalli:** Keni gjetur deficitin shqiptar 450 mln dollarë e keni çuar në 1 mld dollar për katër muaji. Ku po e çoni ekonominë? Ky është buxheti me katastrof që keni sjellë. Ky është skenari grek. Ky është skenari i Papandreut.



AMENDAMENTET

— -Shqyrtimin në parim në 30.12.2013 dhe shqyrtimin në seancë plenare në 13.01.2014. 47 pro, 75 kundër. Bashkon votën me PS-në Omer Mamo i PDIU-së)

— -Shqyrtimi i pr.buxhetit nga komisionet e hershme seancë dëgjimore në komisionet e përhershme në datën 20 dhe 26 dhjetor: 48 pro 74 kundër.

— -Paraqitja e pr.buxhetit nga ministri i Financave në datën 18.12.2013 dhe pyetje mbi të: 74 kundër, 46 pro dhe 1 abestim (Dashamir Shehi).

— -Diskutimi në parim i të ardhurave të buxhetit në 26.12.2013, diskutimi i shpenzimeve në 27 dhjetor, diskutim i deficiti në 28 dhjetor: 48 pro 74 kundër.

— -Seancë dëgjimore me grupet financiare në 3 janar 2014,shqyrtimi i raportit të komisioneve të tjera parlamentare dhe amendamentet e paraqitura nga deputetë në 10 janar: 46 pro, 75 kundër 1 abstenim (Sali Berisha bashkon votën me PS, Dashamir Shehi abstenim)

— -Kalendari i propozuar nga **Braçe (28 dhjetor):** 74 pro dhe 48 kundër.

— **-Berisha:** Votova kundër sepse onstatoj se në panik të madh e në padije të plotë qeveria Rama - Meta përpiqet vetetëmithi ta fshehë. Votova kundër sepse ky buxhet është i vdekur pa lindur fare.

» AKSIONI

KREU *Qeverisë në takim me deputetë, ministra, vendorë tha se s'do lënë okupatorë të detit që bëjnë biznes mbi det. Ai foli për financim të integruar të pushtetit vendor*

Edi Rama: Saranda nuk sheh det, aksioni deri në Butrint

Kryeministri garanton: Pastrimi i bregdetit do vijojë, do zbresë nga Vlora deri në Butrint



Kryeministri Edi Rama në Sarandë

JAKIN MARENA
TIRANE

Aksioni për për "çlirimin" e detit nga ndërtimet pa leje do të shtrihet në tërë bregdetin e rivierës shqiptare, nga Vlora e deri në Butrint. Qeveria shqiptare, pas Vlorës po tregon se e ka marrë seriozisht prishjen e ndërtimeve pa leje, për t'i dhënë bregdetit shqiptar pamjen turistike të një vendi modern mesdhetar dhe që josh turistët. Kështu programi i investimeve në vijën bregdetare të Jugut ka mbledhur në Sarandë kryeministrin Edi Rama, deputetë



Saranda

të qarkut të Vlorës, drejtues vendorë dhe dy ministrat, Eglantina Gjermeni dhe Bledar Çuçi. Në këtë takim u diskutua në lidhje me strategjinë e zhvillimit të turizmit e planifikimin e rregullimit të territorit në zonat bregdetare të detit Jon. Kryeministri Rama theksoi vendosmërinë e qeverisë së tij për të vijuar aksionin e nisur në Vlorë për prishjen e ndërtimeve në bregdet. Tre ditë pas shembjes së kompleksit "Jon" në zonën e Ujit të Ftohtë në Vlorë, kreu i qeverisë tha se aksioni nuk do ndalet, por do zbresë deri në Butrint. Rama vuri theksin në një projekt gjithëpërfshirës në të gjithë vijën bregdetare të Jonit, jo vetëm në Llogara, por projekti të përfshijë dhe parkun e Llogarasë, Orikumin. Kreu i qeverisë nënvizoi se pastrimi i bregdetit nga ndërtimet pa leje do të vazhdojë pa ndërprerje. "Kemi ndërmarrë një aksion që s'do ndalet, pastrimi i bregdetit të Vlorës e krijimi i kushteve për të krijuar një projekt të standardeve më të mira të Mesdheut duke kthyer Vlorën në një portë dinjitoze

FINANCIM EFIKAS

"Nuk do vazhdojmë me traditën e financimeve që e bëjnë copë e thërrime buxhetin modest të shtetit dhe në fund në vend që të prodhojnë zhvillim të qëndrueshmë krijojnë plagë"

të Mesdheut është vetëm një pjesë ndërkohë që aksioni do të zbresë deri në Butrint. Kush ka marrë përsipër të ndërtojë duke marrë peng të ardhmen e fëmijëve të gjithë këtij vendi duhet të paguajë dhe do paguajë. Nuk do të lëmë okupatorë të detit që bëjnë biznes mbi det. I kemi shembujt në mes të Sarandës, pistat të tëra mbi det. Nuk shikon det. Ecën në Sarandë dhe nuk e shikon detin, kthehu majtas e djathtas mure dhe vetëm në të çara sheh det", ka deklaruar Rama. Sipas tij, kush do vijë për të hedhur para nëse nuk do shikojë garanci se mbasi ai investon do dalë një tjetër ta vë murin përpara. "U bë modë që murin ta ngrenë mbi det. Këto janë gjëra që nuk do tolerohen më. Pastrimi është vetëm vendosja e themelit për të ndërtuar e zhvilluar", tha Rama. Kryeministri e vlerësoi Sarandën si zonë prioritare për zhvillimin ekonomik dhe deklaroi se investimet nuk do të bëhen të copëzuara me qëllim që të kemi një zhvillim të qëndrueshëm të zonës së tërë. "Ky është program i parë që konsideron zhvillimin e qëndrueshëm të një zone të tërë, jo të krijuar rastësisht por që për qeverinë shqiptare është prioritare për zhvillimin ekonomik, jo vetëm të njerëzve që jetojnë këtu por mbarë vendit tonë", tha Rama. Ai vlerësoi si të rëndësishëm tejkalimin e kufijve vendore që i hap rrugë një qasje shumë të kërkuar nga vetë burimet e financimit përkatësisht nga donatorët që do të jetë prioritare edhe për qeverinë. "Nuk do të vazhdojmë me traditën e financimeve që e bëjnë copë e thërrime buxhetin modest të shtetit dhe në fund në vend që të prodhojnë zhvillim të qëndrueshmë krijojnë plagë përmes copëzave që nuk janë të lidhura me njëri tjetrin. Financimi copë e cikë nuk a zgjidhur ndonjë problem por ika shtuar", tha Rama. Duke paralajmëruar një zhvillim të integruar të tërë vijës bregdetare shqiptare në funksion të krijimit të kushteve për turizëm.

ITALI

Kodheli, takim në kompaninë FinMeccanica

Ministrja i Mbrojtjes e Shqipërisë, Mimi Kodheli vizitë zyrtare në Itali. Ajo ka qënë dhe në kompaninë italiane FinMeccanica. Kjo kompani është më e madhja e teknologjisë moderne dhe ushtarake në Itali e në të gjithë botën dhe një ndër grupet industriale në nivelin më të lartë botëror në teknologjitë e fundit. Përfaqësues të kësaj kompanie kanë ardhur edhe në Shqipëri, duke vizituar kombinatin metalurgjik të Elbasanit. Ata kanë parë mundësitë që mund të ketë, me qëllim investimimin në vendin tonë. Kodheli ka zhvilluar një takim tjetër edhe në kompaninë Selex.



BRITANIA

"Vlerësim për punën e doganave"

Crown Agents është kompani me integritet dhe me rezultate pune në vende të tjera të rajonit". Këtë qëndrim ka mbajtur ambasadori britanik në Shqipëri, Nicholas Cannon në një takim që ka pasur sot me drejtoreshën e Përgjithshme të Doganave, Elisa Spiropali. Ai shprehu gatishmërinë për bashkëpunim të vazhdueshëm me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Ndërkohë që përgëzoi punën e kryer deri tani nga Administrata e re Doganore duke nënvizuar se "ne vlerësojmë institucionin e doganës si një nga më të rëndësishmit në vend për shkak të punës që kryen dhe peshës që mban aktualisht në sigurimin e tregtisë së ndershme". Drejtoresha e Përgjithshme Spiropali falënderoi Cannon dhe shprehu besimin e saj të plotë për një bashkëpunim të suksesshëm.

Vizita

Rama, në Baku për marrëveshjen e TAP

Firmë me tre kryeministra. Shoqërohet nga ministrat Bushati dhe Gjiknuri

TIRANE

Kryeministri Edi Rama mbërriti mbrëmë vonë në Baku, kryeqytetin e Azerbajxhanit për nënshkrimin e marrëveshjes ndërqeveritare për TAP. Ai shoqërohet në vizitën njëditore nga ministri i Jashtëm Ditmir Bushati dhe ministri i Energjisë dhe Industrisë Damjan Gjiknuri, dhe sot pritet të hedhë firmën në këtë marrëveshje shumë të rëndësishme, bashkë me kryeministrin italian Enrico Letta si dhe atë grek Antonis Samaras që priten të jenë në kryqytetin azer për këtë marrëveshje shumë të rëndësishme si vende nëpër të cilët kalon projekti TAP. Sipas APA-s referuar mediave italiane, kryeministri Letta do marrë pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes ndërqeveritare mbi TAP (Trans Adriatik Pipeline) më 17 dhjetor. Po kjo agjenci bën me dije se zyrtarët e Greqisë dhe të Shqipërisë, vendet e tjera që marrin pjesë në projektin e TAP, do marrin pjesë në ceremoni. Kështu kryeministri Edi Rama pavarësisht se kjo javë dhe më konkretisht dita e sotme është shumë e ngarkuar politikisht, për shkak se jepet dhe vendimi i ministrave të BE për statusin e vendit kandidat për Shqipërinë, ka vendosur që të ndjekë

Firma
"Rama do hedhë firmën në këtë marrëveshje shumë të rëndësishme, bashkë me kryeministrin italian Enrico Letta si dhe atë grek Antonis Samaras që priten të jenë në kryqytetin azer për këtë marrëveshje".



këtë axhendë të fortë ekonomike me një interes të jashtëzakoshëm për vendin. Ende s'është mësuar nëse do ketë takim me presidentin azer Aliev. Më 28 qershor Azerbajxhani njoftoi zgjedhjen e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)për furnizimet e gazit natyror në Evropë. Tubacioni TAP do japë gazin azer për Italinë përmes Turqisë, Greqisë dhe Shqipërisë. Kostoja totale e projektit është rreth 2.2 bilionë dollarë. Sipas parashikimeve, prodhimi në fazën e dytë do fillojë në vitin 2016 dhe Tubacioni TAP do ndërtohet brenda 3 viteve.

Kreu i PLD
TIRANE

Ngjela: Kjo qeveri s'e meriton statusin, s'di të bëjë reforma

Aleati: Refuzimi i Holandës, katastrofë për Shqipërinë

Aleati i PS, kreu i PLD, Spartak Ngjela deklaroi se nuk ka vend për optimizëm për marrjen e statusit të vendit kandidat, sepse kjo qeveri nuk di të bëjë reforma. Në një status në rrjetin social "Facebook", në përgjigje të miqve të tij, Ngjela shkroi se ajo që ai shpreh kundër qeverisë s'është mllef por realitet. "E dëgjove refuzimin e Holandës? Katastrofë për Shqipërinë. Dhe të gjitha, për budallallëkun e kësaj qeverie. S'di të bëjë reforma. Merret me gjëra që s'kanë rëndësi për zhvillimin e demokracinë shqiptare. Për çfarë optimizmi duhet folur, për kalamajtë e Ramës?", shkroi Ngjela, në një prej statuseve të tij në rrjetin social. Më tej, ai jep edhe mendimin e tij, për ato që qeveria pret nga marrëveshja me FMN-në dhe Bankën Botërore. "FMN nuk do të thotë folklor, por Amerikë. Asnjë grosh nuk do t'i japë FMN e Banka Botërore kësaj qeverie. Por, ja që këtë gjë në Tiranë sot, se çfarë janë FMN-ja dhe Banka Botërore, e dinë edhe taksistët; natyrisht folk janë ata, populli i thjeshtë, por kaq gjë e dinë të gjithë" tha Ngjela në lidhje me përgatitjen e mbështetjen që kërkohet nga qeveria për projektbuxhetin e 2014. "Dhe status, para do thotë. Kujt t'ia japë paratë Holanda apo Gjermania? T'ia japë një qeverie që ka 4 muaj që vërtitet dhe bën sikur, për reformat për të luftuar megavjedhjen në domenin Berisha? T'ua japë ca kalamajve që nuk dinë asgjë nga financat? Apo t'ia japë një kryeministri që i kërkon vetë armët kimike, e fut politikën amerikane në një rrjedhë qesharake e pastaj i thotë që 's'më lejon populli'? Pse këta pret ti që të europianizojnë Shqipërinë? Jo mo, këta mirë janë..., le të rrinë në Orient... Por shqiptarët janë të pafajshëm dhe pa fat në këto kohë moderne...", ka deklaruar Ngjela.


Spartak Ngjela

AVOKATI
"Dhe status, para do thotë. Kujt t'ia japë paratë Holanda apo Gjermania?

Integrimi
JAKIN MARENA
TIRANE

Holanda kundër, lobim sekret në Gjermani: Mos na lini vetëm

Shqipëria, 4 skenarët e BE-së për statusin

Zbardhet skema, ja vendet pro e 4 të lëkundura

Dhënia e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë kalon përmes katër skenarëve. Skenari i parë është që ministrat e jashtëm të BE të vendosin sot pro dhënies së statusit të vendit kandidat për Shqipërinë. Nëse jo skenari i dytë: Vendimi i kryeministrave të BE 3 ditë më pas, më 20 dhjetor përmbys vendimin e shefave të diplomacisë dhe vendos pro Shqipërisë. Varianti i tretë është një vendim pro statusit në mars të vitit 2014 kur zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Ministrave të BE dhe varianti i katërt në dhjetor të vitit 2014. Ndërkohë që Holanda duket e vendosur në qëndrimin e saj kundër dhënies së statusit të vendit kandidat nga BE për Shqipërinë. Dhe jo se e ka zënë me Shqipërinë, është në tërësi kundër zgjerimit të BE, madje dhe kundër përfshirjes së Rumanisë e Bullgarisë në sistemin "shengën" ku pritet të vendosë veton. Kryesorja në këtë qëndrim të Holandës kundër Shqipërisë për statusin janë dhe problemet e brendshme politike, pasi së afërmi ka zgjedhje me kartën e moszgjerimit të BE. Dhe Holanda po lobon fort tek vendet e lëkundura, konkretisht ka bisedime të fshehta me Gjermaninë që të bashkohet me të në votën kundër sot, në mënyrë që ajo mos jetë "delja e zezë" e Evropës. Mësohet se janë dhe tre vende të tjera skeptike bashkë me Gjermaninë, dhe konkretisht Britania, Danimarka dhe Franca. Nga ana tjetër pro janë gati të gjithë vendet e tjera të BE, madje Kryediplomatët e 8 shteteve, Italisë, Austrisë , Bullgarisë, Kroacisë, Estonisë, Hungarisë, Irlandës e Sllovenisë shprehen të bindur se Shqipëria i ka plotësuar gjithë kushtet e vendosura nga BE e i kanë dërguar letër Ashton, dhe Lituanisë si presidente e radhës që Shqipërisë ti jepet sot statusi. Ndërkohë mbrëmë është zhvilluar mbledhja e Këshillit të Ministrave të Jashtëm në Bruksel. Pas një mbledhjeje të gjatë, që ka zgjatur rreth dhjetë orë, ku temë diskutimi është parathënë ka qenë edhe Shqipëria, shefja e Politikës së Jashtme të KE, Catherine Ashton në konferencën për shtyp s'tha asgjë konkrete për Shqipërinë. Por Ministri i Jashtëm sllloven, Karl Erjavec tha se ka vënë re se dhe kryediplomatja e BE, Ashton është pro dhënies së statusit. "Të gjithë ministrat e Jashtëm me të cilët kam biseduar mbështesin kandidaturën e Shqipërisë. Vura re se dhe zonja Ashton mbështet statusin për Shqipërinë", tha Erjavec. Edhe zv.kryeministrja kroate, Vesna Pusniç, argumentoi se pavarësisht hezitimit nga disa shtete të rëndësishme anëtare, pjesa dërrmuese e BE e mbështet kandidaturën e Shqipërisë.

SATATUSI KANDIDAT

VENDET LOBUESE PRO
- Italia
- Austria
- Bullgaria
- Kroacia
- Estonia
- Hungaria
- Irlanda
- Sllovenia

VENDET SKEPTIKE
- Gjermania
- Britania
- Damiarka
- Franca

VEND KUNDËR
- Holanda

BONINO:

"Armët kimike siriane në Itali"



— Ministrja e jashtme italiane, Emma Bonino, ka konfirmuar dje në Bruksel, gadishmërinë e Italisë për të pritur në një port të saj, në janar, anijen daneze, që do transportojë armët kimike siriane e do shoqërohen nga forca norvegjeze. Ajo saktësoi se zgjedhja e vendit do bëhet pas një vlerësimi teknik që do bëjë ONAK, që do vlerësojë zonat e peshkimit, madhësinë e Portit e largësinë apo afërsinë me qendrat e banuara. Sipas Boninos, ONAK ka konfirmuar disponueshmërinë, për t`i paraqitur Parlamentit Italian kushtet teknike që do përdoren për aktivitetin që do të nisë në muajin janar. Ajo tha se sipas KS, armët kimike duhet të largohen nga territori sirian, brenda 31 dhjetorit. Sipas Boninos mund të pritet mbërritja në portin italian mes muajit janar. Pas mbërritjes në Itali, armët kimike siriane do të transferohen në anijen amerikane Cape Ray ku edhe do të nisë shkatërrimi i tyre.

Mediat: Shqipëria e meriton statusin në BE

Shkruajnë EuObserver e Financial Times për shanset e Shqipërisë për statusin

Në një nga programet e BBC Kate Holman i EuObserver e gjente të vështirë të besonte se Ukraina mund të pëlqejë akoma anëtarësimin në BE. Ka një tjetër vend më afër shtëpisë, ku 87% e popullsisë duan anëtarësimin e kanë bërë që tani shumë përpjekje për ta marrë: Shqipëria. Liderët e BE do vendosin këtë javë nëse do i japin statusin e kandidatit Shqipërisë. Pas dy refuzimeve më 2010 e 2011, KE ofroi për herë të parë një tentativë aprovimi më 2012, me kushte. Zgjedhjet e verës më në fund plotësuan standardet që vendosin PS e Edi Ramës në pushtet duke gjeneruar një ndjesi të vërtetë se diçka kishte ndryshuar, një ndjenjë shprese. Dhe gjatë 12 muajve të fundit, gjërat kanë ndryshuar. Progres-raporti i KE 2013 theksonte se Shqipëria ka bërë progres të mirë në reforma. Në PE, Fyle u tha eurodeputetëve: "Jam i impresionuar nga mënyra se si qeveria e re po i përqendron përpjekjet në luftën kundër korrupsionit e krimit të organizuar dhe nga rezultatet e arritura gjatë muajve që kur mori detyrën, që konfirmon trendin pozitiv".


Catherine Ashton

FINANCIAL TIMES

Shqipëria u la mënjanë, ndërkohë që shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor kishin nisur rrugën e gjatë të anëtarësimit për në BE shkruan Kerin Hope. Tashmë, ajo ka mundësinë për t'i arritur ato. Në tetor, KE i hapi dritën e gjelbërt për të filluar bisedimet e anëtarësimit, tre vjet pas refuzimit të aplikimit të parë të saj. Një arritje e vendit u pa në qershor, kur zgjedhjet u përcaktuan si të lira e të ndershme nga ndërkombëtarët, që u pasuan nga një kalim i butë i pushtetit. "Statusi i vendit kandidat do ishte i favorshëm për kryerjen e reformave e një sinjal pozitiv për investitorët e huaj që vendi po lëviz në drejtimin e ", thonë analistët.

» GRUPI I PD

PROBLEMI *Deputetja Majlinda Bregu u ankua për taksën progresive duke puhuar: "Jo mo ta di se sa lekë do të çoj në shtëpi se më bërtet burri"*

Majlinda Bregu ankohet për taksat që do të paguajë

Berisha në mbledhje grupi, nuk mungon as një deputet

Ervin Koçi
TIRANE

Opozita ankohet për taksat që do të paguajë me paketën e re fiskale të propozuar nga qeveria. Pas prezantimit të sistemit të ri fiskal nga ana e Ministrit të Financave, Shkëlqim Cani në Konferencën e Kryetarëve në Kuvend, deputetja e Partisë Demokratike, Majlinda Bregu e cila ishte pjesë e kësaj tryeze, filloi që të ankohej në mbledhjen e grupit të PD-së për taksat që ajo do të paguaj pas miratimit të paketës së re fiskale. Kësisoj deputetët e demokrat ankohen për paketën fiskale pasi ajo i rëndon xhepat e tyre.

ANKESA

Pak çaste se të fillonte mbledhja e grupit parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Majlinda Bregu së bashku me ish-ministrin e Ekonomisë, Florion Mima dhe ish-kryetarin e grupi parlamentar të PD-së, Astrit Patozi, po diskutonin rreth taksave që do të paguanin ata nga implementimi i sistemit progresiv të tatimit. Konkretisht ish-ministria e Integrimit, Majlinda Bregu po i kërkonte shpjegime Florion Mimës lidhur me shumën e taksave që ajo do të pagunate në muaj. Në këtë moment, deputeti Astrit Patozi e pyeti Bregun se përse i duhej kjo e dhënë duke e pyetur nëse ishte e ftuar në ndonjë debat televiziv. Por përgjigja e Bregut ishte për tjetër gjë duke shprehur se "Jo mo ta di se sa lekë do të çoj në shtëpi se më bërtet burri". Menjëherë pas këtij pohimi, demokrati tjetër, Florion Mima, si ekspert i fushës ekonomike filloi që të pyeste Bregun lidhur me pagesën e saj mujore, por duke harruar se të dy kanë të njëjtën rrogë pasi që të dy janë deputet të Kuvendit të Shqipërisë. Pas kësaj, Mima filloi që ta sqaronte Ish-ministren e Integrimit mbi taksat e saj mujore me implementimin e sistemit progresiv të tatimeve. Por ajo që bie në sy duket se është se deputetët e Partisë Demokratike paskan më shumë problem xhepat e tyre se sa xhepat e qytetarëve, ashtu siç deklarojnë vazhdimisht në medeia.

BERISHA MBLEDH DEPUTETËT

Një gjë tjetër që ra në sy në mbledhjen e djeshme të Grupit Parlametar të Partisë Demokratike ishte fakti se numri i prezencës së deputetëve ishte maksimal. Kjo gjë duket se ndodh sa herë që në mbledhje grupi shkon ish-kryetari i PD-së, Sali Berisha, pasi në dy mbledhjet e shkuara të grupit të demokratëve kur nuk ka qenë Berisha, edhe numri i deputetëve ishte tepër i pakët. Konkretisht që pas mbledhejs së grupit të PD-së ku u bë edhe përkujtimi i Sokol Olldashit, rreth dy javë më parë, Sali Berisha nuk mori më pjesë në mbledhjet e grupit duke i neglizhuar ato për aktivitete të tjera politike që ai zhvilloi në zyrën e tij. Kjo gjë solli edhe uljen e interesit për deputetët e tjerë të PD-së për të qenë pjesëmarrës në mbledhjet që organizonte kryetari Lulzim Basha. Por me rikthimin e Berishës në ambientet e selisë së Partisë Demokratike, ra në sy edhe prezanca e madhe e deputetëve të PD-së të nga të cilët vetëm Edmond Spahou mungoi për shkak se ka thyer këmbën në aksidentin rrugorë të një muaji më parë.

BATUTAT BREGU-PATOZI-MIMA

— **Bregu-Mimës**: Sa do të tatohemi? Hyjmë tek 1 milion e 300 mijë lekshi edhe ne?
— **Patozi:** Pse ke ndonjë debat sot, ndonëj deklaratë?
— **Bregu-Patozit:** Jo mo ta di se sa lekë do të çoj në shtëpi se më bërtet burri.
— **Mima:** Sa e ke rrogën ti?
— **Bregu:** Aq sa e ke edhe ti.
— **Mima:** Një milion e gjyësm e kam unë.
— **Bregu:** Aq edhe unë. Sa do të taksohemi?



Majlinda Bregu

LAJME
shkurt

PD tryezë 4 ditore me përfaqësues të biznesit

Partia Demokratike do të organizoi për katër dit rrejshtë tek Tirana International Hotel një tryezë të rrumbullakët me përfaqësuesit e biznesit në vend. Nëpërmjet një njoftimi për mediat, PD thekson se kjo forcë politike do të bëhet zëri i biznesit shqiptar për ta përfaqësuar atë në diskutimet që do të bëhen në parlament. "Duke e konsideruar biznesin si gjeneratorin e zhvillimit ekonomik, Partia Demokratike është e gatshme të jete zëri i biznesit në Parlament", thuhet në njoftimin e PD-së.

Bylykbashi: Kuvendi është bër noter i qeverisë

Deputeti i Partisë Demokratike, Oerd Bylykbashi theksoi në një postin në faqen e tij në "facebook" se kryeministri Rama po e kthen demokracionë parlamentare në vend në një demokraci qeveritare. Duke marrë shkasë nga koha e shkurtër në diskutimet për buxhetin vjetor, Bylykbashi thekson se Kuvendi tani më po shërben si një noter për të vulosur vendimet e qeverisë dhe se diskutimet mbi projektligjet që po miratohen nuk po merren për bazë nga qeveria.

Akuzat

Basha: Paketa Fiskale rrënon 100% të shqiptarëve

PD kundër qeverisë. "U harruan premtimet elektorale"

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, theksoi dje se vonesa e draftit të buxhetit vjetor për vitin 2014 ka pasur si synim mungesën e transparencës dhe llogari-dhënies së qeverisë ndaj grupeve të interesit dhe opozitës. Gjatë mbledhjes së djeshme të grupit parlamentar të Partisë Demokratike, kryetari Basha në fjalën e tij lëshoi shumë akuza drejt kryeministrit Edi Rama për buxhetin vjetor ku kryefjala e tyre ishte mungesa e transparencës si dhe rrënimi ekonomik i vendit. Në këtë mënyrë, PD-ja, që pa nisur ende disktutimi mbi draftin, do të jetë kundër tij. Sipas Bashës, në këtë ligj nuk janë përfshirë premtimet elektorale të bëra nga Partia Socialiste në fushatën zgjedhore para 23 qershorit. Konkretisht sipas Bashës, qeveria nuk po ul taksat për 97% të shqiptarëve por po bën rrënimin ekonomik për 100% të tyre. "Ky është buxheti që i varfëron të gjithë shqiptarët, përfshirë ata të cilëve në mënyrë shumë cinike ky buxhet u jep me lugë kafeje në formën e taksimit progresiv të pagës atë që ua merr me lugë të madhe e madje me garuzhde mund të themi, nëpërmjet rritjes dramatike të taksave të tjera të konsumit, mosindeksimit të inflacionit, e instrumentave të tjerë. Ky është buxheti i gënjeshtrave dhe premtimeve të pambajtura për; pronarët, të përndjekurit politikë, shëndetësinë falas, uljen e çmimeve, rritjen e pensioneve, e shumë premtimeve të tjera të pambajtura të tullumbaces së plasur", theksoi Basha.



Legalizimet
Basha akuzoi qeverinë se ka mashtruar me legalizimet falas pasi sipas draftit, ALUIZNI do të siguroj 1.2 miliard lekë të ardhura.

Në vijim të fjalës së tij, kreu i demokratëve vijoj duke premtuar se Partia Demokratike përgjatë këtyre dy javëve do të demaskoi projekt-buxhetin si edhe paketën fiskale që e shoqëron atë duke shtuar se qeveria me këtë draft do të rrënoi ekonominë e vendit si edhe xhepat e qyetarëve shqiptar. "Do thellojmë shqyrtimin tonë për paketën fiskale që shoqëron buxhetin. Paketa më e dobët, kërkohet kalimi pa konsultim. Operatorëve të huaj në sektorin e naftës do t'u duhet të tatohen më shumë, dhe këtë çmim do ta paguajnë të punësuarit e kësaj industrie. Do rriten taksat dhe detyrimet, dhe duket se kjo lëvizje nuk është bërë për të lehtësuar biznesin e vogël, por për t'u marrë komunave dhe bashkive të vetmin burim të ardhurash që mund të administronin vetë. Goditje të rëndë marrin mbi 280 mijë shqiptarë që kanë nga një shtëpi të dytë. Akcizat rriten pothuajse për të gjithë mallrat e aksesueshëm. Ata që vërtet besuan në një shëndetësi falas për të gjithë kanë në dorë jo vetëm provën e mashtrimit, por edhe faturën e mashtrimit. Në këtë paketë nuk përfitojnë 95 % e shqiptarëve por penalizohen, ndëshkohen 100% e shqiptarëve. PD është e përgatitur për përballjen me qeverinë Rama-Meta për paketën fiskale. Do bëjmë të mundur që grupet e interesit të dëgjohen në grupet e punës parlamentare. Do të paraqesim propozimet tona që mund të evitojmë recesion që i serviret vendit bashkë me këtë buxhet të qeverisë", pohoi Basha.

Zyrtarët e lartë

MARIGLEN MULLA
TIRANE

Dosja "Imami", eksperti i Taks-Forcë "në kërkim" të milionave

Imamit i llogaritet dëmi, ikin 9 të Burgajt

Tenderi i policisë, përjashtohen 9 zyrtarët

Burgaj
Hysni Burgaj, Ish-drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, nuk është përjashtuar dje nga strukturat e unifo-rmave blu. Pritet një vendim tjetër.

Në foto: Hysni Burgaj



Imami
Dosja hetimore nga ish-ministrit të Mbrojtjes Arben Imami, synon të formulojë akuzë për dënimin e një ish-ministri për shpërdorim detyre.

Në foto: Arben Imami



Prokuroria e Tiranës caktoi një ekspert që të përllogariste dëmet financiare në dosjen "Imami" dhe 4 ish-zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, të denoncuar nga Kodheli për abuzime në shumë prej 1.2 milionë dollarësh, teksa orët në vijim pritet që akuza kryeqytetase të regjistrojë një procedim tjetër penal në ngarkim të ish-kryepolicit Hysni Burgaj e 9 anëtarët e komisionit të ofertave, të cilët u përjashtuan dje nga policia, por Burgaj nuk u përjashtua. Hetimi për Imamin do të drejtohet nga anëtarët e Task-Forcës së Prokurorisë së Tiranës. Pas kallëzimit penal nga ministrja Mimi Kodheli, dosja ishte dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme, por pas verifikimeve u delegua për moskoopetencë në Prokurorinë e Tiranës. Hetimet do të bëhen me qëllim për të parë, nëse në këtë dosje ka elementë të veprës penale atë të "shpërdorimit të detyrës". Eksperti i caktuar do të përllogarisë dëmin e shkaktuar. Nëse gjatë hetimit prokurorët do të konstatojnë vepër penale në ngarkim të ish-ministrit, Arben Imami, ky i fundit do të hetohet nga Prokuroria e Përgjithshme e cila do të kërkoj edhe heqjen e imunitetit si deputet që është. Ndërkaq, zyrtaret e tjerë të Ministrisë së Mbrojtjes do të hetohen nga ana e Prokurorisë së Tiranës. Disa nga detajet e kallëzimit penal, të cilat lidhen me datën 21 maj kur Qendra e Kulturës së Forcave të Armatosura, ka xhiruar nga buxheti rreth 1.2 milionë dollarë për llogari të një kompanie, "Zoom Event", që si për koeçidencë ishte krijuar vetëm disa muaj para këtij vendimi. Fondi i ishte kaluar nga kjo kompani menjëherë kompanisë "PRO Image", e cila ka bërë ndarjen e fondeve, për të cilat edhe më herët deputetë të PS-së, e kanë akuzuar për shpërndarje në mënyrë preferenciale. Përfituesi kryesor i fondit me rreth 70 % ka qenë grupi mediatik Media 6. Nga ana tjetër, 9 ish-Anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në Ministrinë e Brendshme janë përjashtuar dje. Përjashtimet kanë ardhur pas një auditi të brendshëm të zhvilluar në Ministrinë e Brendshme. Dy ditë më parë Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm ka referuar në Prokurorinë e Tiranës dosjen për abuzimet me reklamat, ku kallëzohet penalisht ish-Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Hysni Burgaj, zëvendësdrejtori i Përgjithshëm, Rasim Borishi dhe tetë anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në këtë drejtori. Nga detyra janë përjashtuar ish-zëvendës Drejtori i Përgjithshëm, Rasim Borishi; ish-kryetari i Vlerësimit të Ofertave, Kole Kukaj; si dhe 7 atëtarë të komisionit Adelina Marashi, Liza Tafili, Klejda Plangarica, Meri Papakostandini, Besjana Martini, Islam Cenga dhe Agim Hysko. Spoti televiziv "Shqipëria pa viza" ka kushtuar 1.2 milionë euro.

Drejtësia

"Magjistratët, e ardhmja e drejtësisë, jo qokat e KLD"

Replikat e Ministrit të Drejtësisë, Nasip Naço, dje në mbledhjen e KLD-së

TIRANE

Pas debateve në sallë, Ministri i Drejtësisë Nasip Naço është larguar dje, nga mbledhja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë ndërsa anëtarët e këtij këshilli po diskutonin në lidhje me emërimet në 13 vendet vakante në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Daljen e tij ende pa përfunduar mbledhja Ministri Naço e motivoi me mungesën e transparencës në vendimmarrje si dhe mosinformimin e opinionit publik mbi çështjet që ky këshill trajton. Ministri Naço deklaroi para mediave të interesuara në lidhje me zhvillimet e KLD-së, se është e dyta mbledhje që Këshilli i Lartë i Drejtësisë po e zhvillon në kundërshtim me praktikën që ka pasur deri tani, duke e distancuar median dhe rrjedhimisht duke ndikuar ndjeshëm në uljen e transparencës së vendimeve që ai miraton. "Sot ka pasur diskutime të ndryshme në lidhje me emerimet për vendet vakante në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë si dhe për plotësimin e vendeve vakante në disa Gjykata Administrative, vakanca të cilat vijojnë prej muajsh dhe nuk plotësohen nga KLD-ja duke dëshmuar qartë për një mungesë efiçence të këtij këshilli. Ka pasur qëndrime të ndryshme përsa i përket emërimeve në 13 vendet vakante të Gjykates së Rrethit Tiranë dhe vendeve vakante në gjykatat administrative. Ndonëse mbledhja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë ende po vazhdon, unë e braktisa sepse nuk mund të pranoj të jem pjesë e një farse të tillë që bie në kundërshtim me ligjin dhe praktikën që ky këshill duhet të zbatojë. KLD-ja ka nisur një praktikë errësire duke qenë larg syrit të medias dhe ky është një kthim mbrapa përsa i takon transparencës", deklaroi Ministri Naço. "Mendoja se Këshilli i Lartë i Drejtësisë do të më mirëkuptonte në lidhje me promovimin e këtyre magjistratëve. Mbi 130 magjistratë që nga viti 2001 kanë furnizuar me gjyqtarë sistemin e drejtësisë dhe besoj se këta magjistratë do të jenë e ardhmja për ta përmirësuar sistemin e drejtësisë dhe jo "qokat" e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të marrë gjyqtarë nga një rreth apo një tjetër", theksoi Naço. "Është koha të promovohen në karrierë ata gjyqtarë që do i japin tonin drejtësisë shqiptare", përfundoi Ministri i Drejtësisë Nasip Naço, para se të largohej nga salla e mbledhjeve.

VENDIMET E TJERA

KLD përjashtoi gjyqtarin e Pukës, Shtjefën Lleshi

— Këshilli i Lartë i Drejtësisë, si pikë e parë e rendit të ditës, pezulloi gjyqtarit të Rrethit Gjyqësor Pukë, Shtjefën Lleshi, deri në dhënien nga gjykata të një vendimi gjyqësor të formës së prerë për akuzën e ngritur ndaj tij. Këshilli miratoi kërkesën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Elidon Papazisi për transferim të tij në Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër. Anëtarët e KLD-së miratuan me unanitimet deklarimin e mbarimit të parakohshëm të mandatit si inspektore pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkak të dorëheqjes të zj. Alma Hicka.





Nasip Naço

GJYQTARËT E VLERËSUAR

1. Anesti Kasuli,	Apeli Korçë
2. Elvana Llurri,	Tiranë
3. Eneida Civici,	Tiranë
4. Fatime Velçani,	Tiranë
5. Kaçe Agolli,	Tiranë
6. Kreshnik Omari,	Tiranë
7. Nazmie Pengili,	Apelit Durrës
8. Ndue Gjura,	Durrës
9. Petraq Dhimitri,	Apeli Durrës
10. Alfred Konomi,	Fier
11. Anastasi Shehu,	Vlorë
12. Besnik Qira,	Kurbin
13. Eda Kaja,	Durrës
14. Ilir Përdeda,	Lezhë
15. Merita Xhani,	Durrës
16. Valdete Hoxha,	Tiranë
17. Valentina Sadiraj,	Apeli Durrës
18. Ramazan Avdiu,	Elbasan
19. Ylli Minka,	Gjirokastër
20. Miranda Çekrezi,	Elbasan
21. Osman Aliu,	Kavajë
22. Dhurata Bilo,	Durrës
23. Valbon Çekrezi,	Durrës
24. Shpëtim Reka,	Durrës
25. Hysni Demiraj,	Tiranë
26. Ergys Selmani,	Fier
27. Piro Sota,	Fier
28. Seladin Pysqyli,	Korçë
29. Ariola Kristo,	Korçë
30. Miljana Muça,	Korçë
31. Luljeta Kole,	Korçë
32. Fran Prendi,	Krimet e Rënda
33. Markelian Kuqo,	Korçë
34. Izet Kadana,	Pukë
35. Eglantina Mikani,	Korçë
36. Stavri Kallço,	Korçë
37. Maksim Qirjazi,	Korçë
38. Alvano Murataj,	Korçë
39. Brunilda Orhani,	Korçë
40. Arben Lera,	Korçë
41. Pëllumb Vehbi,	Gjirokastër
42. Kostika Çobanaqi,	Berat
43. Fahrije Budo Stringa,	Tiranë

» PALLATI

VENDOSJA *e 400 kg tritol në 1500 vrima sheshoi njërën prej kullave, ndërkohë që gjunjëzoi tjetrën. Të gjitha strukturat kaluan në gadishmëri nr. 1 në zonë*




NË FOTO: Momenti i shëmbjes së kompleksit



Bojaxhi, bllokoi pallatin në 2010

— Ish-kreu i INUK Gjergji Bojaxhi, vendosi pezullimin e punimeve në kompleksin "Jon" dhe më pas urdhëroi gjobitjen e kompanisë "G.B.A Konstruksion", për këto masa nuk e ndaluan aspak ndërtimin.



Avokatia e Berishës mbrojti firmën

— Erinda Ballanca, që njihet dhe si avokatja e ish-kryeministrit Sali Berisha, ka mbrojtur juridikisht kompanisë "G.B.A Konstruksion". Ballanca rezultoi se ishte dhe një ndër banoret e pallatit.



Haxhia, paralajmëron për proces gjyqësor

— Avokati i njohur Maks Haxhia, që përfaqëson 13 familjet e kompleksit "Jon", ka paralajmëruar se ai do ndjekë të gjitha nivlet e gjyqësorit, duke kërkuar dëmshpërblimin për pallatin e prishur.

INUK pret kollonat e pallatit me gërshërë, rrëzohet kulla 2

Një eskavator me paisje "gërshërë" u fut në kompleks

ELTON QYNO
VLORE

Forcat e INUK dhe xhenios së ushtrisë i janë dashur katër ditë për të rrëzuar në tokë 8 katet e kompleksit "Jon" që ndodhet në zonën e Ujit të Ftohtë në Vlorë. Tre eskavatorë, të mbështetur nga fadroma dhe një eskavator që ishte i paisur me një paisje "Gërshërë", kanë punuar për gjatë ditës e natës së djeshme, duke sjellë dëmtimin në pjesën më të madhe të objektit që mbeti në këmbë, pas shpërprtimit të rreth 400 kg tritol të vendosur në 1500 vrimat e hapura në kollonat e betonit. Kollonat e padëmtuara nga sasia e tritolit gjatë ditës së djeshme janë këputur, nga një eskavator që ishte i paisur me një "Gërshërë", e cila arrinte të këpuste në brendësi të objektit kollonat e komleksit "Jon". Për gjatë gjithë kësaj kohe në krye të këtij operacioni ka qëndruar kreu i INUK Zyhdi Dajti, i cili ka drejtuar brigadat e punonjësve, lidhur me rrëzimin e kompleksit "Jon". Ndërkohë që njëherësh, puntorët kanë nisur në pjesën e shembur totalisht të largojnë interenet e pallatit, me qëllim pastrimin dhe rehabilitimin në gjëndjen e mëparshme të zonës. Pritet që pikërisht në truallin ku është ndërtuar pallati në pronësi të Xhuvi Sharxhit dhe Xhafer Isufit, do të ndërtohet shëtitorja e qytetit të Vlorës.

Masat
Para se të kryhej shpërthimi i fuqishëm, të shtunën e kaluar u morrën masa për shmangien e çdo avarie në zonën e "Ujit të Ftohtë"





NË FOTO: Fadroma duke prishur pjesën e mbetur të kompleksit

MASAT E MARRA

Para se të kryhej shpërthimi i fuqishëm, të shtunën e kaluar u morrën masa për shmangien e çdo avarie në zonën e "Ujit të Ftohtë". Nga ana e kompanisë "Cez Shpërdarja" është ndërprerë energjie elektrike, ndërkohë që policia, dy autoambulanca dhe tre zjarfikëse kanë qëndruar në gadishmëri numër 1, për të zgjidhur çdo situatë të pakëndshme, që mund të krijohej pas shpërthimit të lëndës plasëse. Janë larguar ekspertët e xhenios. Rruga "Aleksandër Moisiu" është bllokuar dhe se në një distancë prej 40 metra është shtuar fitili, prej nga është bërë shpërthimi i komanduar. Në një perimetër prej 100 metra largësi nga kompleksi "Jon", janë urdhëruar të largohen të gjithë banorët, me qëllim shmangien e çdo dëmtimi të jetëve njerëzore.

400 KG TRITOL

Ka qënë ora 14:00 kur është bërë aktivizimi i sasisë prej 400 kg tritol, të vendosur në mbi 1500 vrimat e hapura. Kompleksi "Jon", i përbërë nga dy kulla binjake është rrëzuar totalisht në njërën pjesë, ndërkohë kulla tjetër është shembur në tre katet e para ndërsa 5 katet e tjera kanë mbetur të padëmtura. Shpërthimi ka dëmtuar rëndë këtë pjesë, duke e anuar në drejtim të detit. Pas largimit të tymit të krijuar, fadromat dhe eskavatorët e INUK kanë filluar të shembin kollonat një e nga një. Ky proces sipas drejtuesve të operacionit është kryer përgjatë gjithë ditë-natës së këtyre orëve, duke sjellë dhe shembjen totale edhe të kullës së dytë të kompleksit "Jon".

Pronarët e eskavatorëve

Sasia e hekurit u jepet privatëve

Sasia e shufrave të hekurit që përfitohet nga prishja e kompleksit "Jon", do kalojë në favor të firmave private që kanë vënë në shërbim të INUK ekavatorët. Zyrtarë të INUK, deklarojnë nën zë, se pjesën më të madhe të mjeteve të rënda për prishjen e pallatit që ndodhej në pronësi të vjehrrit të Lulzim Bashës, janë marrë me qëra dhe se si kompesim për punën dhe naftën e konsumuar,



i është lënë marrja e hekurit që përfitohet nga prishja e pallatit. Bëhet fjalë për disa pronarë që përfitojnë sasinë e konsiderueshme të hekurit, të cilët siç mësohet do kontribojnë me automjetet e tyre edhe për pastrimin e ineterteve të betonit. Burime pranë INUK thanë se një praktikë e tillë do përdoret në të gjitha rastet e shembjes së objekteve në zonën e bregdetit të Vlorës.

"ZENEL MURRA"

U prish shkolla për ndërtimin e kompleksit



— Skandali i ndërtimit të pallatit në pronësi të vjehrrit të Lulzim Bashës, morri përmasa akoma dhe më të mëdha kur u mësua se pikërisht në vendin ku ishte ndërtuar pallati, ka qënë një shkollë 8-vjeçare. Kjo tregoi se bëhej fjalë për një pronë që ska qënë asnjëherë pronë private, por përkundrazi sipërfaqja i ka shërbyer shkollës 8-vjeçare të quajtur "Zenel Murra" dhe që është ndërtuar rreth viteve 1980 nga rregjimi i asaj kohe. Sot godina e kësaj shkolle nuk ekziston më, jo për faktin se është gryer nga dallgët e ditit, por ajo është shembur nga fadromat, duke i hapur kështu rrugën e ndërtimit të pallatit. Shkolla "Zenel Murra", është prishur, duke u transefruar disa metra më larg në afërsi të shkollës tregtare që ndodhet në zonën e "Ujit të Ftohtë".



Lokalizohet në Vlorë personi që kishte përdorur numrin

Zbulohet në Vlorë pronari i kartës se telefonit bombë

Kontrolli i servisit dhe pyetja e punonjësve

Hetimet

ELTON QYNO
TIRANË

Hetimet për gjetjen e autorëve që vendosën 200 gramë tritol poshtë makinës së prefektit të Vlorës Besnik Dervishi, kanë zbuluar dy ditë më parë një 50-vjeçar, si personin që ka pasur numrin që ishte vendosur në telefonin "Samsung". Ky person konfirmohet se banon në Vlorë dhe se gjatë ditës së dielë, është shoqëruar në polici ku dhe ka dhënë deklarime, lidhur me lëvizjet që ka kryer gjatë javës së kaluar dhe kohës së përdorimit të numrit celular. Në rrëfimin e tij 50-vjeçari ka treguar para hetuesve të çështjes, se kohë më parë ka pasur në përdorimin numrin që është gjetur në aparatin celular, i cili ishte lidhur me 2 dotonatorë dhe një sasi prej 200 gramë tritol. 50-vjeçari, emri i të cilit nuk bëhet i ditur për arsye hetimore, ka treguar më tej se numri i tij është mbyllur nga kompania telefonike për shkak të mos futjes së lekëve brenda afatit kohor. Në këto kushte ai e ka zëvendësuar kartën me një numër tjetër, ndërkohë që gjatë dhënies së deklarimeve nuk ishte në gjendje të tregonte rrethanat e humbjes së numrit, që tashmë ndodhet në dorën e prokurorisë. Megjithëse është lënë i lirë në këtë fazë të hetimit ky person është nën mbikqyrjen e policisë dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda.



Prefekti i Vlorës, Besnik Dervishi



Eksplozivi dhe telefoni i gjetur në makinë

Në kartën e gjetur, janë administruar dhe dy sms promocionale që kanë mbërritur nga kompania telefonike.

KONTROLLI I SERVISIT

Deklarimi në prokurori i prefektit të Vlorës Besnik Dervishi se disa ditë para se të udhëtonte në drejtim të Tiranës, ka lënë makinën në një servis për rriparimin me disa difekteve, ka shtyrë prokurorët e çështjes të nxjerin menjëherë urdhërin për kontrollin e imtësishëm të ambjenteve të servisit si dhe marrjen në pyetje të gjithë punonjësve. Nga ky kontroll fizik, bëhet me dije se nuk është arritur të përftohen të dhëna të nevojshme për hetimin. E njëjta vjjë ka ndodhur edhe gjatë marrjes në pyetje të punonjëse të servisit të cilët kanë treguar momentet e para kur është future makina në servis, rregulluar dhe më pas kanë treguar dhe personit që ishte paraqitur për të marrë mjetin. Për momentin të gjitha dyshimet e prokurorisë dhe policisë janë përqëndruar në qytetin e Vlorës, pasi dy muaj më parë prefekt i këtij qyteti u emërua Besnik Dervishi.

GARDISTI ZBULOI TRITOLIN

Makina me tritol hyri në oborrin e kryeministrisë

— Ka qënë mëngjesi i 13 dhjetorit, kur efektivi i Gardës së Republikës Dritan Doko gjatë një kontrolli me pasqyrë ka vërejtur se automjeti i parkuar brenda në teritorin e kryeministrisë ishte i paisur me një sasi eksplozivi. Makina ishte parkuar disa minuta para kontrollit nga Besnik Dervishi, ndërkohë shumë shpejt e gjithë zona u rrethua ndërsa punonjësit e kryeministrisë u evakuan. Mbëritja e forcave RENEA solli dhe çaktivizimin e lëndës shpërthyese, ndërsa Prokuroria e Krimeve të Rënda, e cilësoi si akt terorist vendosjen e tritolit në automjetin e Dervishit. Momentalisht hetimet për këtë ngjarje vijojnë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në zbatim të ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", **Departamenti i Administratës Publike** shpall konkurimin për **1 vend** të lirë në pozicionin:

Përgjegjës në Sektorin e Financës në Drejtorinë e Financës, në **Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë**.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në Shërbimin Civil në përputhje me nenin 12 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 «Statusi i nëpunësit civil».

KËRKESA TË VEÇANTA PËR KANDIDATËT

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë në Fakultetin Ekonomik (për nivelin e diplomave referojuni Udhëzimit nr. 4 dt. 17.02.2010)
- Të ketë jo më pak se 5-vjet eksperiencë pune nga ku jo më pak se 3-vite në profesion
- Të zotërojë gjuhën angleze.
- Të përdorë programet bazë të punës në kompjuter
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup

Paga e pozicionit është në kategorinë III - a

Paraqitja e dokumenteve:
Kandidati duhet të paraqesë brenda **datës 15.01.2014 në Kutinë Postare Nr.1751,** këto dokumenta: kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të diplomës dhe librezës së notave, të librezës së punës, certifikatave të kualifikimit, dëshmive të gjuhëve të huaja dhe kompjuterit, vërtetimin e gjendjes gjyqësore si dhe të paktën një letër rekomandimi, një numër telefoni për tu kontaktuar si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit. (Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit).

KONKURIMI është i hapur për nëpunësit civil të të njëjtës klasë me procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë. Nëse vendi nuk plotësohet nga këta kandidatë, konkurimi zhvillohet me kandidatët jashtë Administratës Publike, sipas proceduravе të shërbimit civil.
Pas verifikimit paraprak, **me datë 21.01.2014** në selinë e **Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë** si dhe në www.pad.gov.al, do të shpallet lista e konkurentëve, që do të vazhdojnë më tej konkurimin si dhe data kur do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista me gojë. Konkurimi do të bazohet në njohuri të përgjithshme mbi legjislacionin që rregullon fushën financiare, ligjin e buxhetit, kodin e procedurave administrative, Ligjin nr. 9131 dt. 08.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike", Ligji nr. 8503 dt. 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare" si dhe Ligji nr. 9367 dt. 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", Ligj nr.9049 dt. 10.4.2003 "Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë"

Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, rezultatet e verifikimit paraprak si dhe datat kur do të zhvillohen testimet, mund t'i gjeni në adresën e Web Site të Departamentit të Administratës Publike www.pad.gov.al.

ADRESA: BULEVARDI "DËSHMORËT E KOMBIT", TIRANË, SHQIPERI, KUTIA POSTARE NR. 1751 TEL/FAX: +355 4 251241, 235937 - WWW.PAD.GOV.AL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në zbatim të ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", **Departamenti i Administratës Publike** shpall konkurimin për **1 vend** të lirë në pozicionin:

Përgjegjës në Sektorin e Lejeve dhe Monitorimit të Hidrokarbureve në Drejtorinë e Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve, në **Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë**.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në Shërbimin Civil në përputhje me nenin 12 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 «Statusi i nëpunësit civil».

KËRKESA TË VEÇANTA PËR KANDIDATËT

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë në Shkencat Politeknike (për nivelin e diplomave referojuni Udhëzimit nr. 4 dt. 17.02.2010)
- Të ketë jo më pak se 5-vjet eksperiencë pune nga ku jo më pak se 3-vite në monitorim dhe mbikqyrje kontratash dhe marrëveshjesh në fushën politeknike
- Të zotërojë gjuhën angleze.
- Të përdorë programet bazë të punës në kompjuter
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup

Paga e pozicionit është në kategorinë III - a

Paraqitja e dokumenteve:
Kandidati duhet të paraqesë brenda **datës 15.01.2014 në Kutinë Postare Nr.1751,** këto dokumenta: kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të diplomës dhe librezës së notave, të librezës së punës, certifikatave të kualifikimit, dëshmive të gjuhëve të huaja dhe kompjuterit, vërtetimin e gjendjes gjyqësore si dhe të paktën një letër rekomandimi, një numër telefoni për tu kontaktuar si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit. (Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit).
KONKURIMI është i hapur për nëpunësit civil të të njëjtës klasë me procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë. Nëse vendi nuk plotësohet nga këta kandidatë, konkurimi zhvillohet me kandidatët jashtë Administratës Publike, sipas proceduravе të shërbimit civil.
Pas verifikimit paraprak, **me datë 21.01.2014** në selinë e **Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë** si dhe në www.pad.gov.al, do të shpallet lista e konkurentëve, që do të vazhdojnë më tej konkurimin si dhe data kur do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista me gojë. Konkurimi do të bazohet në njohuri të përgjithshme mbi legjislacionin në fushën e hidrokarbureve, Kodin e Proçedurave Administrative, Ligjin nr. 9131 dt. 08.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike", Ligji nr. 8503 dt. 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare" si dhe Ligji nr. 9367 dt. 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", Ligj nr.9049 dt. 10.4.2003 "Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë"
Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, rezultatet e verifikimit paraprak si dhe datat kur do të zhvillohen testimet, mund t'i gjeni në adresën e Web Site të Departamentit të Administratës Publike www.pad.gov.al.

ADRESA: BULEVARDI "DËSHMORËT E KOMBIT", TIRANË, SHQIPERI, KUTIA POSTARE NR. 1751 TEL/FAX: +355 4 251241, 235937 - WWW.PAD.GOV.AL

Procesi

Pretenca e akuzës: 150 vite burg 7 anëtarëve të grupit

1 shekull e gjysëm burg bandës së lazaratasve

Torturuan 3 persona, dyshonin se u vodhën drogën

ELTON QYNO
TIRANE

Prokuroria e Krimeve të Rënda ka kërkuar shpalljen fajtorë të 7 personave dhe dënimin e tyre me 150 vite burg për akuzën e "Rrëmbimit të personit" shoqëruar me tortura fizike e psikike. Në materialin përfundimtar prokurori i çështjes i tha gjykatës se dyshimi për grabitjen e një sasie lënde narkotike ka bërë që tre personat Velo Shele, Ergest Shele dhe Ergys Goxhaj të rrëmbehen dhe të torturohen në mënyrë çnjerëzore nga 7 pjesëtarët e një grupi kriminal që vepron në zonën e Lazaratit në Gjirokastër. Pjesëtarët e këtij grupi kriminal kishin planifikuar të trafikonin një sasi lënde narkotike të llojit marijuanë në drejtim të Greqisë, mirëpo teksa përpiqeshin të vinin në zbatim planin e tyre, gjithçka është rrëzuar, pasi sasia e drogës është vjedhur nga disa persona. Të 7 pjesëtarët e këtij grupi, kanë kryer verifikime, ku kanë dalë në konkluzionin se lënda narkotike ishte vjedhur nga tre shtetasit Ergest Shele, Velo Shele ndryshe "Kosta Agora" dhe Resul Goxhaj, nga qyteti i Përmetit. Nisur nga kjo situatë, njëri nga anëtarët e grupit, i pandehuri Aleksandër Kalemi, e ka marrë në telefon të dëmtuarin Ergest Shele, duke i kërkuar këtij të fundit të takoheshin në Gjirokastër. Së bashku me vëllain e tij Velo Shelo, ata kanë udhëtuar me autobus nga Përmeti në Gjirokastër, ku pasi janë takuar me të pandehurin Kalemi dhe janë ulur së bashku në një lokal, ata janë gjendur mes disa personave të armatosur. Pikërisht këta persona kanë qenë të pandehurit e mësipërm, të cilët u kanë kërkuar të kthenin mallin e vjedhur, pasi në të kundërt do t'i vrisnin. Dy vëllezërit kanë pohuar se s'kanë vjedhur asnjë kilogram drogë, por pas kësaj ata janë rrëmbyer duke i çuar në një banesë të braktisur në fshatin Lazarat, ku edhe i kanë torturuar për gjatë gjithë natës. Së bashku me ta është torturuar edhe shtetasi Ergys Goxhaj, i cili ka shkuar për të sqaruar situatën, por që më pas është mbajtur peng nga 7 trafikantët.

"NXIRNI MALLIN"

I pandehuri Aleksandër Kalemi i telefononte shpesh të pandehurit Ergest Shele për ta pyetur për vendndodhjen. Të dëmtuarit Ergest Shele dhe Velo Shele kanë zbritur në vendin e quajtur Ura e Lumit, ku janë takuar me të pandehurin Aleksandër Kalemi, i cili ishte me një makinë tip "Ford" me xhama të zinj. Të dëmtuarit Ergest dhe Kosta kanë hipur në makinën e tij dhe të tre kanë shkuar tek lokal "Fantazia" afër vendit të quajtur Qafa e Pazarit në Gjirokastër, ku kanë qëndruar rreth 15 minuta dhe me makinën e të pandehurit Aleksandër Kalemi kanë shkuar në drejtim të shkollës "Naim Frashëri" në lagjen "Dunavat". Sapo kanë filluar të zbresin poshtë rrugës, janë ndaluar nga një automjet tip furgon me ngjyrë të bardhë me targa amerikane, që drejtohej nga i pandehuri Arbër Meçi. Në këtë kohë nga furgoni kanë dalë të pandehurit Bledar Muho dhe Kasëm Buzheri, të cilët u janë drejtuar vëllezërve Ergest dhe Kosta me fjalët: "Mos lëvizni!" I pandehuri Kasëm Buzheri e ka goditur me pistoletë në kokë të dëmtuarin Ergest Shele duke i thënë: "Më njeh mua... ju që donit të më vidhnit mallin mua". Më pas kanë goditur me grushte Ergestin dhe Kostën në trup, duke i detyruar të hipnin në një furgon me ngjyrë të bardhë dhe janë nisur drejt fshatit Lazarat. Në afërsi të fshatit Kordhocë, të dëmtuarit janë detyruar të hipin në automjetin e markës "Audi Q7" me ngjyrë të zezë, që drejtohej nga i pandehuri Alfons Buzheri dhe kanë vazhduar rrugën për në fshatin Lazarat. Në furgon kanë hipur edhe të pandehurit Kasëm Buzheri, Bledar Muho, Arbër Meçi dhe Aleksandër Kalemi. Të pandehurit i kanë çuar të dëmtuarit në një shtëpi të braktisur në fshatin Lazarat, duke ushtruar ndaj tyre dhunë çnjerëzore.


Vullnet Buci


Kasem Buzheri


Bako Byzheri

PRETENCA

- Kasëm Buzheri 22 vjet burg
- Bledar Muho 22 vjet burg
- Alfons Buzheri 22 vjet burg
- Aleksandër Kalemi 20 vjet burg
- Arbër Meçi 22 vjet burg
- Bako Buzheri 21 vjet burg
- Vullnet Buci 21 vjet burg


Arbër Mici


Aleksandër Kalemi


Bledar Muho

LIDHJA ME TEL

I pandehuri Alfons Buzheri e ka lidhur të dëmtuarin Ergest Shele këmbë dhe duart me tel xingato dhe ka filluar ta godasë me shkelma e grushte duke i thënë: "Nxirrni mallin! Kush e ka marrë?" Më pas në dhomë kanë hyrë të pandehurit Bako Buzheri, Kasëm Buzheri, Bledar Muho, Arbër Meçi dhe një person tjetër i paidentifikuar, të cilët kanë filluar ta godasin Ergestin me shkelma e grushte dhe i drejtoheshin me fjalët: "Ku e keni mallin?" Në të njëjtën kohë të pandehurit godisnin edhe të dëmtuarin Velo Shele, të cilin më pas e kanë lënë të lirë, duke e kërcënuar me jetën e të vëllait nëse kallëzonte në polici. I pandehuri Alfons Buzheri ka vazhduar të godasë me shkelma e grushte të dëmtuarin Ergest Shele për ta detyruar që të pranonte se "mallin e kishte vjedhur bashkë me Resul Goxhaj dhe Alban Rustemin". Disa minuta më pas, në dhomë është sjellë dhe Ergys Goxhaj, i cili pasi është torturuar, ka pranuar se mallin e kishte vjedhur ai.

LAJME
shkurt

"Burri më mban si prostitutë"

Një 30-vjeçare nga Tirana ka denoncuar bashkëshortin e saj, me akuzën se po e shfrytëzonte për prostitucion. Pas denoncimit të shtetases A.Matraku, nënë e një fëmije të vogël, policia ka nisur procedimin penal në gjendje të lirë për Oriol Matrakun.

Nxirret nga deti motovedeta

Është nxjerrë pas 2 javësh në det të hapur motovedeta e Guardia di Finanzës, e bllokuar në cekëtinë në grykëderdhjen e Semanit, më 30 nëntor. Operacioni për shpëtimin e motovedetës ka zgjatur disa orë, ndërsa nxjerrja e saj në det është bërë e mundur përmes një mjeti të rëndë, që ka hapur një kanal nën ujë,.

Kapen 2 minorenet, kryen 50 grabitje

Dy motra të mitura, 10 dhe 11 vjeçe të cilat dyshohet se janë autore të një sërë grabitjesh në Tiranë, janë arrestuar në Shkodrër teksa po kryenin vjedhjen e fundit. Sipas policisë, dy motrat rome pasi shënjestronin objektivin që do vidhnin, futeshin brenda tij dhe njëra prej tyre fillonte të kërkonte lëmoshë ndaj personit që ndodhej brenda ndërsa tjetra kryente vjedhjen. Ato mendohet se janë autore të mbi 50 grabitjeve në Tiranë.

Pranga faturistëve të CEZ-it vidhnin qytetarët e bizneset

Task-Forcë, finalizohen hetimin për mbi faturimin

Energjia
TIRANE



Plot 14 persona punonjës të "Cez Shpërndarje" janë vënë në ndjekje penale nga njësia hetimore Task-Forcë, pranë prokurorisë së Tiranës, për shkak të vjedhjeve të energjisë elektrike. Ditën e djeshme gjykata e Tiranës vendosi masën e "arrestit në burg" për 8 faturues ndërkohë që për 6 punonjës të tjerë është vendos masa e "arrestit në shtëpi". Tashmë të 14 masat janë ekzekutuar nga policia e Tiranës. Masat e sigurimit ndaj këtyre personave janë caktuar në bazë të provave, sipas të cilave rezulton se kanë fallsifikuar faturat e energjisë elektrike për një numër të konsiderueshëm qytetarë e biznese, duke bërë që këta të fundit të paguajnë shuma që variojnë nga 65.000-280.000 lekë të reja për shkelje të pretenduara nga faturistët, por që realisht konsumatorët nuk i kanë kryer këto shkelje.

TE ARRESTUARIT

N. Sulaj	arrest me burg
A. Koleci	arrest me burg
M. Ndreu	arrest me burg
B. Kurtaj	arrest me burg
N. Kurti	arrest me burg
K. Karamuca	arrest me burg
E. Tocilla	arrest me burg
Sh. Basha	arrest me burg
M. Dragoshi	arrest në shtëpi
A. Gjondedaj	arrest në shtëpi
L. Karaosmani	arrest në shtëpi
M. Shiqeruka	arrest në shtëpi
H. Zhilli	arrest në shtëpi
Sh. Stojku	arrest në shtëpi

Eksklusive

ELTON QYNO
TIRANË


Si hyri në familjen e viktimës 17-vjeçare

Shaban Norja, ja rrëfimi i monstrës plak të Shijakut

"Magjepsi" vajzën 60 vjet më të re


Shaban Norja


Ajshe Vata


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

PROCESVERBAL
PËR MARRJEN E TË DHËNAVE NGA PERSONI NDAJ TË CILIT ZHVILLOHEN HETIME

Në Durres , me 14.10.2012 ora 13.30
Unë Artan LLUPA , oficer i Policise Gjyqesore, në bazë të nenit 296 të K. Pr. Penale, mbaj këtë procesverbal për marrjen e të dhënave, nga personi ndaj te cilit zhvillohen hetimet: Shaban Norja , i biri i Reshit dhe i Cije, i datelindjes 13.02.1932 , lindur Likesh Shijak dhe banues ne Komuna Xhafzotaj katerruget Shijak , Durres, me kombesi e shtetesi Shqiptare, me gjendje gjyqesore i denuar me pare per tentativ vrasje , me gjendje familjare i ve , me numer telefoni 0686505548 ,,

Personit iu spjeguan se:
- Ka të drejtë të mos përgjigjet dhe se cdhe po të mos përgjigjet procedimi do të vazhdojë, neni 38/3 i K.Pr.Penale;
- Mund të japë gjithçka që çmon të dobishme për mbrojtjen e tij, neni 39/2 i K. Pr. Penale;
- Cilat janë faktet për të cilat procedohet dhe arsyet e marrjes në pyetje të tij, si dhe të dhënat në regjistrin të tij, neni 256 i K. Pr. Penale;
- Ka të drejtë të zgjedhë një mbrojtës dhe të kërkoj caktimin e një mbrojtësi nga organi procedues, nenet 48, 49, 296 e tejues të K. Pr. Penale.

Jam me banim ne Komunen Xhafzotaj lagja Partizan Shijak .
Pasi u njoha me te drejtat e mia sqaroj se une do jape shpjegime pa pranin e avokatit ne kete faze te hetimit per cfare do pyetem.
Pyetje: Ndaj jush zhvillohen hetime per veprën penale te "Vrasjes ne rrethana te tjera cilesuese " te shtetases Aishe Vata per te cilen Prokuroria e

Faksimile e dokumentit të dëshmisë së Shaban Nores

Shaban Norja, personazhi 81-vjeçar që 1 vit më parë habiti të gjithë opinionin publik me krimin e tij mostruoz të vrasjes së 17-vjeçares Aishe Vata, vjen me një rrëfim të plotë të ngjarjeve para dhe pas krimit të datës 11 tetor 2012. Gazeta "Shqiptarja.com" disponon të plotë dëshminë e të moshurit, i cili ka treguar me detaje marrëdhënien me familjen Vata, vajzat e kësaj familje si dhe një bisedë që Shaban Norja ka pasur me Muhametin, babain e Aishe Vatës, të cilit i spiunonte për lidhjet intime që vajzat e tij kishin me djem të fshatit. Në këtë bisedë Norja, i ka treguar dhe emrin konkret të djalit, dhe se Muhameti ka dashur ti japë një kafe në lokal dhe të flisnin bashkë shtruar, por vetë Shaban Norja ka refuzuar, duke i pohuar se këto punë nuk ishin për tu diskutuar në lokale. Më tej në rrëfimin e tij, para oficerëve dhe prokurorëve, Norja ka treguar dhe për një martesë të shtetases V., e cila është zgjidhur 1 ditë më pas për shkak se ajo nuk ishte e virgjër, duke e akuzuar direkt direkt të prindërit, Shaban Norjan si shkaktar të kësaj situate. Por që sipas tij, veprimet e saj ishin shenjë hakmarje, për lidhjen e fshehtë që Norja ia kishte zbuluar, për të cilën i kishte treguar dhe babait të saj, Muhametit. Gazeta "Shqiptarja.com" sjell sot një pjesë të rëfimit që Shaban Norja ka dhënë para grupit hetimor.

DËSHMIA

Shaban Norja ka treguar dhe për një martesë të shtetases V., e cila është zgjidhur 1 ditë më pas për shkak se ajo nuk ishte e virgjër

DËSHMIA E NORJAS

Në Durrës më 14.10. 2012 ora 13:30

Unë A.Ll. Oficer i Policisë Gjyësore në bazë të nenit 296 të Kodit të Procedurës Penale, mbaj këtë procesverbal për marrjen e të dhënave ndaj personit që zhvillohen hetimet Shaban Norja, i biri i Reshitit dhe i Cajes, i ditëlindjes 13.02.1932, lindur në Likesh Shijak dhe banues në Komuna Xhafzotaj katër rrugët, Shijak, Durrës, me kombësi e shtetësi Shqiptare, me gjëndje gjyqësore i dënuar më parë për tentativë vrasje, me gjëndje familjare i ve, me numër telefoni 0686505xxx

I dyshuari u njoh me të drejtat që i njeh ligji.

Unë Shaban Norja jam me banim në komunën Xhafzotaj lagjia "Partizan" Shijak. Pasi u njoha me të drejtat e mia sqaroj se unë do të jap shpjegime pa praninë e avokatit në këtë fazë të hetimit për çfarë do pyetem.

Pyetje: Ndaj jush zhvillohen hetime për veprën penale të "Vrasjes në rrethana të tjera cilëuese" të shtetases Aishe Vata, për të cilën Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka filluar procedimin penal nr. 1649 për veprën penale të parashikuar nga nenet 79/b të Kodit Penal në lidhje me ngjarjen e datës 11.10.2012, kur rreth orës 09:00 në një arrë me misër është gjetur e vrarë (Pa kokë) kjo shtetase. Çfarë mund të na thoni në lidhje me këtë ngjarje"

Përgjigje: Lidhur me ngjarjen unë kam për të deklaruar se viktimën Aishe Vata, e njoh që në vitin 2002. Dua të them se Aishja me familjen e saj erdhi në vitin 1997 dhe u vendosën me shtëpi në fshatin Xhafzotaj. Dua të sqaroj se pranë banesës së familjes Vata kam patur një tokë që ia kam shitur shtetasit Ermal Laçi. Në vitin 2001 shtetasi Eduart Xheraj që është me banim në Durrës më ka lënë në ruajtje një parcelë të rrethuar dhe e mbjellë me pemë frutore. Gjatë kësaj kohe jam njohur me shtetasin Muhamet dhe familjen e tij. Nuk më kujtohet viti, por di që Muhameti ka ikur në Angli dhe unë e kam ndihmuar Sulejmanin duke çuar një makinë me dru. Theksoj se unë në atë kohë punoja si magazinier në pronën e shtetasit Ermal Laçi, ku kishte materiale inerte dhe pjesë këmbimi për automjetet e rënda. Unë di që Muhameti ka qënë i martuar shtetasen Rrushe Vata, me të cilën ka pasur pesë fëmijë të quajtur M., V., A., S., dhe djali E. Dy vajzat, V., e ka të martuar dhe ndodhet në Itali, ndërsa M., është e martuar në Fllakë me shtetasin Sh.N. Pas vdekjes së gruas së parë Muhameti është martuar me shtetasen T.Vata me të cilën ka dy fëmijë të quajtur S., djali dhe S., vajza. Muhameti merret me aktivitet privat. Ai ka një servis elektroaut pranë shtëpisë ku banon. Për sa i përket shtetasit. Sulejman V., di që ai ka qënë i martuar me shtetasen Aishe V., me të cilën ka pasur pesë fëmijë, katër vajza të quajtura E., N., A., dhe L., si dhe një djalë i quajtur M. Sulejmani është i martuar aktualisht me shtetasen Refije.V me të cilën ka një djalë. Unë si me Muhametin ashtu dhe me Sulejmanin siç shpjegova më lart kam patur marrëdhënie të mira. Unë në një rast në vitin 2008 e vura në dijeni se vajza e Muhametit e qujatur V., kishte lidhje dashurore me një djalë nga Ferma Xhafzotaj,me origjinë çame dhe që i flisni "Liçja". Muhameti më tha që hajde të pimë nga një gjë në local, por unë e kam rrefuzuar duke i thënë që nuk është punë për lokal. Më pas kur unë ja shpjegova Muhametit më tha që do e rregullonte ai këtë punë dhe se çfarë bëri me V., unë nuk e di. Më pas më datën 13 gusht 2008 V., u martua me një person nga Dibra, emrin nuk ja di por të nesërmen burri I saj e ktheu në shtëpi. Muhameti pasi ju kthye vajza, V., e pyeti se cila është shkaku i kthimit por ajo i tha se nuk ishte e virgjër, duke shpifur se kishte kryer marrëdhënin seksuale me mua Shaban Norjan. Sqaroj se vetë V., ma kishte thënë që do të më fuste në sherr me babain e saj, duke shpifur për mua. Nga kjo gjë debatuam me Muhameti dhe pse unë i shpjegova që nuk kam të bëj dhe i shpjegova për lidhjet që ajo kishte patur me persona siç shpjegova dhe më lart.

KAFJA

Në këtë bisedë Norja, i ka treguar dhe emrin konkret të djalit, dhe se Muhameti ka dashur ti japë një kafe në lokal dhe të flisnin bashkë shtruar

Vendimi

81-vjeçarin Gjykata e dënoi me 25 vite burg për vrasjen e Vatës

Norja pranoi autorësinë e krimit para trupit gjykues

TIRANË

Në muajin janar të 2013 gjykata e Durrësit, dënoi me 25 vite burg njeriun që cilësohet si mostra e Shijakut. Norja është dënuar me 25 vite burg pasi ka pranuar gjykimin e shkurtuar. Ai ka pranuar para trupit gjykues vrasjen e 17-vjeçares Vata, për shkak se ajo nuk abortonte fëmijën që priste nga ky i fundit. Ndërkohë që më herët Prokuroria ka kërkuar burg përjetë për "monstrën e Durrësit". Ngjarja e rëndë tronditi mbarë opinionit publik. Gjetja e trupit të një femre, e masakruar dhe pa kokë më tepër se sa skenave të një filmi horror ngjante me të pabesueshmen. Por hetimet çuan në kapjen e autorit i cili pranoi se e kishte kryer krimin me gjakftohtësi dhe krejt i vetëm. Ajshe Vata u gjet e masakruar pa kokë mëngjesin e 11 tetorit nga një bashkëfshatar i saj, në një arë me misër në fshatin Xhafzotaj, aty ku edhe jetonte. Kur ekspertiza vërtetoi se ajo ishte shtatzënë, hetimet morën një rrjedhë tjetër derisa u bë e mundur kapja e Shaban Norjas. Ekspertët arritën në konkluzionin se vajza ishte abuzuar që 14-vjeç nga Norja, i cili ka deklaruar më pas që e vrau vajzën për shkak se nuk donte të abortonte fëmijën që priste nga ai. Sipas organit të akuzës Norja ka kryer ekzekutimin e 17-vjeçares, fillimisht me armë zjarri tip pistoletë dhe më pas e ka gjymtuar, duke i prerë kokën viktimës me një sëpatë me mendimin që të mos identifikohej.

DËNIMI

Norja është dënuar me 25 vite burg pasi ka pranuar gjykimin e shkurtuar. Ai ka pranuar para trupit gjykues vrasjen


Shaban Norja në gjyq

Autobusët

Shoferët dhe fatorinot, prej tre muajsh pa marrë rrogat

Pezullohet transporti urban për 3 orë në Tiranë

Përfaqësuesit paralajmërojnë protesta 24 orëshe

MIRANDA GJONI
TIRANE

Të gjitha linjat e autobusëve në kryeqytet kanë zhvilluar dje një protestë 3-orëshe për pagat e shoferëve dhe fatorinove. Greva nisi në orën 05:00 dhe zgjati deri në orën 08:15, gjë që shkatoi kaos në rrugët e kryeqytetit, pasi qytetarë nxitonin për të shkuar në punë apo në shkollë. Po kështu, linjat e urbanëve, kërkojnë uljen e akcizës së naftës dhe rritjen e çmimit të biletës. I kontaktuar nga "Shqiptarja.com" kreu i Sindikatës së Punonjësve të Transportit Urban, Zija Hasanaj, tha se shkak për nisjen e grevës është mosmarrja e pagave të shoferëve dhe fatorinove prej disa muajsh.

KËRKESA

Ndërkaq, kërkesa e sindikatës drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë, konsiston në vendosjen e çmimeve dhe tarifave të tjera të biletës, si dhe rimbursimin e biletave të studentëve. Brenda një jave, kjo është greva e dytë e zhvilluar nga punonjësit e transportit urban. Në grevën e parë autobuzat urban kryeqytetas kanë pezulluar punën për rreth 45 minuta, duke krijuar probleme për qytetarët e Tiranës. "Në bazë të ligjit, Këshilli i Ministrave vendos çmimet dhe tarifat, por ato janë nën mbikqyrje të qeverisë. Kërkesat tona i drejtohen Ministrisë së Transportit dhe Ministrisë së Ekonomisë, për t'i bërë kërkesë qeverisë për miratimin e kërkesave tona nga Këshilli i Ministrave. Kërkesa e sindikatës është që pagat e punonjësve të merren rregullisht, si dhe të rritet çmimi i biletës, dhe të bëhet rimbursimi i tyre. Është i madh numri i personave që përfitojnë nga transporti urban falas siç janë studentët dhe shtresat në nevojë, si dhe nuk bëhet as rimbursimi i aboneve. Na kanë thënë do bëhet ndryshime, por ende asgjë", tha Hasanaj. Shoqata e transportit urban ka kërkuar prej kohësh një rritje të çmimit të biletës në 70 lek, kërkesë që është hedhur poshtë për të disatën herë radhasi. Për këtë arsye, vjen edhe pamundësia e shoqatës për të paguar punonjësit, të cilët kanë zgjedhur të protestojnë dhe të ngrenë zërin për problemin e tyre.

PARALAJMËRIMI

Sipas kreut të Shoqatës, nëse nuk marrin përgjigje për kërkesat e tyre, protestat do të përshkallëzohen, duke paralajmëruar protestë 24-orëshe javën e ardhshme, ndërsa shton se do të përshkallëzohet protestat edhe në linjat interurbane. Protestat e paralajmëruara, 24 orëshe do ishin një dëm i madh i qytetarëve të kryeqytetit të cilët përdorin linjat urbanë për të shkuar në punë apo në shkollë. Mungesa e urbanëve, ka shkaktuar kaos për qytetarët që lëviznin për të shkuar në punë dhe nxënësit që po shkonin në shkollë. Pas kësaj ka reaguar avokati Altin Gxhaj, nga Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorit duke u shprehur se këto greva janë të jashtëligjshme, dhe i krahasuar ato me bllokimet e rrugës nacionale, ku për të goditur një palë të tretë, dëmtohet konsumatori. Ndër të tjera ai shprehet se ZMK konsideron të papranueshme kërkesën për rritjen e çmimit të biletës, të paligjshme dhe të papranueshme grevën e sotme të transportit publik dhe akuzon kompanitë si shkaktarë të vërtetë të dëmtimit të konsumatorëve dhe të punonjësve të tyre.



Qytetarët e Tiranës duke pritur në stacion

Kërkesa
Shoqata e transportit urban ka kërkuar prej kohësh një rritje të çmimit të biletës në 70 lek, kërkesë që deri tani nuk është marrë parasysh

BUJQËSIA

Panariti takon homologun Maqedonas

— Ministri shqiptar i Bujqësisë, Edmond Panariti ka takuar të hënën në Shkup homologun maqedonas Lupço Dimovski, me të cilin ka rënë dakord që përveç thellimit të bashkëpunimit institucional, të nxisin edhe komunitetin e biznesit që të intensifikojë kontaktet për t'i hapur rrugë rritjes së shkëmbimit të produkteve bujqësore. Përmes forcimit të bashkëpunimit në bujqësi, Maqedonia dhe Shqipëria shohin mundësi të mirë për të rritur shkëmbimin tregtar mes dy vendeve. ministri shqiptar intesifikimin e bashkëpunimit në bujqësi e sheh si shumë të rëndësishëm.

MINISTRIA E MJEDISIT

Nesër aksioni për prishjen e subjekteve që shesin inerte

— Nesër Ministria e Mjedisit do të ndërmarrë aksionin për mbylljen dhe prishjen e aktiviteteve që shfrytëzojnë burime inerte në mënyrë të paligjshme. Këto aktivitete të njohura ndryshe si guroret, kanë pasur si afat për çmontimin e pajisjeve në mënyrë vullnetare datën 15 dhjetor, që përbënte një afat një mujor të lënë nga vetë Ministri i Mjedisit, Lefter Koka. Aksioni për dhënien fund të këtij aktiviteti që shfrytëzon burimet natyrore për përfitime ekonomike personale do të zhvillohet nesër me datë 18 dhjetor. Ministri Koka, në deklaratën e fundit ku ka folur për guroret, është shprehur se Inspektoriati në Ministrinë e Mjedisit do të prishë çdo aktivitet që nuk është tërhequr vullnetarish brenda afatit, pa asnjë llojë hezitimi si dhe në lidhje me mjedisin nuk do të tolerohet askush. Aksioni për pezullimin e aktiviteteve që shfrytëzonin burimet inerte ka nisur rreth një muaji më parë dhe është përqëndruar në Zallherr ku është edhe nje numër i konsiderueshëm subjektesh. Inspektoriati në Ministrinë e Mjedisit, gjatë këtij muaji ka punuar për identifikimin e këtyre pikave në të gjithë vendin. Pas afatit një mujor, guroret do të prishen dhe për këto do të kërkohet një revokim i lejes mjedisore. Ministria e Mjedisit është duke punuar për identifikimin dhe përcaktimin e zonave të caktuara ku do të mund të zhvillohet ky aktivitet si dhe ai i furrave të gëlqeres. Koka ka shprehur vendosmëri për ruajtjen e mjedisit dhe mos tolerimin e çdo individi që synon ta cënojë atë.





Apeli

MIRANDA GJONI
VLORË

Ministri i Shëndetësisë Beqaj do vizitojë vogëlushin e sëmurë

Vijojnë ndihmat për 3 vjeçarin me HIV AIDS

Në Shqiptarja.com, pako në emër të familjes

Ministri i Shëndetësisë është bashkuar me dhjetra shqiptarë nga shumë qytete por dhe diaspora që kanë mbështetur financiarisht dhe kanë dhënë kontributin e tyre në ndihmë të djalit 3 vjeçar nga Vlora të infektuar me HIV/AIDS. Ministri i Shëndetësisë, Ilir Beqaj ka premtuar se do të vizitojë 3-vjeçarin e sëmurë me HIV/AIDS në Vlorë. Lajmin e ka konfirmuar Ministri dje në mbrëmje duke shtuar se e viziton fëmijën me rastin e ditëlindjes, dhe pikërisht me datë 21 dhjetor.Apelit në Shqiptarja.com dhe A1 Report i janë përgjigjur shumë shqiptarë duke dhënë kontributin e tyre financiar në numrin e llogarisë së hapur në emër të gjyshes së djalit 3 vjeçar.Historia e gjyshes 64-vjeçare nga Vlora, F. R., e cila pas vdekjes së të bijës nga SIDA i duhet të kujdeset për nipin 3-vjeçar , djalin e vajzës, mbartës i virusit HIV por dhe 2 motrat e tij më të mëdha, ka prekur shumë njerëz. Ata janë solidarizuar



për t'i kthyer shpresë dhe buzëqeshje kësaj familje. Në prag të festave të funditvitit kjo ka nxjerrë dhe një herë në pah humanizmin e shqiptarve. Edhe redaksia e "Shqiptarja.com" dhe "A1Report" kanë dhënë kontributin e tyre, ndërkohë që ka pasur dhe qytetarë të cilët kanë sjellë në redaksi pako me dhurata në emër të vogëlushit 3 vjeçar. Historia u publikua në emisionin "Urbanika" të televizionit A1 Report më 5 dhjetor. Më pas komentues të shumtë në faqen online të "Shqiptarja.com" shprehën vullnetin dhe gatishmërinë për të ndihmuar ekonomikisht familjen, por për këtë i'u nevojitej një numër llogarie. Televizioni A1 Report u kujdes edhe për zgjidhjen e këtij problemi, teksa korrespondenti ynë në Vlorë, Armand Xheliaj shkoi në shtëpinë e F. R. dhe i komunikoi asaj dëshirën dhe vullnetin e shqiptarëve për ta ndihmuar dhe nevojën për hapjen e një numri llogarie. 64-vjeçarja, e shoqëruar nga gazetari i televizionit u paraqit në një prej filialeve të Intesa San Paolo Bank në këtë qytet ku dhe u hap llogaria bankare. E moshuara falenderon nga zemra të gjithë ata persona që janë bashkuar për t'ia lehtësuar dhimbjen e saj dhe bën apel për të gjithë ata që kanë mundësi të kontribuojnë për t'ia lehtësuar sadopak problemet kësaj familjeje. Ndërkohë apelit të të moshuarës i janë përgjigjur shumë shqipëtarë brenda dhe jashtë vendit, të cilët janë shprehur të gatshëm për t'i ardhur në ndihmë kësaj familjeje dhe tre vjeëarit të sëmurë më HIV/AIDS.


NDIHMA

Edhe redaksia e "Shqiptarja.com" dhe "A1Report" kanë dhënë kontributin e tyre në ndihmë të vogëlushit nga Vlora



Facebook

Berisha: Heqja e shpërblimit, kartolina e vitit të ri nga qeveria Rama-Meta



Ish Kryeministri ka reaguar në profilin e tij në facebook, ku ka shprehur se qeveria po përdor fondin e parashikuar për shpërblimin e administratës për të paguar personat me aftësi të kufizuar

NGA SALI BERISHA

Administrata pa shpërblim për festat e fundvitit, një pashpirtësi e vërtetë e qeverisë Rama - Meta.

Te dashur miq, kete vit administrata e Shqiperise do te jete e vetmja ne Europe dhe ndofta ne bote qe nuk do marre shperblimin e fundvitit. Kjo sepse qeveria Rama - Meta ne nje akt pashpirtesie, fondin e parashikuar me ligj per shperblimin e fundvitit te administrates do ta marrin per te paguar personat me aftesi te kufizuar mbasi fondet per keta te fundit jane shperdoruar nga qeveria per zyra, paisje, orgjira, udhetime, etj.

Heqja e shperblimit te fundvitit, qe iu takon me ligj punonjesve te administrates, nga qeveritaret qe kane porositur pushimet e tyre ne hotelet me luksoze te botes eshte kartolina e vitit te ri qe dyshja Rama - Meta u dergon punonjeseve me paga te ulta dhe te mesme te administrates publike. sb

Postuar dje rreth orës 17:00

LAJME
shkurt



Do të ketë reformë e thellë në sistemin arsimor

I gjithë sistemi arsimor në vend do t'i nënshtrohet një reforme të thellë sa u përket teksteve shkollore. Reforma do të nisë që nga parashkollori dhe deri në shkollat e larta ku do të tentohet që fakultetet që përgatisin mësuesit e ardhshëm të fuqizohen. Kurrikula e sistemit arsimor nëntevjeçar do të pësojë ndryshime të mëdha, në mënyrë që të ulet mbingarkesa, të mos ketë përsëritje dhe të jetë më afër nxënësit. Gjithashtu tekstet tona do të përafrohen me ata të Kosovës, duke bërë që të dy vendet të shkëmbejnë mes tyre eksperiancat më të mira. Mësohet se pjesë e rishikimit të kurrikulave arsimore do të jetë edhe Alterteksti, ku pas një tryeze me specialistë të fushës do të vendoset për vazhdimsinë e tij.




Pogradec, protestojnë të larguarit nga puna


78 punonjës të administratës publike, në qytetin e Pogradecit, të larguar nga puna ditët e fundit kanë dalë në protestë për shkak të largimit nga puna. Ata thonë se janë hedhur në mes të katër rrugëve pa asnjë motiv dhe janë zëvendësuar nga militantë të Partisë Socialiste. Ata thonë se nuk u është dhëne asnjë shpjegim apo motivacion për këtë largim por vetem iu është komunikuar ndërprerja e marrdhënieve të punës. Gjithashtu, sipas tyre, jane zëvendësuar në detyrë nga militantë të PS-së.Kryetari i PD-së së Pogradecit në mbështetje të protestuesve, u ka bërë thirrje drejtuesve të institucioneve të ndalin revanshin politik. 78 të larguarit nga sektorët e shëndetësise, pyjorja, ujësjellesi apo CEZ, kanë depozituar padi civile në Gjykatën e Pogradecit.

Kufiri

MARIGLEN MULLA
GREQI


Elias Kosteni


Elvis Collaku


Melsi Collaku

Kriminaliteti
Në Prespë kalojnë ngarkesa droge, armësh dhe emigrantësh, pas mbylljes së Portit të Igumenicës. Aty kalojnë çdo ditë më shumë se 6.000 njerëz.

Ç'ndodh me peshkatarët në Prespë, ku u vranë 3 për rrjetat

Mespërmes "ferrit" në kufirin shqiptaro-grek

Kryepolici grek merr ngushëllime për oficerin


Nga takimi Tiranë, javën e kaluar

Perspektiva e krijimit të një qendre të përbashkët koordinuese për bashkëpunimin policor dhe doganor në kufijtë tokësorë të Greqisë dhe Shqipërisë e kryesisht çështjet e krimit ndërkufitar ishin të fokus të takimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Greke Nikolaos Papagianopoulos, homologut shqiptar Artan Didi, ambasadorit grek në Tiranë, Leonidhas Rokanas dhe Ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri. Nga ana tjetër, mediet greke pasqyrojnë realitetin në pikat kufitare. E përditshmja greke "TaNea" zbardh detaje nga takimi, ku u diskutua përmirësimi i sistemit të shkëmbimit të drejtpërdrejtë të të dhënave, sidomos në rastet e krimeve të individëve ose bandave. E përditshmje greke shton se kryepolici i tyre tha se kriminelët shqiptarë të kërkuar në Greqi dhe Europë, gjejnë strehë në Shqipëri dhe se kërkohet arrestimi i tyre. "TaNea" shkruan se përfaqësuesit e autoriteteve shqiptare shprehën ngushëllimet e tyre për vrasjen e policit grek Elias Kosteni në Vrontero të Follorinës, në përplasje me 2 vëllezërit shqiptarë Melsi dhe Elvis Çollaku. Ndërkaq, "Real.gr" shkruante dje se në "vreshtin e parrethuar" është kthyer kriza, ku i referohet kufirit greko-shqiptar, Prespë. Heqja e njësive ushtarake nga Kosturi dhe reduktimi i rojeve kufitare, kanë çuar në prerjen e pothuajse të përditshme të paligjshëm të pyjeve. Në shpatet e prefekturës së Kosturit, në kufi me Shqipërinë, janë pastruar rreth 5.000 hektarë pyje, ndërkohë që, sipas policisë, bandat e organizuara, korrin fitime që arrijnë në 1.8 milion euro. E përditshmja tjetër greke "Kathimerini" ka bërë një reportazh dje për Prespën, kufirin greko-shqiptar. Liqeni, në jugperëndim ngushtohet dhe shkon për disa qindra metra në territorin shqiptar. Para se ta kalojë këtë pikë të kufirit, peshkatari Christos Konstandinidis, nga Mikrolimni, lë varkën në breg. Me aktivitet artizanal, të vogël ai ecën tani midis lisave dhe një kasolleje, pikërisht aty ku u vranë të dielën e kaluar polici grek dhe 2 shqiptarët. E përditshmja greke shkruan se peshkatarët shqiptarë e quajnë plotësisht të pambikëqyrur pjesën greke dhe hynë në kufi për të vjedhur rrjetat e peshkatarëve. Në këtë zona kufitare, raportet tregojnë për lëvizjen e drogave, armëve dhe emigrantëve. Christos Konstandinidis është 35 vjeç dhe disa vite më parë vendosi të vendosej përgjithmonë në Mikrolimni, në Prespën e Vogël, një fshat me 40 banorë. Çdo mëngjes hedh rrjetat për kapjen e krapit dhe për ta shitur në Kostur dhe Follorinë. "Për herë të parë unë po përdor një varkë me motorr"-thotë ai. Ndërkaq, Elias Anastasiout, i cili gjithashtu jeton në Mikrolimni, i janë vjedhur 120 rrjeta, me dëme deri në 10.000 euro, një pasuri për një peshkatar. Jeta e peshkatarëve në Prespë mbetet e vështirë dhe monotone. Babai i 2 vëllezërve shqiptarë kishte punuar gjatë viteve të stuhishme të imigrimit të lartë të shqiptarëve dhe të gjithë e përshkruajnë atë si një njeri paqedashës. Djali i madh ishte akuzuar në të kaluarën për kontrabandë emigrantësh dhe një vjedhje të vogël. Ata shkuan me anije në pjesën greke, për të vjedhur rrjetat e krapit.

PRESPA

Peshqit që rriten atje, çmimet dhe projektet



I famshëm për krap, liqeni i Prespës preferohet nga peshkatarët dhe tregtarët e peshkut që e shesin në 4-5 paund një kg. Në liqen ka edhe sardele, ku disa prej të cilave eksportohen në Francë, ndërsa rrjetat e peshkatarëve kapin edhe flutura, që shiten me në 0.70 euro, të sjella nga Kina në fermat shtetërore të bregut shqiptar, të lëshuara në liqen, pas rënies së regjimit komunist. Peshkimi në Prespë ndalon në fund të pranverës për riprodhim. Sipas kreut të Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Prespës, Nick Giannakis, niveli i cilësisë së ujit mbetet i lartë. Ky liqen është i mbrojtur nga konventat ndërkombëtare mjedisore, pasi Parku i Prespës regjistron më shumë se 260 lloje zogjsh, shumë nga të cilat janë të rralla në të gjithë botën. Të paktën 11 milionë kushton projekti për Prespën e Madhe, e përbashkët me Greqinë, Shqipërinë e Maqedoninë, për menaxhimin racional të burimeve ujore në një zonë të kultivuar prej 16.000 hektarë.

ALBANA VOKSHI:

Distancohem nga kushërira Në burg kontrabandistët

Ditën e djeshme, deputetja e Partisë Demokratike Albana Vokshi ka reaguar lidhur me përmendjen e emrit të saj në median tonë, në shkrimet, ku vihej në dukje lidhja e saj farefisnore me një nga personat e implikuar në kontrabandën e naftës dhe alkoolit nga Mali i Zi drejt Durrësit, konkretisht qytetaren Zyhra Vokshi. Nga ana tjetër gjykata la në burg të arrestuarit. Deputetja e PD-së vë në dukje se, pa mohuar lidhjen farefisnore me kushërinë e saj, dëshiron të distancohet publikisht nga çështja e dyshuar e kontrabandës, si dhe u bën thirrje organeve të drejtësisë që të kryejnë punën e tyre pa asnjë lloj hezitimi dhe pa asnjë lloj ndikimi nga kushdo qoftë. Ajo shprehet se nuk ka asnjë lidhje me aktivitetin, për të cilin dyshohet se është e implikuar kushërira e saj. Ndërkaq, gjykata ka dhënë masën e sigurisë me 30 ditë burg për Zyhra Vokshin dhe të tjerët e arrestuar.

Seanca
GREQI

Vriste burrat, këtë javë gjyqi për "Vejushën e Zezë"

Minoritarja Evangelia Zhango murosi grekun

Mungesa e avokatit mbrojtës të "Vejushës së Zezë", ka bërë që të shtyhet sërish gjyqi ndaj saj. Minoritarja sarandiote është e akuzuara kryesore për rastin e vrasjes së Tasos Tsagaropoulosm, 42-vjeçarit biznesmen, në maj 2009, në Diakofto, teksa ajo është njohur me nofkën "Black Widow", "Vejusha e Zezë". Gjyqi ndaj Evangelia Zhangës, u shty të premten, për të dytën herë radhazi. Në mënyrë të veçantë, gjykata është informuar se avokati i saj po merrte pjesë në seancën për një rast tjetër penal në Athinë. Si rrjedhojë, vazhdimi i gjykimit të bujshëm është vendosur për të premten më 20 dhjetor.


Evangelia Zhango

Fillimisht mbrojtja e Evangelia, kishte kërkuar shtyrje të gjyqit, një kërkesë që nuk ishte pranuar nga Gjykata. Viktima është "çimentuar" në banjon e një vile luksoze në qershor 2010. Gjithçka u zbulua pas një letre anonime, e cila erdhi në duart e avokates Maria Ekonomi, e cila merrej me rastin e zhdukjes së 42-vjeçarit, ku specifikohej pika në të cilën ai ishte varrosur. Sa i përket historisë së Eva Zhangës, (Evangelia), është mjaft e gjatë dhe e ngarkuar me më shumë se 13 dënime kundër saj për mashtrim të kryer në Kretë, Volos, Selanik dhe Peloponez. Minoritarja nga Thiva e Sarandës akuzohet për vrasjen e 3 burrave, teksa fisi i saj akuzohej për vrasje brenda fisit. Ndërkaq, ajo akuzohet se ka mashtruar dhjetëra qytetarë, sidomos të moshuarit, duke fituar me punët e tyre, pasurinë e jetës së saj. Edhe një gjyqtar mendohet se është mashtruar prej saj, ku i ka marrë 1 milionë euro. Ndërkaq, ajo quhet "Vejusha e Zezë", sepse kur ishte shtatzanë vrau burrin e saj në Shqipëri.

Shkretat në Mamurras i vranë djalin, u vrau babanë e vëllanë

Llani, tutor në Itali kërkohej për 2 vrasje

"Travel sex" zbulon shtatë shqiptarët në Firence

Operacioni
MARIGLEN MULLA
ITALI

Hasmi e kërkonte në Mamurras për ta hequr qafe, kurse ai dhe banda e 7 shqiptarëve shfrytëzonte nja 20 femra si prostituta në Novoli të Italisë. Kjo është historia e Jetmir Llanit, "tmerrit të Mamurrasit", 34-vjeçarit që për t'u hakmarrë ndaj vrasësve të djalit 9-vjeçar, ekzekutoi babain e vrasësve dhe më pas njërin prej vëllezërve Shkreta. Tashmë ai ndodhet në Shqipëri, pasi u ekstradua në janar nga Italia, ku u kap, teksa strehohej tek miqtë, që në këtë rast i bie të qenë qenë tutorët e tjerë dhe kur karabinierët iu afruan për ta prangosur, ai u tregoi fotografinë e djalit të vrarë. Atij tashmë pritet t'i komunikohet zyrtarisht akuza e "shfrytëzimit të prostitucionit", nëpërmjet autoriteteve italiane, të cilat do t'i dërgojnë një letër-porosi të posaçme Ministrisë së Drejtësisë. Në Shqipëri, Llani akuzohet për 2 vrasje dhe vetëm pasi të ketë kryer dënimin këtu, mund t'i hapet rruga procedurës për ta ekstraduar në Itali.


Jetmir Llani







Ekstradimi
Njeriu që "tmerroi" Mamurrasin, pasi i vranë djalin 9 vjeç, i arrestuar prej dy muajsh në Itali, u ekstradua në Shqipëri, më 15 janar 2013.

"Të fala"
Në dëshminë e tij Aurel Shkreta tha se Llani kishte përmendur fjalët "I bëni të fala tim biri në varr", teksa qëllonte në drejtim të tyre, ku një u vra.

Urrejtja
Ajo ç ka ngjizi urrejtjen ishte vrasja aksidentale e djalit të tij, Indrit Llanit, 9 vjeç, në prehrin e nënës në datën 5 qershor 2012, teksa kthehej nga shkolla.





HARAÇI PËR TROTUARIN

Hetimet e operacionit "Travel sex" zgjatën 15 muaj, ku për shfrytëzim prostitucioni në Novoli, u arrestuan 7 shqiptarë mes 21 dhe 34 vjeç. Ky grupi kishte në "pronësi" të paktën 20 prostituta, të gjitha 18 deri në 30 vjeçe, të cilat i nxirrte në trotuaret e rrugës "Guidoni", në veri të Firences, ku i detyronin t'u paguanin nga 50 deri në 100 euro në ditë. Nëse gratë refuzonin, ata i rrëmbenin dhe i detyronin të hipin në makina, duke i kërcënuar me armë. Gratë ishin të detyruara të paguanin në bazë të numrit të klientëve të tyre, gjatë një dite të zakonshme. U sekuestrua një pistoletë e kalibrit 6,35, e modifikuar dhe rreth 7 mijë euro. "Firenzetoday.it" shkruante dje se hetimi filloi në shtator 2012, i kryesuar nga zëvendëskomisari Erminia Del Prete. "Ky grup kriminal, në fakt kishte fituar një lloj pronësie në të gjitha zonat përgjatë rrugës Guidoni, duke lëshuar lejë të vërtetë për prostitucion në zonë"-thuhet në urdhërin e burgimit me arrest, të lëshuar nga hetuesja Erminia Bagnoli dhe gjyqtari Leopoldo De Gregorio. Nga mijëra orët e përgjimit, janë zbuluar edhe detaje që inkriminojnë grupin. Në pranga ranë Hasim Biku, 21 vjeç, Klinsman Ivanaj, 23 vjeç, tashmë në "arrest shtëpie" për "vrasje në tentative, Shkëlzen Guri, 29 vjeç, Renato Çeta, 29 vjeç dhe Aldo Memushai 27 vjeç, që besohet të jetë kreu i organizatës kriminale.

LLANI DHE VRASJET NË MAMURRAS

Jetmir Llani është prangosur më 20 nëntor 2012, teksa udhëtonte me një makinë në Firence të Italisë. Aty ai u tregoi policëve foton e të birit që është vrarë nga anëtarët e familjes Shkreta. Jetmiri, në kryeqytetin toskan ka një numër të madh miqsh si dhe një të afërm, te i cili kishte jetuar kohët e fundit, teksa ndodhej në kërkim. Tashmë, konfirmohet fakti se Llani ishte "i angazhuar" në grupin e prostitucionit. Ai u ndal në lagjen "Viale Belfiore" të Firences. Mediet italiane thanë se në çastin e arrestimit Jetmiri nuk lëvizi as qepallën. Ai tërhoqi një foto të djalit të tij nga portofoli dhe ua tregoi atë policëve duke u thënë: "Ai nuk jeton më". Më 5 qershor, djemtë e familjes Shkreta përgatitën atentatin ndaj ish-shokëve të fëmijërisë. Rreth orës 14:00 Muharrem Llani, 22 vjeç, bashkë me kunatën kishte marrë në shkollë në qytetin e Mamurrasit nipin 9 vjeç dhe fëmijë të tjerë dhe po kthehej me makinën e tij "Ëosksvagen" në shtëpi, në Shpërdhet të Kurbinit. Në afërsi të Urës së Drojës, në Fushë-Mamurras u është zënë pritë nga dy vëllezërit. Endri 9 vjeç ndërroi jetë brenda pak minutash, ndërsa xhaxhai u plagos. Autorë ishin vëllezërit Altin dhe Oligert Shkreta, të cilët u arrestuan. Më 19 korrik Mark Shkreta, 71 vjeç, babai i dy djemve të akuzuar për krimin ndaj 9-vjeçarit u ekzekutua në mes të Tiranës, në rrugën "Hoxha Tahsim". Në të njëjtin vend ku u vra 9-vjeçari Endri Llani, më 5 tetor 2012, humb jetën në pritë 31-vjeçari Gentian Shkreta dhe plagoset i vëllai, Emanueli, 29 vjeç. Llani, dyshohet se i ka zënë pritë.

"Ishte aksident, s'doja ta vrisja shqiptarin"

Dëshmia e italianit nga qelia, qëlloi 25-vjeçarin në shtëpinë e të vëllait

Vrasja
ITALI

Ishte një goditje aksidentale, krejt gabimisht". Kështu shprehet nga qelia Mirko Franzoni mbron nga qelia e tij, ku është ndaluar që të dielën në mëngjes për vrasjen e shqiptarit. "Unë nuk doja ta vrisja, vetëm sa doja të merrja përsëri gjërat e mia"- thotë 29-vjeçari që në Serle, natën e së shtunës vrau me një pushkë një djalë 25-vjeçar shqiptar, që e kishte kapur duke vjedhur në shtëpinë e vëllait të tij. Co Franzoni, avokati i tij do të rindërtojë skenën kur dy hajdutët kishin hyrë për të vjedhur. Në dëshminë e tij Franzoni thotë se "I thashë një burri që ishte në dritare që të lajmëronte policinë". Por vjen edhe dëshmia e vëllait të të akuzuarit. "Vëllai im është djalë përsëmbari dhe kjo është jashtë çdo dyshimi. Është një veprim që nuk i përket". Kështu ka dëshmuar Ezio Franzoni, 37 vjeç për vëllain e tij, Mirkon një mekanik, partner me të. Mirko Franzoni jetonte me babain e tij Eugenio dhe nënën Paola, në numrin 66, në rrugën "Marconi". Pas kthimit nga gjuetia, babai dhe djali arritën në shtëpinë e Ezios, 2-katëshe, teksa Ezio ishte jashtë për pazar. Në mbrëmje do të festonte ditëlindjen e gruas së tij, Paola. Hajdutët kishin hyrë në dhomën e gjumit, ku kishin marrë sende ari. Njëri u vra, tjetri iku.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në zbatim të ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", **Departamenti i Administratës Publike** shpall konkurimin për **1 vend** të lirë në pozicionin:
Specialist në Sektorin e TI në Drejtorinë e Shërbimeve, në **Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë**.
Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në Shërbimin Civil në përputhje me nenin 12 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 «Statusi i nëpunësit civil».

KËRKESA TË VEÇANTA PËR KANDIDATËT
- Të ketë mbaruar arsimin e lartë (për nivelin e diplomave referojuni Udhëzimit nr. 4 dt. 17.02.2010)
- Të ketë eksperiencë pune në fushën e teknologjisë së informacionit dhe marrëdhëniet me mediat (pasi pozicioni i punës mbulon kryesisht marrëdhëniet me mediat dhe përditësimin e përmbajtjes së faqes së internetit të institucionit në lidhje me njoftimet për median dhe publikun)
- Të zotërojë gjuhën angleze.
- Të përdorë programet bazë të punës në kompjuter
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup

Paga e pozicionit është në kategorinë III - b

Paraqitja e dokumenteve:
Kandidati duhet të paraqesë brenda **datës 15.01.2014 në Kutinë Postare Nr.1751,** këto dokumenta: kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të diplomës dhe librezës së notave, të librezës së punës, certifikatave të kualifikimit, dëshmive të gjuhëve të huaja dhe kompjuterit, vërtetimin e gjendjes gjyqësore si dhe të paktën një letër rekomandimi, një numër telefoni për tu kontaktuar si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit. (Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit).

KONKURIMI është i hapur për nëpunësit civil të të njëjtës klasë me procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë. Nëse vendi nuk plotësohet nga këta kandidatë, konkurimi zhvillohet me kandidatët jashtë Administratës Publike, sipas procedurave të shërbimit civil.
Pas verifikimit paraprak, **me datë 21.01.2014** në selinë e **Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë** si dhe në www.pad.gov.al, do të shpallet lista e konkurentëve, që do të vazhdojnë më tej konkurimin si dhe data kur do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista me gojë. Konkurimi do të bazohet në njohuri të përgjithshme, kodin e procedurave administrative, Ligjin nr. 9131 dt. 08.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike", Ligji nr. 8503 dt. 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare" si dhe Ligji nr. 9367 dt. 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", Ligj nr.9049 dt. 10.4.2003 "Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë"

Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, rezultatet e verifikimit paraprak si dhe datat kur do të zhvillohen testimet, mund t'i gjeni në adresën e Web Site të Departamentit të Administratës Publike www.pad.gov.al.

ADRESA: BULEVARDI "DËSHMORËT E KOMBIT", TIRANË, SHQIPERI, KUTIA POSTARE NR. 1751 TEL/FAX: +355 4 251241, 235937 - WWW.PAD.GOV.AL

KUJTIMET E NJË GAZETARI

PJESA E FUNDIT *e pasazheve të zgjedhura nga kujtimet e gazetarit dhe deputetit Zoi Xoxa. Peripecitë e përballjes me mediat, dhe kapriçot e pafund të princeshave....*





NË FOTO: Princeshat në vitin 1938 gjatë vizitës së tyre në Uashington

Zoi Xoxa: Princeshat nuk e donin shoqërinë e grave të bukura

Në Paris madamë Vilën e përflisnin, ndërsa në Suedi s'mund ta shihnin dot me sy çupën e konsullit Gardlung, të cilën e quanin "lopa"…

NGA DR. ZOI XOXA
TIRANE

Në Kopenhagë

Në mbrëmje arritëm në Kopenhagë. Kur hodha sytë nga dritarja e trenit, u tmerrova: stacioni ishte mbushur sa nuk kishe ku të hidhje kokrrën e mollës. Kureshtja për të parë princeshat e një vendi oriental, të cilin ata nuk e njihnin aspak ose e kishin dëgjuar si një vend të egër dhe prapanik i kish shtyrë kopenhagasit të dilnin, i madh e i vogël, për të parë me sytë e tyre si do të qenë këto princesha. Por e mblodha veten. U thashë princeshave të mos hutoheshin, të mbanin gjakftohtësinë dhe të silleshin me dinjitet. Konsullit dhe zonjës Gomboes u thashë të bënin nderimet e shtëpisë dhe të na prezantonin me autoritetet, që do të kishin dalë të na prisnin.

Konsulli dhe zonja Gomboes do të dilnin përpara, princeshat pas tyre dhe unë me Noçkën në fund. Me të zbritur në platformën e stacionit, princeshat ndaluan dhe unë e Noçka i vumë në mes. Autoritetet iu afruan sipas gradës së pozitës së tyre dhe u shtrënguan dorën princeshave, duke u thënë fjalë mirëseardhjeje: përfaqësuesi i Pallatit mbretëror, ministri i jashtëm me zonjën, përfaqësues të trupit diplomatik të akreditur në Kopenhagë. Konsulli Gomboes ishte i mrekullueshëm: ai na i paraqiste një nga një, pa u hutuar fare, modest dhe me buzën në gaz, sikur këtë punë e bënte përditë dhe s'i kushtonte asgjë. Fotoreporterët, me qindra, kishin hipur kudo, edhe sipër çatisë së trenit, dhe shkrepnin aparatet e tyre fotografike, duke i shoqëruar me një dritë verbuese magneziumi.

Më në fund Konsulli me zonjën Gomboes, duke udhëhequr princeshat, çau rrugën midis tërë atij kallabalëku, që u nda më dysh për t'i lënë princeshat të kalojnë, dhe u drejtua për nga dalja e stacionit. Këtu ishte radhitur një sërë e pambaruar veturash. Konsulli kishte porositur dy vetura për ne: në një hipën princeshat me zonjën Gomboes dhe në tjetrën, unë, Noçka dhe konsulli. Vargu i vetura u drejtua për në hotel, i ndjekur nga të dy anët nga shumë motoçikleta.

Edhe përpara hotelit ishte grumbulluar një



Zoi Xoxha

popull i madh, që duartrokiste.

Hymë në hotel, një hotel me pastërti shembullore, dhe u drejtuam për në "holl". Asnjë nga autoritetet nuk zbriti me ne. Konsulli na shpjegoi se ishte zakon të mos i bezdisnin mysafirët, të cilët kishin nevojë për t'u çlodhur, dhe vetëm të nesërmen do të përgatisnin programin e vizitave.

U kënaqa që mbetëm vetëm dhe sikur mora frymë lirisht. I pyeta ç'dëshironin dhe porositëm nga një çaj me konjak. Konsulli Gomboes na tha se sonte do të kalonim një mbrëmje të bukur në Teatrin Kombëtar, ku kishte porositur dy lozha. Në këtë premierë të "Lohengrinit" do të merrte pjesë edhe familja mbretërore, edhe trupi diplomatik.

Mirëpo, për fat të keq, kishte vdekur mbretëresha e Norvegjisë, që ishte e motra e mbretit të Danimarkës. Pra, Pallati ishte në zi dhe, për respekt, nuk do të merrte pjesë as trupi diplomatik. Natyrisht nuk do të merrnim pjesë as ne. Por populli ishte i lirë të merrte pjesë. Pas pak konsulli dhe zonja Gomboes na kërkuan leje të largoheshim, se princeshat ishin të lodhura dhe kishin nevojë të shplodheshin.

Me t'u larguar konsulli dhe zonja Gomboes, Myzejeni më tha që të zija një lozhë dhe të shkonim në teatër. Atë të shkretë teatër e donin shumë: vdisnin për teatër. Por me rastin e vdekjes së mbretëreshës së Norvegjisë, respektuam zinë. Këtë ua sqarova princeshave.

-Ne kemi ardhur të nderojmë emrin e Shqipërisë: Kjo është porosia me të cilën më ka ngarkuar mbreti dhe unë do ta mbaj si amanet.

U ngjitëm në dhomat e fjetjes. Ato ishin mësuar të ngriheshin vonë. Unë u ngrita shpejt dhe në orë tetë zbrita në holl. Pas pak erdhi edhe konsulli Gomboes. Ai kishte krijuar një shërbim të përpiktë shtypi: kishte pajtuar dy persona, që i përkthenin frëngjisht gjithë sa shkruante shtypi i vendit rreth vizitës sonë. Pastaj i priste artikujt e gazetave dhe u ngjiste përkthimin frëngjisht. Këto kupyra unë i ruajta gjer më 7 prill 1939, kur Italia pushtoi Shqipërinë, pastaj i zhduka për arsye politike.

Pra, e pashë konsullin me çantën plot me këto kupyra. Gazetat shkruanin për né plot fjalë të bukura, na jepnin një mirëseardhje të nxehtë, entuziaste; por ajo që na gëzoi shumë ishin lëvdatat që na bënin për pjesëmarrjen tonë në zinë që kish goditur familjen mbretërore, duke mos marrë pjesë në premierat e "Lohengrinit", sado që Konsulli i inderit të Shqipërisë, zoti Gomboes, kishte zënë dy lozha për to.

Po ditën e tretë Gomboes erdhi i zbehtë si një meit dhe po dridhej i tërë. Harroi të më thoshte edhe mirëmëngjes. Dukej se s'kishte fjetur tërë natën, se i dukeshin sytë të fryrë. M'u drejtua, sikur desh të më sulmonte:

-Zoti sekretar, (kështu e paraqita veten në atë udhëtim, si sekretar i princeshave): gazetat më kanë bërë sot për pesë para; por më duket se nuk e meritoj, se unë s'kam munguar çdo ditë të ndodhem këtu, që në orën tetë të mëngjesit. Ju e dini fare mirë. Po unë nuk mundem t'i detyroj princeshat...

Dhe më dha kupyrat e të gjitha gazetave, të përkthyera në frëngjisht. Porosita nga një kafe dhe u thellova në leximin e tyre. Ato e qortonin rreptë konsullin se nuk dinte t'i udhëhiqte princeshat, që dalin vetëm vonë pasdreke, në një kohë kur nuk mund të shikohet asgjë. Konsulli duhet të hartojë një program dhe t'i bëjë princeshat që të vizitojnë muzetë, pinakotekat, bibliotekat, shkollat, industritë, viset tona historike, për të cilat "ne, me të drejtë, jemi kryelartë dhe mburremi që t'ia tregojmë çdo të huaji". Princeshat e Shqipërisë patën mirësinë të deklarojnë, në intervistën e tyre me gazetarët, se kanë ardhur të përfitojnë nga eksperienca dhe nga përparimet tona. Atëherë ç'bën zoti konsull dhe pse, vallë, i mban të mbyllura tërë ditën në hotel ? – etj, etj.

Gratë

Princeshat kishin një munxë: nuk e dëshironin shoqërinë e grave dhe, sidomos, të grave të bukura. Këtë e kisha vënë re që në Paris



Udhëtimi diplomatik

Peripecitë e vizitave në Danimarkë e Suedi

Gazetat sulmuan konsullin se i mbante princeshat mbyllur në hotel, ndërsa princeshat në të vërtetë flinin deri në drekë vonë…

Dhe pothuaj të gjitha gazetat këtë avaz mbanin, sikur ta kishin bërë me fjalë.

Unë u revoltova, u revoltova rëndë. Më erdhi keq për atë konsullin e mirë Gomboes, që s'kishte asnjë faj dhe po hante dru nga shtypi i vendit, vetëm e vetëm për faj të atyre, që donin vetëm të bënin muhabete midis tyre. I thashë konsullit të mos shqetësohej se unë do të gjeja rastin t'i deklaroja shtypit se s'ishte faji i konsullit, që po e kryente detyrën me zellin dhe me përpikërinë më të madhe, Vetëm se vonesat dhe moszbatimi i programit të vizitave ka ndodhur ngaqë njëra nga princeshat nuk e ka ndjerë veten shumë mirë.

Konsulli të shkretë sikur i erdhi gjaku dhe, në shenjë falënderimi, ma shtrëngoi dorën me përzemërsi.

-Tani, ju lutem, më bëni një program të vizitave, që të udhëzohemi se ç'duhet të bëjmë.

-Po e kam gati, zoti sekretar!

Dhe më dha një listë të daktilografuar, të ndarë me ditë dhe me orë.

-Shumë bukur, - i thashë duke marrë programin që kishte përgatitur, - që nesër do ta vazhdojmë pikë më pikë këtë program.

U ngjita te princeshat dhe u përktheva shqip ç'kishin shkruar gazetat kundër konsullit tonë. Kjo s'ishte e drejtë. Ai s'kishte asnjë faj; ai vinte këtu që në pikën e mëngjesit: "ndërsa ju flinit dhe s'deshi t'ju bezdisë. Kjo nuk duhet të përsëritet. Që nesër do ngriheni në orën 7 dhe në orën 8 duhet të fillojmë nga vizitat. Këtu ndodhemi zyrtarisht dhe nuk mund të bëjmë pas qejfit tonë".

-Vështroni! Vështroni! – m'u përgjigjën.

-Po pse s'mendoni që, si të ikim ne, shtypi mund të shkruajë kundër jush një mijë të zeza, siç shkruan gazetat e Amerikës? Askush nuk na detyroi të vijmë. Deshëm dhe erdhëm. Por tani që erdhëm, e kemi për detyrë, me sjelljet tona, ta nderojmë emrin e vendit tonë. Mbreti ka mbetur shumë i pikëlluar nga ato që kanë shkruar gazetat e Amerikës. Ajo punë nuk duhet të përsëritet edhe këtu. Unë këtë urdhër kam marrë dhe do ta zbatoj: Pra nesër në orën 7 të mëngjesit të jeni të ngritura.

Ndërkaq, pas dreke, do të kishim një takim me gazetarët. Këtu ishte frika ime. Sikur ta shkelja me ndonjë përgjigje të pamatur, na rroftë mundi! Duhej t'u shmangesha çështjeve politike, se synimi ynë ishte tjetër. Kështu, kur më erdhën disa gazetarë dhe kërkuan që t'u caktoja një intervistë me princeshat, unë u thashë: "Kur të dëshironi, me kënaqësinë më të madhe". Por shtova menjëherë:

-Ne, të dashur kolegë, kemi një protokoll në Shqipëri, që ju lutemi ta respektoni. Princeshat mbretërore janë të ngarkuara të merren me punë shoqërore. – Princesha Myzejen është kryetare e Artizanatit dhe e Arteve të Bukura; Princesha Ruhije është kryetare e Sportit dhe Princesha Maxhide... nuk po mbaj mend tani e ç'aktiviteti ishte – po jo me politikë. Prandaj, ju lutem shumë të mos u bëni pyetje politike, se nuk do t'ju përgjigjen. E dyta: pyetjet, ju lutem, t'i bëni me shkrim, me qëllim që t'i studiojnë dhe t'ju përgjigjen me kompetencë dhe me data të sakta.

Unë kujtoj se vështirë të gjendet një popull më korrekt se ai i vendeve skandinave: njerëzit, përgjithësisht, s'dinë ç'është gënjeshtra, ç'është mashtrimi, ç'është dredhia. Sapo mbarova fjalë, ata m'u përgjigjën se do ta respektonin protokollin tonë. Dhe asnjëherë nuk kërkuan ta shkelnin. M'i dhanë me të shkruar pyetjet e tyre. Më të shumat rrihnin rreth gjendjes së gruas: ata kishin mendimin se gruaja shqiptare rronte e mbyllur në të katër muret e shtëpisë, nën zotërimin absolut të burrit; që vajzat martoheshin pa e njohur bashkëshortin e tyre; që, edhe kur dilnin, duhej të mbuloheshin me ferexhe të rënda etj. etj. Unë kisha mjaft argumente bindëse që t'i përgënjeshtroja këto njohuri të gabuara. Dhe, midis të tjerave, dy fakte ua shpalosa përfaqësuesve të shtypit, që t'u mbushej mendja se punët ishin ndryshe: U thashë se ne kishim në përdorim Kodin Civil të Zvicrës, nga më të përparuarit; por né shkuam edhe më tej se kodi i Zvicrës. Sepse, për pjesën e detyrimeve, kemi marrë projektin italo-francez, që asnjë shtet s'e ka vënë akoma në zbatim. Sipas këtij kodi, asnjë martesë nuk mund të ketë fuqi, pa u njohur të dy bashkëshortët e ardhshëm dhe pa pëlqimin e çiftit. Sa për atë që gratë tona ndenjkan mbyllur dhe dalkan me ferexhe, unë di që këtu në Kopenhagë ju kini, në Trupin Diplomatik shumë persona që kanë qenë përfaqësues të shtetit të tyre në Tiranë. Pyetini dhe do t'ju thonë se sallat e Pallatit mbretëror, të bashkisë dërgoja rregullisht në Tiranë.



Psonisjet

Madama Vila, që ishte franceze, dhe e njihte mirë Parisin, u shërbente dendur si "komisionere" për psonisje të ndryshme

ose të Institucioneve të tjera mbushen me gra elegante dhe dekolté ditët e festave kombëtare ose ditët e tjera solemne. Gratë dhe vajzat tona dinë të dancojnë më bukur edhe se shumë gra të Perëndimit. Vallet tona kombëtare, pastaj, kanë një bukuri folkloristike të tillë që meritojnë të njihen dhe të përshkruhen nga ju. Në emër të princeshave, unë i ftova të na vinin mysafirë në vendin tonë, ashtu siç kemi ardhur né në vendin e tyre. Duhej të na këmbenin vizitën, - përfundova duke qeshur.

Ata mbetën vërtet të kënaqur. Gazetat shkruan bukur për vendin tonë.

Më në fund, përpara se të largoheshim, unë e quajta me vend të mbaja vetë një konferencë shtypi, por këtë radhë jo si sekretar i princeshave, por si gazetar. Ia bëra të ditur këtë dëshirë konsullit Gomboes, i cili foli me kryetarin e sindikatës së shtypit. Ata e pritën me kënaqësi dhe, për shkak të një pjesëmarrjeje të madhe, më ftuan të flas në sallën e konferencave të shtypit.

Desha t'u jap një ide të qartë mbi historinë e Shqipërisë, mbi lashtësinë e saj dhe mbi përparimet e arritura. Këto desha të qenë sa më të dokumentuara e bindëse, sepse e dija që gazetarët do t'i përdornin gjerësisht. S'e kisha të rëndë t'i dokumentoja, se lashtësia e Shqipërisë është historikisht e njohur dhe, sa për përparimet e tanishme, u bazova më shumë në legjislacionin në fuqi, meqë ligjet janë pasqyra e përparimit të një vendi. Për fat të bardhë, që më 1929, ne kishim vënë në fuqi kodet nga më të përparuara që njiheshin, si kodin Civil, të marrë nga Zvicra, Kodin Penal, të marrë nga Italia, dhe Kodin Tregtar, të marrë nga Projekti i Prof. Vivantes, më i përparuari i të gjitha kodeve tregtare të botës.

Konferenca ime bëri përshtypje të mirë dhe këtë e vura re jo vetëm nga vëmendja me të cilën më dëgjuan, por edhe nga përshkrimet që bënë të nesërmen në gazetat e tyre. Isha shumë i kënaqur: Ky ishte qëllimi i këtij udhëtimi; dhe qëllimi më duket se u arrit. Të gjitha kupyrat e gazetave unë i

Në Suedi

Konsulli dhe zonja Gomboes na shoqëruan gjer në Malmo, ku kishin dalë të na prisnin konsulli ynë i nderit në Stokholm dhe zonja Gardlung me të bijën. Këtë prindërit e kishin marrë si interprete, pse e dinte frëngjishten fare mirë.

Konsulli Gardlung ishte një sportdashës i zjarrtë. Ai kish qenë nja dy herë në Shqipëri dhe kish marrë edhe një skuadër sportistësh shqiptarë që të vizitonin Suedinë. Mua më tërhoqi menjëherë bukuria e vajzës së Gardlungut: një bukuri nordike e ftohtë, po joshëse. Ishte një leshverdhë nja 12 vjeçe, po dukej si 22 vjeçe. Mua më kënaqte shoqëria e saj dhe isha gjithnjë në kontakt me të, pse ishte e vetmja që dinte frëngjisht dhe për çdo gjë duhej t'i drejtohesha asaj.

Por princeshat kishin një munxë: nuk e dëshironin shoqërinë e grave dhe, sidomos, të grave të bukura. Këtë e kisha vënë re që në Paris. Noçka vetëm dy herë e kishte sjellë të shoqen në hotel Vandomë, të takohej me princeshat. Edhe ai e kish kuptuar se ato nuk e donin shoqërinë e grave dhe pothuaj kurrë nuk e ftonin me gruan. Gjithashtu në Paris kishim edhe madamë Vilën, të shoqen e ministrit tonë në Francë. Madama Vila, që ishte franceze, dhe e njihte mirë Parisin, u shërbente dendur si "komisionere" për psonisje të ndryshme. Ajo bëhej copë që t'u shërbente sa më mirë, megjithatë ato nuk e donin dhe e përflisnin.

Tani s'mund ta shihnin dot me sy çupën e zotit Gardlung, të cilën e quanin "lopa".

-Po ç'keni me të? – u thosha unë. – Ajo është e vogël, megjithëse është me trup të zhvilluar, si gjithë nordiket. Ama po bëhet copë që të na shërbejë sa më mirë.

-Pse, të pëlqeka ty ajo "lopë"? Neve s'na pëlqen.

-Ne s'kemi ardhur këtu që të pëlqejmë çupat, po që të kryejmë qëllimin tonë.

Kosnulli Gardlung i njihte princeshat që në Tiranë dhe na kënaqi duke kujtuar ngjarje dhe kuriozitete nga Shqipëria. E bija nuk lodhej së përkthyeri frëngjisht dhe unë shqip.

Të dy konsujt, Gomboes dhe Gardlung, ishin marrë vesh mbi mënyrën e pritjes së princeshave, prandaj edhe pritja në Stokholm qé më tepër se e përzemërt. Nuk po zgjatem këtu, se këtë përshkrim e kemi në gazetën "Drita".

Harrova të shënoj se në Tiranë Asim Jakova, ai që kish shoqëruar princeshat në Amerikë, më kish thënë se kishte gjetur belanë nga gazetarët. Këta merrnin drejtpërdrejt princeshat në telefon (jashtë të gjitha dhomat e hotelit kanë telefon) dhe i pyesnin për gjepura: i pyesnin se ku i kishin blerë kapelat, këtë sahat, këto këpucë etj. Dhe, nga një përgjigje që merrnin me vend a pa vend, të nesërmen thurnin nëpër gazeta një roman të tërë fantastik.

-Po pse s'e pretë telefonin nga dhomat e tyre? – e kisha pyetur Asimin aty për aty.

-Hë, ke të drejtë! Si s'na vajti mendja?

Duke mbajtur mend këtë ngjarje, unë me të vajtur në hotel, në Kopenhagë, i kisha thënë drejtorit të priste telefonat nga dhomat e princeshave dhe të linte të funksiononte vetëm telefoni i dhomës sime.

Kështu bëra edhe në Stokholm, sado që tani, që kisha njohur gazetarët e Danimarkës, më dukej se s'ishte nevoja e këtyre masave paraprake, meqë gazetarët skandinavë ishin krejt të ndryshëm nga gazetarët amerikanë: këtyre të fundit u pëlqenin lajmet sensacionale, përshkrimet aventureske, ai që quhet "shtypi i verdhë", për të tërhequr sa më shumë lexues, për të shitur sa më shumë gazeta; kurse atyre u pëlqente serioziteti, ndershmëria, të qenët profesionalë e të përkorë.

» DORËSHKRIMI

"RIMARI" *i Alfons Dovanës, i vetmi i këtij lloji i përgatitur në vendin tonë vazhdon të ruhet nga familjarët e tij. Dy vëllime me 75 kapituj, dhe përkatësisht me 416 dhe 619 fletë të shkruara në makinë shkrimi para 60 vjetëve*



Alfons Dovana me nënën në Itali



Alfons Dovana diten e fejesës



Alfons Dovana

Alfons Dovana, autori i "Rimarit" të pabotuar

Rrëfimi i së bijës: Persekutimi dhe vështirësitë në të cilat u hartua 'Rimari i gjuhës shqipe' dhe veprat e tjera të babait

GËZIM KABASHI
TIRANE

Alfons Dovana vdiq më 29 dhjetor të vitit 1967, vetëm dy ditë pasi bashkëshortja dhe dy fëmijët e vegjël i kishin uruar në barakën e ftohtë të familjes, 49-vjetorin e lindjes së tij.

Pinjoll i njërës prej familjeve të njohura tregtare në Durrës, Alfonsi i sëmurë me zemër, ishte i detyruar të flinte prej disa ditësh në kuzhinë, atje ku ishte pak më ngrohët se në pjesën tjetër të shtëpisë me llamarina. Historia e jetës së Alfonsit është e ngjashme me atë të mjaft familjeve të pasura në Durrës, e në të njëjtën kohë është po aq e veçantë, sa të duket se po ndjek fillin e një historie Krishtlindjesh.

I arsimuar si ekonomist në Milano ai punoi shumë pak kohë në drejtimin e shoqërisë aksionere "Vëllazën Dovana". Jeta e tij ndryshoi katërcipërisht kur pushtetin e morën komunistët, të cilët pasi konfiskuan të gjitha pronat, kalbën në burgje shumë prej tyre. Burrë i pashëm, elegant dhe sqimatar, administratori i firmës tregtare do t'i kishte humbur lidhjet me botën, nëse nuk do t'i kishte ardhur në ndihmë kultura e tij. Për vite me radhë ai hodhi në letër gjithçka kishte mësuar e po mësonte mbi letërsinë, historinë dhe mitologjinë, duke përmbushur profecinë e një poeteje të njohur italiane, e cila pas një bisede të gjatë në Milano i kishte thënë: -Çfarë bën në fakultetin e Ekonomisë një djalë si ti?!

PALLTOJA E BURGUT

Ndër pesë fëmijët e Vlash Dovanës dhe Mellani Terkës (një tjetër mbiemër i dëgjuar tregtarësh dhe politikanësh në Durrës), Alfonsi vinte i treti. Vëllai tjetër, më i madhi i fëmijëve, Nik Dovana, ka hyrë në historinë e sportit durrsak si futbollisti i mirënjohur dhe filantropi i skuadrës, aq sa stadiumi i vetëm i qytetit prej 20 vjetësh ka marrë emrin e tij.

Tre motrat, Ksantipi, Elsa dhe Belina patën secila fatin e vet, mjaft të afërt me pjesëtarët e tjerë të familjes.

Alfonsi nuk i kishte kaluar 30 vjetët, kur u arrestua dhe dënua me burgim të përjetshëm. Pas kësaj ai do të falej dhe do të dënohej disa herë. Në qelinë e ftohët do ti "këndojë" kështu palltos, të cilën e kishte veshur për herë të parë dhëndër:

Sikur të kishe gojë do flisje si jam dridhur,
Me pranga e zinxhirë dhe këmb' e duar lidhur,
Atje n'ato bodrume, nën tokë, në qeli,
Me muaj kur qëndronim, së bashku në vetmi!

(O pallto e bekuar)

Ishte në burg, kur u bë baba për herë të parë në vitin 1951. Kur morri lajmin nga nëna e tij, mbi kapakun e paketës së cigareve e kishte shkruar dukshëm emrin "Vlash". Pasardhësi i tij, do të mbante përjetë emrin e gjyshit të nderuar.

Kur del nga hapsana, Alfons Dovanën e dërgojnë të punojë në periferi të qytetit për hapjen dhe zhbllokimin e kanaleve. Më pas kërkojnë ta poshtërojnë me të njëjtën punë, brenda në Durrës. Poeti rebel nuk përulet, largohet nga puna dhe e kthen në një studio të vogël barakën, çatinë e së cilës familja e tij e ndante me katër familje të tjera.

ZARFA, FJALORË, SUMBULLA E POEZI

"Babai dilte shumë pak nga shtëpia. Gjatë ditës prodhonte sumbulla dhe zarfa, të cilat më pas shiteshin në dyqanet e tregtarëve të vegjël". Kështu e kujton në një intervistë për ATSH-në Alfons Dovanën, e bija, Nirvana, e cila në atë kohë ishte vetëm 10 vjeç. Argjila që mblidhte në kodrat e Currilave thahej deri sa bëhej pluhur dhe me të përgatitej balta që hidhej në tabelën me format e ndryshme. Gjithçka bëhej gati në sobën dhe tavolinën e vetme në kuzhinë-dëshmon Nirvana, e cila ka ruajtur edhe disa nga sumbullat e përgatitura prej të atit më shumë se një gjysmë shekulli më parë. Qoshet e tyre qëroheshin me thikë dhe pastaj me ndihmën e nënës ato lyheshin me një bojë të veçantë, që u jepte shkëlqim. Kur paratë nuk mjaftonin gatiste edhe zarfa me ngjyra.

Kjo ishte puna që bënte gjatë ditës zotëria, që kishte studiuar për ekonomi, ndërsa kur binte mbrëmja Alfons Dovana harrohej pas poezisë dhe punës shkencore.

Në dimër, njërën dorë e mbante mbi borsën me ujë të ngrohtë, e shkruante me tjetrën-kujton qetësisht Nirvana tablonë e shtëpisë-barakë ku banuan për shumë vjet.

Alfons Dovana kishte studiuar në Liceun francez të Korçës e më pas edhe në gjimnazin e Janinës. Ishte i dashuruar me letërsinë franceze, të cilën ua lexonte shpesh fëmijëve, ashtu siç u lexonte edhe poezitë, që shkruante netëve të gjata, në shtëpinë në periferi të qytetit.

Në vitin 2003, 36 vjet pasi i ati i kishte mbyllur sytë Nirvana Dovana i ka botuar poezitë e të atit në dy vëllime me titullin "Hallka të shkëputura". Bashkë me lirikat që pasqyrojnë shpirtin e trazuar të poetit shquhen edhe përkthimet nga Alfred dë Vinji dhe Alfons dë Lamartin.

"Nuk kam pasur asnjë vështirësi për t'i mbledhur poezitë e babait-vijon rrëfimin e saj Nirvana. I kishte lënë të gjitha gati, në fletoret e tij me kapak blu, madje bashkë me kapitujt kishte caktuar edhe titullin e të dy vëllimeve".

"Rimari i gjuhës shqipe"

Vepra që pret të botohet

Në vitet 1950 Alfons Dovana ka përgatitur "Fjalorin e rimave" të gjuhës shqipe. Bashkë me zërat e parë të një "Fjalori mitologjik" është një punë titanike 10-vjeçare, ende e pabotuar.

Në korespondencën me ndërmarrjen shtetërore të botimeve "Naim Frashëri" kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, Dhimitër Shuteriqi, shkruante në atë kohë se "puna e bërë nga Alfons Dovana është një punë e durueshme dhe e zellshme, me kritere të shëndosha shkencore".



Më pas ai shton se "ky Rimar, i pari në vendin tonë, do të ishte një ndihmë e madhe për studiuesit e gjuhës dhe të poezisë shqiptare, si brenda dhe jashtë shtetit". Vetëm një muaj më parë, më 2 maj 1960 thuajse të njëjtin vlerësim jep për veprën edhe Dekani i fakultetit të histori-filologjisë, Androkli Kostallari.

"Të bie në sy larmia e rimave, gjë që dëshmon se autori ka hetuar dhe gjurmuar me durim një numër të madh fjalësh nga thesari leksikor i gjuhës sonë-nënvizon Kostallari, duke e rekomanduar veprën për botim, njëlloj siç bën edhe Shuteriqi në korrespondencën e tij zyrtare me shtëpinë botuese.

Opinionet e dy drejtuesve nuk kanë mjaftuar për ta kaluar veprën në rotativat e shtypshkronjës. E vetmja përgjigje e vagullt për autorin ishte justifikimi se letra mungonte dhe se ishte vendosur të botoheshin vetëm librat me një numër të kufizuar faqesh.

"Rimari" i Alfons Dovanës, i vetmi i këtij lloji i përgatitur në vendin tonë vazhdon të ruhet nga familjarët e tij.

Dy vëllime me 75 kapituj, dhe përkatësisht me 416 dhe 619 fletë të shkruara në makinë shkrimi para 60 vjetëve përbëjnë edhe një studim të poetëve shqiptarë të vjetër e të rinj.

"Fjalori i rimave të gjuhës shqipe" meriton të botohet për të mos mbetur si një relike e familjes.

» LIBRI

RRËFIME *nga ditari i Mandelës: jeta e një afrikani të fisit xhosa, i cili arratiset një ditë nga vendlindja e tij, sepse, ndërsa e përgatisnin për kryetar fisi, po e detyronin të martohej pa dëshirën e tij.*

Biografia e Mandelës botohet në gjuhën shqipe

Libri "Portret në foto e fjalë", ka dalë në dritën e botimit nga shtëpia Botuese 'Pegi'

DHURATA HAMZAI
TIRANE

Ikja nga kjo botë e Mandelës rikthen në kujtesën historike shembullin humanizmit, modestinë dhe fuqinë e këtij njeriu frymëzues. Libri i autorizuar nga vetë Nelson Mandela, "Portret në foto e fjalë", qëlloi të dilte në dritën e botimit në gjuhën shqipe ditën e vdekjes së tij nga shtëpia botuese "Pegi", e cila e kishte në proces botimi. Në këto ditë lamtumire, libri biografik e shton edhe më shumë kuriozitetin e lexuesit. "Portret në foto dhe fjalë" është përkthyer nga origjinali "A portrait in ëords and pictures" nga Anxhela Çikopano. Autor i biografisë është vetë Mandela, një afrikan i fisit xhosa, i cili arratiset një ditë nga vendlindja e tij, sepse ndërsa e përgatisnin për kryetar fisi, po e detyronin të martohej pa dëshirën e tij. Kjo ishte zanafilla e peripecive të një njeriu me ngjyrë, në kohën kur dallimet dhe padrejtësitë raciale ishin diskriminuese dhe atij i duheshin përpjekje të jashtëzakonshme për shkollim dhe punësim. Libri "Portret në foto e fjalë", skicon jetën e Mandelës nëpërmjet imazheve dhe citimeve të përzgjedhura me kujdes, shumica e të cilave janë marrë nga arkivi i tij personal. Ky portret me foto dhe fjalë na shpalos jetën dhe kurajën e pamasë të një individi të jashtëzakonshëm, jeta e të cilit ka aftësinë të na frymëzojë, të na prekë e të na motivojë. "Me një format tërheqës dhe të thjeshtë, ky libër ka për qëllim të na prezantojë Nelson Mandelën, nëpërmjet fjalëve të tij të mençura, imazheve goditëse të jetës dhe sendeve të tij personale, si edhe opinioneve të shumë të tjerëve, të marra nga burime të palexuara më parë", thotë botuesja e "Pegit", Loreta Bërhami. I nderuar nga gjithë bota për guximin e jashtëzakonshëm dhe forcën e tij morale, Nelson Mandela konsiderohet si simbol i shpresës dhe i mundësive të pajtimit. Jeta e tij ndikoi më shumë se çdokush tjetër në fitoren e idealeve të lirisë, të barazisë dhe të demokracisë në mbarë botën. "Jeta e Nelson Mandela-s është historia e njeriut që i bëri ballë cinizmit dhe dëshpërimit që aq shpesh mundojnë botën. Nga një i burgosur u bë njeri i lirë; nga një figurë luftëtare u bë një zë i apasionuar për pajtimin; nga udhëheqësi i një partie u bë presidenti i një vendi të tërë dhe i hapi rrugën demokracisë dhe zhvillimit. Ai ka bërë aq shumë për të ndryshuar vendin e tij, edhe botën, sa është e vështirë ta përfytyrosh historinë e këtyre dekadave të fundit pa të.", shprehet presidenti aktual i SHBA-ve Barack Obama.



Nelson Mandela (Rolihlahla Dalibhunga Mandela) (18 korrik 1918 - 5 dhjetor 2013) ishte President i Afrikës Jugore dhe Luftëtar i lirisë, i cili luftonte kundër shtypjes racore që u bëhej njerëzve me ngjyrë në Afrikë

Barack Obama "Jeta e Nelson Mandela-s është historia e njeriut që i bëri ballë cinizmit dhe dëshpërimit që aq shpesh mundojnë botën. Nga një i burgosur u bë njeri i lirë; nga një figurë luftëtare u bë një zë i apasionuar për pajtimin..."


Nelson Mandela në adoleshencë me veshjen karakterisite të fisit xhosa

NELSON MANDELA, NOBELISTI I PAQES

Nelson Mandela (Rolihlahla Dalibhunga Mandela) (18 korrik 1918 - 5 dhjetor 2013) ishte President i Afrikës Jugore dhe Luftëtar i lirisë, i cili luftonte kundër shtypjes racore që u bëhej njerëzve me ngjyrë në Afrikë, posaçërisht në Afrikën Jugore. Ai studioi juridikun. Shumë vite të jetës së tij ai i kaloi nëpër burgje. Fillimisht Mandela zgjodhi rrugën paqësore për qëllimet e tij dhe të shokëve të tij. Në vitin 1956 ai u akuzua për "tradhti të lartë" nga regjimi i atëhershëm, bashkë me 155 shokë të tjerë. Procesi zgjati deri me 1961 dhe të gjithë u liruan. Mbas lirimit a u bë lideri i grupit të armatosur së ANCs,Umkohnto we Sizëe. Në vitin 1962 ai u burgos dhe u dënua me 5 vjet heqje lirie. Në vitin 1964 ai u dënua me burg të përjetshëm, sepse kishte planifikuar luftë të armatosur. Në vitin 1985 atij iu afrua mundësia e lirimit, në qoftë se do të pranonte ndalimin e aktivitetit të armatosur, por ai refuzoi. Në vitin 1990 mbas një kampanje të ANC dhe presion ndërkombëtar ai u lirua pa kushte. Në vitin 1993 ai fitoi çmimin Nobel. Kurse në vitin 1994 ai u zgjodh në zgjedhje demokratike, President i Afrikës Jugore dhe me 9 maj ai u zgjodh si presidenti i parë i zi në këtë vend. Në vitin 1999 ai dha dorëheqje dhe ishte aktiv për organizata për drejta të njerëzve të ndryshme. Në vitin 2003 ai kritikoi shumë Toni Blair dhe Georg VV. Bush për intervenimin në Irak. Mandela vdiq pas një sëmundjeje të gjatë më 5 dhjetor 2013 në shtëpinë e tij në Johannesburg.

TOB mbrëmje gala

Të ftuar Kledi Kadiu, Agim Hushi, Eno Peçi

Mbrëmja gala "60 vjet skenë operistike shqiptare" vjen për publikun për të kremtuar 60-vjetorin e TKOB. Në këtë përvjetor artistët janë duke përgatitur pjesët më të mira të repertorit klasik ndër vite. Prej ditësh artistët janë duke zhvilluar provat, pasi në mbrëmjen e datës 17 dhjetor jepet shfaqja "60 vjet skenë operistike shqiptare". Në këtë shfaqje publiku do të ketë mundësinë të shijojë jo vetëm performancat artistike të artistëve më të njohur dhe të vlerësuar të skenës operistike shqiptare, por këtij festimi i bashkohen dhe artistët që jetojnë jashtë dhe kanë kohë që i kanë munguar skenës së TOB. Regjisor i shfaqjes është Nikolin Gurakuqi, skenograf Genc Shkodrani, dirigjentë të korit janë Dritan Lumshi dhe Suzana Turku. Në këtë mbrëmje gala do të interpretojnë solistët lirikë dhe të baletit, Kori dhe Trupa e Baletit, Orkestra Simfonike e TKOB, si dhe artistët e ftuar Frano Lufi, Agim Hushi, Eno Peçi, Kledi Kadiu. Programi i shfaqjes përmban arie, duete, korale dhe numra baleti nga repertori më i mirë botëror dhe shqiptar. Orkestrën do ta dirigjojnë Ermir Krantja dhe Edmond Doko. Regjisori Nikolin Gurakuqi shprehet se do të jetë një program i larmishëm. Kjo gala festive në kuadër të 60 vjetorit të TKOB, sjell në skenë të gjithë solistët, si Ylber Gjini, Armando Likaj, Sidrit Bejleri, Eva Golemi, Marjana Leka, Shpresa Beka, Eriona Gjyzeli, Dorina Selimaj, etj. Programi do të jetë me pjesë nga operat dhe baletet më të njohura që janë vënë në skenën e TOB për 60 vjet si "Berberi i Seviljes", "Toska", "Trovatore", "Skënderbeu", etj, apo dhe pjesë nga baletet si "Halili dhe Hajria", "Arrëthyesi", etj, etj.







Editorial

Paratë e spoteve duhet të kthehen: Janë të invalidëve

vijon nga faqja 1

...ka hapur 3 hetime kundër 3 ministrive: Çështjeve Sociale, Ministrisë së Mbrojtjes dhe asaj të Brendshme. Tre hetimet kryesore i përkasin të njëjtit krim: abuzime (të dyshuara) të bëra me reklamat shtetërore. Hetimi i parë u referohej rreth 600.000 eurove, të financuara nga ministria e Çështjeve Sociale për spote televizive dhe manifestime të bëra me rastin e festës së 1 Majit; hetimi i dytë për 1.2 milionë euro, të financuara nga ministria e Mbrojtjes në spote televizive për të reklamuar forcat e armatosura shqiptare. Dhe hetimi i tretë, për 3.1 milionë dollarë, të paguara nga Ministria e Brendshme nga 2010 deri në 2011 për prodhimin dhe transmetimin e spoteve televizive për liberalizimin e vizave në Bashkimin Europian.

Flasim për një shumë prej rreth 5 milionë dollarësh, të menaxhuara nga një agjenci e vetme publicitare që i ka shpërndarë pjesën më të madhe të buxhetit televizionit të vëllait të vet. Bëhet fjalë për 5 milionë dollarë, që sot i mungojnë arkës së një shteti, që ka nevojë për 18 milionë dollarë buxhet ekstra për t'ia dalë t'u paguajë pensionet invalidëve. Burime të mirëinformuara mediatike bëjnë të ditur se shuma e përfituar në mënyrë abuzive nga i njëjti grup mediatik pranë Berishës arrin pikërisht deri në 18 milionë dollarë.

Nuk është një rastësi, që skandalet e para të dala në sipërfaqe, mes një mali me skandale të tjera, kanë të bëjnë me marrëdhëniet e njerëzve të Berishës me mediat: pasi u kritikua për shumë vite si njeriu që persekutonte shtypin, Berisha kuptoi se më mirë ishte ta blinte. Sigurisht që jo të gjithë mediat pranuan dhe për ta u mbyllën të gjitha "rubinetat" financiare, që një qeveri mund të mbyllte. Për të tjerët, rubinetat u hapën përtej çdo kufiri, madje përtej ligjit.

Tani logjika është shumë e thjeshtë. Funksionarët e ministrive dhe dy ministra janë nën akuzë sepse paguan parà publike që nuk duheshin dhënë: Por, nëse janë fajtorë ata që paguan, janë fajtorë edhe ata që i kanë marrë këto parà.

Nuk besojmë se drejtësia vendoset duke arrestuar dhe, në fakt, askush nuk bën apel për pranga. Por drejtësia mund të vendoset vetëm duke dëmshpërblyer dëmin e bërë. Atëherë, ato parà, të marra për spote televizive, nëse janë marrë duke shkelur ligjin, duhet të kthehen. Ky është një parim elementar i së drejtës. Do të ishte një gabim i madh të dënohen politikanët vetëm sepse janë bërë ish-pushtetarë, por njëkohësisht t'u japësh imunitet botuesve vetëm sepse këta vazhdojnë të drejtojnë televizionet e tyre.

Nëse është e vërtetë ajo që Qeveria thotë, pra se arka e shtetit është bosh, nuk mjafton të pengojë abuzimet e reja, të përmirësojë kontrollet në dogana ose të bllokojë evazionin e ri fiskal për ta rimbushur. Duhet t'i kthehen taksapaguesve paratë që janë marrë duke shkelur ligjin ose duke përfituar nga privilegjet që gëzonin klanet qeverisëse. Kjo do të vlente si paralajmërim edhe për kë ka si qëllim të vjedhë sot: të ketë kujdes, se nëse do t'i takojë atij të kthejë paratë e marra padrejtësisht në kurriz të njerëzve. **(c.b.)**

Koment

Statusi: Thjesht një '5' nga Brukseli?



PROF.ASOC. **MIRELA BOGDANI***)

vijon nga faqja 1

...ne historine e krejt zgjerimeve te BE-se, refuzimi tri here i statusit një vendi aplikant përbën një rast paprecedent, ndërsa refuzimi për të katërtën herë do të ishte një "humiliation". Po ky s'është rasti i vetëm në rrugëtimin problematik të Shqipërisë drejt BE-së. Në fillim të procesit, në vitin 2000, Shqipëria renditej e treta, pas Maqedonisë dhe Kroacisë. Tani, 13 vjet më pas, Shqipëria rezulton diku nga parafundi, duke lënë pas vetëm Bosnjen dhe duke u kaluar dhe nga vendi që u bë shtet 5 vjet pas fillimit të procesit, Mali i Zi. Shqipërisë ju desh më shumë se çdo vendi tjetër të Ballkanit Perëndimor të nënshkruajë MSA-në (5 vjet). Procesi i ratifikimit zgjati gjithashtu më shumë se çdo vend tjetër, gati dy vjet e gjysëm. Shqipëria ishte nga vendet e vetme të grupimit (bashkë me Bosnjën) që ju rrëzua kërkesa për liberalizimin e vizave dhe ju dha vetëm herën e dytë.

Për t'u kthyer te statusi, nëse do të jepet, do të jetë vetëm çështje e dashamirësisë së BE-së, por aspak e përmbushjes së detyrimeve dhe plotësimit të "detyrave të shtëpisë". Kjo është dhe arsyeja pse disa vende të BE-së, me spikatshëm Hollanda, ku shumica e partive politike dhe 90% e opinionit publik kanë shfaqur objeksione ndaj dhënies së statusit Shqipërisë, kanë rezerva. Nga këto detyrime, po analizoj shkurt 5 kryesoret:

Shteti ligjor: Në Shqipëri nuk funksionon shteti ligjor, këtu akoma nuk kuptohet dhe zbatohet parimi bazë i një shteti ligjor që të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit, si pushtetari e politikani (pra njeriu me pushtet politik dhe ekonomik), ashtu dhe qytetari i thjeshtë pa pushtet.

Sistemi i drejtësisë: Vazhdon të jetë jo thjesht jo-profesional dhe i politizuar, por i mbërthyer nga korrupsioni. Pra, në vend që sistemi i drejtësisë të jetë "problem-solver" është kthyer vetë në një problem. Dhe ç'është më e keqja, korrupsionin në drejtësi nuk po e lufton, si duhet të ndodhe, shteti, por media. Gjyqtarët dhe prokurorët sot po i tremben gazetarisë investigative që po denoncon rastet e shumta dhe jo forcës së ligjit dhe shtetit.

Korrupsioni: Të gjithë jemi dëshmitarë të përhapjes së metastazave të kancerit të korrupsionit shqiptar në çdo fushë të jetës politike, ekonomike e sociale dhe njëkohësisht të dështimit të çdo qeverie në luftën ndaj tij. Ulja në rankim e Shqipërisë në raportin e Transparency International ishte një tjetër dëshmues i kësaj.

Krimi i organizuar: Mungesa e rezultateve konkrete në luftën ndaj komponenteve të tij si trafikimet, droga, kontrabanda dhe mbi të gjitha lidhja e politikës me krimin.

Administrata publike: Jo meritokratike dhe tërësisht e politizuar. Premtimi i PS në fushatë për shndërrimin e administratës në profesionale dhe spastrimin nga militantët nuk duhet të konsistojë vetëm në heqjen e një ushtrie militantësh dhe zëvendësimin me një ushtri tjetër. Sigurisht, është shpejt për të gjykuar për ecurinë në këtë fushë, por fatkeqësisht ka plot raste të konkurseve fiktive, punësimit të anëtarëve apo kontribuesve, gjë e spikatur kjo sidomos në atë pjesë të administratës që kontrollohet nga aleatja e PS në qeveri, LSI-ja.

Pra një analizë e shpejtë e këtyre detyrave apo kushteve kryesore tregon që Shqipëria nuk është gati për statusin. Por gjithsesi të gjithë urojmë ta marrë, për hir të së mirës së përgjithshme të vendit dhe popullit, duke shpresuar që këtë hap të Shqipërisë në rrugëtimin drejt BE-së politikanet dhe partitë në pushtet të mos e deklarojnë si arritje apo kredencial të vetin, po siç është në të vërtetë, një 5 nga Brukseli, sa për të kaluar klasën.

*) Pedagoge e politikave të BE dhe autore e librave mbi Shqipërinë dhe BE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në zbatim të ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", **Departamenti i Administratës Publike** shpall konkurimin për **1 vend** të lirë në pozicionin:

Përgjegjës në Sektorin e Përfaqësimit Ligjor në Drejtorinë Juridike, në **Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë**.
Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në Shërbimin Civil në përputhje me nenin 12 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 «Statusi i nëpunësit civil».

KËRKESA TË VEÇANTA PËR KANDIDATËT
- Të ketë mbaruar arsimin e lartë për Drejtësi (për nivelin e diplomave referojuni Udhëzimit nr. 4 dt. 17.02.2010)
- Të ketë jo më pak se 3-vjet eksperiencë pune në profesion
- Të zotërojë gjuhën angleze.
- Të përdorë programet bazë të punës në kompjuter
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup

Paga e pozicionit është në kategorinë III - a

Paraqitja e dokumenteve:
Kandidati duhet të paraqesë brenda **datës 15.01.2014 në Kutinë Postare Nr.1751,** këto dokumenta: kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të diplomës dhe librezës së notave, të librezës së punës, certifikatave të kualifikimit, dëshmive të gjuhëve të huaja dhe kompjuterit, vërtetimin e gjendjes gjyqësore si dhe të paktën një letër rekomandimi, një numër telefoni për tu kontaktuar si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit. (Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit).

KONKURIMI është i hapur për nëpunësit civil të të njëjtës klasë me procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë. Nëse vendi nuk plotësohet nga këta kandidatë, konkurimi zhvillohet me kandidatët jashtë Administratës Publike, sipas procedurave të shërbimit civil.

Pas verifikimit paraprak, **me datë 21.01.2014** në selinë e **Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë** si dhe në www.pad.gov.al, do të shpallet lista e konkurentëve, që do të vazhdojnë më tej konkurimin si dhe data kur do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista me gojë. Konkurimi do të bazohet në njohuri të përgjithshme mbi legjislacionin që rregullon fushën financiare, ligjin e buxhetit, kodin e procedurave administrative, Ligjin nr. 9131 dt. 08.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike", Ligji nr. 8503 dt. 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare" si dhe Ligji nr. 9367 dt. 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", Ligj nr.9049 dt. 10.4.2003 "Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë"

Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, rezultatet e verifikimit paraprak si dhe datat kur do të zhvillohen testimet, mund t'i gjeni në adresën e Web Site të Departamentit të Administratës Publike www.pad.gov.al.

ADRESA: BULEVARDI "DËSHMORËT E KOMBIT", TIRANË, SHQIPERI, KUTIA POSTARE NR. 1751 TEL/FAX: +355 4 251241, 235937 - WWW.PAD.GOV.AL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në zbatim të ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", **Departamenti i Administratës Publike** shpall konkurimin për **1 vend** të lirë në pozicionin:

Përgjegjës në Sektorin e Legjislacionit në Drejtorinë Juridike, në **Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë**.
Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në Shërbimin Civil në përputhje me nenin 12 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 «Statusi i nëpunësit civil».

KËRKESA TË VEÇANTA PËR KANDIDATËT
- Të ketë mbaruar arsimin e lartë për Drejtësi (për nivelin e diplomave referojuni Udhëzimit nr. 4 dt. 17.02.2010)
- Të ketë jo më pak se 3-vjet eksperiencë pune në profesion
- Të zotërojë gjuhën angleze.
- Të përdorë programet bazë të punës në kompjuter
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup

Paga e pozicionit është në kategorinë III - a

Paraqitja e dokumenteve:
Kandidati duhet të paraqesë brenda **datës 15.01.2014 në Kutinë Postare Nr.1751,** këto dokumenta: kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të diplomës dhe librezës së notave, të librezës së punës, certifikatave të kualifikimit, dëshmive të gjuhëve të huaja dhe kompjuterit, vërtetimin e gjendjes gjyqësore si dhe të paktën një letër rekomandimi, një numër telefoni për tu kontaktuar si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit. (Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit).

KONKURIMI është i hapur për nëpunësit civil të të njëjtës klasë me procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë. Nëse vendi nuk plotësohet nga këta kandidatë, konkurimi zhvillohet me kandidatët jashtë Administratës Publike, sipas procedurave të shërbimit civil.

Pas verifikimit paraprak, **me datë 21.01.2014** në selinë e **Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë** si dhe në www.pad.gov.al, do të shpallet lista e konkurentëve, që do të vazhdojnë më tej konkurimin si dhe data kur do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista me gojë. Konkurimi do të bazohet në njohuri të përgjithshme mbi legjislacionin që rregullon fushën financiare, ligjin e buxhetit, kodin e procedurave administrative, Ligjin nr. 9131 dt. 08.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike", Ligji nr. 8503 dt. 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare" si dhe Ligji nr. 9367 dt. 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", Ligj nr.9049 dt. 10.4.2003 "Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë"

Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, rezultatet e verifikimit paraprak si dhe datat kur do të zhvillohen testimet, mund t'i gjeni në adresën e Web Site të Departamentit të Administratës Publike www.pad.gov.al

ADRESA: BULEVARDI "DËSHMORËT E KOMBIT", TIRANË, SHQIPERI, KUTIA POSTARE NR. 1751 TEL/FAX: +355 4 251241, 235937 - WWW.PAD.GOV.AL

Satirë politike

(Pjesa e parë)

Në ç'përmasa e kemi sot krizën ekonomike?!



NGA **ARBEN DUKA**

vijon nga faqja 1

Të fshehësh sot krizën,
do qe akt idiot,
ndaj dhe qeveria,
duhet të na thotë.

Duhet të na thotë,
tani-sa s'është vonë,
a është futur vendi,
në një recesion?!

Deri tani kriza,
s'ka shënjë për t'u zbutur,
por s'e dimë-në gropë,
sa thellë jemi futur?!

E kuptojnë krizën,
dhe më psikopatët,
gjersa bëhet Lajm,
fondi për sakatët!

E kuptojnë krizën,
dhe më optimistët,
kur as dymijë lekë,
s'ka për pensionistët!

Dhe të kuptosh krizën,
s'duhet shumë talent,
them se që nga vjet,
e kemi prezent.

Dhe ato tri muaj,
që ndërroi pushteti,
e gjithë Shqipëria,
u bë kripë deti!

U mbush trup' i vendit,
me plagë e varixhe,
paratë u vodhën,
me thasë e valixhe.

Ta kuptosh sot krizën,
thashë-s'duhet talent,
ata që e sollën,
janë në Parlament!

Është në Parlament,
gjithë ajo hordhi,
që duhet t'i japi,
vendit llogari.

Të kapet për k...sh,
ai psikopat,
për të na treguar,
ku i çoi paratë?

Kemi vetëm rritje,
tetë vjet na the,
po paratë e rritjes,
tani ku i ke?!

Në ç'zgëqe e banka,
ato janë fshehur,
se kriza nuk vjen,
ashtu papandehur!

Nëse në tetë vite,
ke vetëm zhvillim,
duhet që të kishim,
shumë akumulim.

Nëse ka qënë rritja,
mender dyshifrore,
duhej që të kishim,
rezervë buxhetore!

Nëse ke gënjyer,
thjeshtë na e ke hedhur,
nëse s'ke gënjyer,
paratë i ke vjedhur!

S'erdhëm rastësisht,
tek ky çast kritik,
po këtu ka ndodhur,
krim ekonomik!

Kush një vend të tërë,
zhyt në varfëri,
duhet para ligjit,
të japë llogari.

Këtu kemi pasur,
një gjyq popullor,
dhe ai ju bë,
Salës në Qershor.

Gjyqi i Qershorit,
vlerë s'mund të ketë,
nëse tani s'bëhet,
gjyqi i vërtetë!

(Vijon nesër pjesa tjetër)

Poezi

Tek ty do të tretem...

(Sipas P.Elyar)

Po u bëre akull-do të bëhem zjarr,
të ftohtin mos vuaj,
po u bëre zjarr-do të bëhem akull,
zjarrin do ta shuaj.

Krahët po m'i preve-do të bëhem zog,
për të fluturuar,
dritën po ma zure-do të bëhem yll,
për të vezulluar.

Po ma mbylle zemrën-po më le të vetëm,
nën një rreze hëne,
po ma mbylle zemrën-do të bëhem çelës,
të hap zemrën tënde.

Po u bëre lumë-në dallgët e tua,
thellë do të zhytem,
nga kjo jetë e shkretë-tjetër gjë nuk dua,
veç tek ty të mbytem.

Po të zuri gjumi-në një errësirë,
po i mbylle sytë,
gjersa të më zgjohesh-për ty do të bëhem,
një endërr me dritë.

Po humbe në mjegull-do të bëhem rreze,
mjegullën do tret,
gjersa të më shfaqet -si yll në mëngjeze,
i ëmbli portret.

Po humbe në mjegull-unë do bëhem Diell,
që prapë të më shfaqesh,
në dimrin me borë-për ty do të çel,
tufa manushaqesh.

Nuk të ndahem kurrë-gjer në fund të jetës,
pas teje do mbetem,
do të bëhem ajër-do bëhem aromë,
tek ty do të tretem...

Shënim: *Për mendimet dhe sugjerimet që kini për këtë faqe mund të kontaktoni me mesazhe me numrat e telefonit* ***0696031369*** *&* ***0696546873*** *. Mendimet dhe sugjerimet tuaja do të vlerësohen nga autori*

VIPa dhe RRiPa

NGA **ARBEN DUKA**



Këshillit të Ministrave të BE-së

Sot ka Shqipëria,
të radhës provim,
nëse do na ftojnë,
për një integrim.

Po as sot pëlqimi,
nuk është unanim,
se për dreq Hollanda,
tek ne s'ka besim.

Se për dreq Hollanda,
tek ne s'ka besim,
dhe një shtet i vetëm,
çon në refuzim!

Dhe një shtet i vetëm,
të shuan çdo shpresë,
vite-dhe s'po bëhet,
ende kjo martesë.

Vite-dhe s'po bëhet,
ende kjo martesë,
gjithmonë-po të duash,
e gjen ndonjë pengesë.

Për ne u krijua,
sivjet goxha klimë,
pse s'na do Hollanda,
tamam nuk e dimë!

S'është se kjo ftesë,
na shton ndonjë pikë,
por është pikësëpari,
moment politik.

Po është pikësëpari,
moment politik,
për gjithë shoqërinë,
krejt psikologjik.

Nëse ky Këshill,
sot do na pranonte,
tranzicioni i gjatë,
këtu do mbaronte.

Nëse marrim "Jo-në",
një gjë dihet mirë,
këtu do të bëhet,
edhe më vështirë!

» KONCERTI

SUKSESI *Në dhjetor të 2014 , adhuruesit rusë të muzikës do të kenë kënaqësi ta dëgjojnë sërish*

Suksesi i Inva Mulës, në Rusinë e nënës së saj!

Sopranoja me famë botërore, emocione në Moskë

NGA FLORA NIKOLLA
TIRANE

Diva e muzikës, Inva Mula ka dhënë një koncert të jashtëzakonshëm në Moskë, (Rusi), duke u rikthyer me sukses në vendin e nënës së saj, Nina Mula, një nga sopranot më të njohura shqiptare, emrin e së cilës e mban sot, vajza e vogël, e artistes së madhe e cila këndon prej vitesh në sallat më të njohura të botës. Këtë herë Inva Mula, këndoi në një nga sallat me prestigjioze te Moskës, në sallën që mban emrin e dirigjentit të famshëm rus Svetllqnov, e shoqëruar nga Orkestra Kombëtare Fizarmonike e Rusisë nën drejtimin e maestro Vladimir Spivakov, ku ajo është duartrokitur nga një publik i zgjedhur që kish mbushur sallën. "Inva Mula, një artiste me një përvojë të jashtëzakonshme, me një bagazh të pasur operistik dhe me një zë të rrallë, interpretoi në skenën e Sallës së Madhe që mban emrin e dirigjentit të famshëm rus Svetllqnov në Shtëpinë Ndërkombëtare të Muzikës në Moskë , me maestro Vladimir Spevakov, Drejtues artistik dhe kryedirigjent i i Orkestrës Kombëtare Filarmonike të Rusisë e përbërë nga 100 muzikantë si dhe President i Shtëpisë Ndërkombëtare të Muzikës, një kompleks modern arkitektonik ", shkruante pas koncertit, Olga Kolpakova njohëse e mirë e shqipes e cila ka studiuar në Uiversitetin e Prishtinës. Në shkrimin e saj shkruar në gjuhën shqipe, Kolpakova, përkthyese e Kadaresë, përshkruan se, "salla e madhe ishte mbushur jo vetëm me publik rus që çmuan talentin e vërtetë të Inva Mulës, por dhe nga dashamirës të shumtë të Shqipërisë, përfaqësues të trupit diplomatik në Moskë, nga Ambasadori i Republikës së Shqipërisë ne Federatën Ruse, Sokol Gjoka, përfaqësues të Ambasadës Franceze, Italiane. Gjermane etj. Në sallë ishin të pranishëm dhe studentët që vazhdojnë shkollimin në Rusi por edhe shqiptarët me banim të përhershëm e të përkohshëm në Moskë". "Inva pati një sukses të jashtëzakonshëm. Duartrokitjet të shoqëruar me brohoritjet Bravo, vazhduan gjatë dhe pas çdo arie interpretuar nga Diva e muzikës. Ato vazhduan sidomos pas skenës nga akti i tretë i operës Lucia di Lammermur (Il Dolce suono) të Gaetano Doniceti , të njohur në interpretimin e Invës pas filmit të Luk Bessonit "Elementi i pestë si dhe aries së Margaritës nga opera Faust të Sharl Gunos", vijon artikullin e saj Olga Kolpakova, autore e shumë librave dhe artikujve shkencore, e cila ka punuar në ambasadën e Rusisë në Tiranë dhe aktualisht ka emisionin e saj në gjuhën shqipe në Radio Moska.



Kujtimet
Koncert i '97 pati, një jehonë te jashtëzakonshme, ndërkohë që u realizua ëndrra e vjeter e babait të saj, Avni Mula

Rikthimi
Inva, këndoi në një nga sallat me prestigjioze te Moskës, në sallën që mban emrin e dirigjentit të famshëm rus Svetllqnov

NË FOTO: Inva Mula

Koncerti

Zëri që u gdhend në memorien e rusëve

Duartrokitjet e brohoritjet janë shtuar kur Inva Mula këndoi në fund të koncertit, romancën e bukur të kompozitorit të famshëm rus Sergej Rahmaninov, " Këtu ndihem mirë" /Zdesj horosho/ në gjuhën ruse. Përqafime me maestro Vladimir Spevakov, puthje dore, përshëndetje të përzemërta me solistët e Orkestrës janë shoqëruar nga duartrokitje të gjata të publikut në sallë që u ngrit në këmbë gjatë kësaj mbrëmje për ti dhuruar shumë lule në fund të kësaj mbrëmje. "Kalova emocione të jashtëzakonshme të cilat do të më shoqërojnë



gjatë. Ishte një eksperiencë e mrekullueshme", shprehu sopranoja e njohur e cila vlerësoi bashkëpunimin me Orkestrën Kombetare Filarmonike të Rusisë e duartrokitur nga publiku, veçanërisht kur maestro Spivakov mori në duar violinën e tij Stradivari. Koncerti në Moskë i Inva Mulës ishte paralajmëruar prej kohësh. Afishet me portretin e Invës ishin vendosur në skaje të ndryshme të Moskës dhjetë milionëshe. Kanale të ndryshme të Radios dhe të Televizionit në rubrikat kulturore dhe muzikore lajmëruan për koncertin e këngëtares shqiptare. Por e prisnin Invën dhe miqtë e saj – muzikantë të shumtë rusë, ndër të cilët edhe violinisti e dirigjenti i mirënjohur Vladimir Spivakov me bashkëshorten e tij.

FTESA

Vladimir Spevakov, violinist e dirigjent i shquar, drejtues artistik i orkestrës së famshme "Virtuozet e Moskës" ishte i pari që e ftoi Inva Mulen në Rusi. Ishte dhjetor i vitit 1997 kur ajo këndoi në sallën e famshme të Konservatorit të Moskës i cili mban emrin e të madhit Pjoter Ilic Çajkovski. Inva Mula, e kujton shpesh këtë mbrëmje jo vetëm për arsye që në sallën e madhe u mblodh ajka politike dhe artistike e Moskës, nga çifti Elcin dhe anëtarët e qeverisë ruse e deri tek muzikantet e njohur rusë, por edhe për emocionet e veçanta që ajo provonte kur në radhën e parë shikonte fytyrat e prindërve të saj, Ninës dhe Avniut, artistë me diploma të shkëlqyera të Konservatorit Çajkovski. Dhe ai koncert pati një jehonë te jashtëzakonshme, ndërkohë që u realizua ëndrra e vjeter e babait të saj, Avni Mula, që shihte vajzën e tij në skenën e famshme të Konservatorit Çajkovski ku dikur kishte kënduar me një sukses të madh ai vetë. Suksesi i Inva Mulës, në Rusinë e nënës së saj , nuk përfundon këtu.. !!! Në dhjetor të 2014 , adhuruesit rusë të muzikës do të kenë kënaqësi ta dëgjojnë sërish zërin manitës të Inva Mules në Gala-Koncertin me rastin e inagurimit të godinës së re të teatrit te Helikon-Operas në Moskë me ftese të mikut të saj Dmitrij Bertman.

Kalendari Kulturor

Teatri Kombëtar i Komedisë

- Shfaqja "Lakuriq" me regji të Kastriot Çipit
- **Interpretojnë:** Julia Ilirjani, Pjerin Vlashi, Niada Sailiasi, etj
- Skenograf, Genc Shkodrani dhe kostumografe Edlira Qyshka
- Me datë 20, 21 dhe 22 dhjetor në Teatrin Kombëtar të Komedisë

Galeria Kombëtare e Arteve

- Çmimi "ONUFRI" në edicionin e XX-të, shpallë artistët finalisë të cilët do të marrin pjesë në ekspozitën me moton
- "Elozhe dyshimi" me kurator Claudio Cravero dhe Olson Lamaj.
- Të enjten 26 dhjetor në Galerinë Kombëtare të Arteve

Galeria Zenit

- Ekspozita "Intervista Difektoze"
- Aktori Artur Gorishti, kësaj rradhe vjen ndryshe për publikun. Ai do të prezantojë në ambjentet e galerisë se artit "Zenit" koleksionin e tij me piktura.
- Ekspozita do të jete e hapur nga datat 15-24 dhjetor 2013

Kinema Millenium

- Maratona e filmave në Kinema Millennium 12- 19 dhjetor
- Nëse shihni më shumë se 1 film brenda Javës Maratonë 12-19 dhjetor, bileta e 2-të kushton 50% më lirë.

- **Filmat dhe Oraret nga 12 Dhjetor:**
- 10.30 - Hunger Games: Catching Fire - 300 lekë
- 13.00 - 3D The Hobbit: The Desolation of Smaug- 500 lekë
- 15.30 - Femrat- 500 lekë
- 18.00 - Hunger Games: Catching Fire- 500 lekë
- 20.30 - The Counselor -500 lekë
- 22.30 - Hunger Games: Catching Fire - 500 lekë

KINEMA AGIMI

- -"The Hobbit:The Desolation of Smaug" 3D/ 12:00 / çmimi 500 leke
- -**"The Hunger** Games:Catching Fire" 2D/ 17:00 / 20:00 / çmimi 500 leke
- -"The Counselor" 2D/ 22:30 / çmimi 500 leke
- -"Frozen" 3D / 10:00 / 15:00 / çmimi 500 leke

PARADE FJALEKRYQESH

NGA KADRI VOKOPOLA

HOROSKOPI

Dashi

Ambienti yjor do favorizoje një komunikim shume te mire sot për jetën tuaj ne çift. Do i shprehni edhe me lirshëm ato qe ndjeni dhe me më tepër delikatese. Beqaret gjithashtu do ndihen me se miri gjate kësaj dite. takimet do jene te mrekullueshme dhe personat mjaft interesante. Financat do fillojnë pak nga pak te përmirësohen, kështu qe do jeni edhe me te qete.

Demi

Pozicionimi i mire i Jupiterit ne jetën tuaj ne çift do sjelle ekuilibër dhe harmoni. Askush nuk do mund te ndikoje tek lidhja juaj dhe ta destabilizoje atë. Beqaret do kenë shume sukses ne dashuri dhe do e gjejnë personin e përshtatshëm. Sektori i financave do jete përgjithësisht jo problematik. Merkuri do ju ndihmoje t'i menaxhoni me kujdes ato qe ardhura qe keni.

Binjakët

Nëse jeni ne një lidhje duhet t'i merrni gjerat me seriozisht sot. Mos vazhdoni te fshiheni nga te tjerët sikur keni bere ndonjë krim. Beqaret do kenë flirte dhe mundësi për dashuriçka kalimtare, asgjë me tepër sesa kaq. Duhet ende kohe për te takuar princin e kaltër. Te ardhurat fatmirësisht do fillojnë dalëngadalë te stabilizohen.

Gaforra

Çiftet qe kane shume kohe se bashku do ndihen te lumtur gjate kësaj dite. Askush dhe asgjë nuk do ua prishe dot atmosferën e ngrohte. Beqaret nga ana tjetër do jene mjaft melankolike dhe do qëndroni gjethe kohës duke menduar e reflektuar. Ne planin financiar duhet te bëni kujdes, sepse ndikimi i yjeve nuk do jete aspak pozitiv. Investimet lërini për me vone.

Luani

Merrini gjerat shtruar sot ne jetën tuaj ne çift dhe mos u mundoni te beni asgjë te jashtëzakonshme. Yjet nuk do i keni pas veten dhe gjithçka mund t'iu ndodhe. Beqaret nuk duhet te bëjnë gabimin te ngatërrojnë jetën sentimentale me atë profesionale. Me financat do keni vështirësi te shumta. Shmangni investimet dhe dhëniet e huave.

Virgjëresha

Dite shume konfuze kjo e sotmja për te dashuruarit. Do keni debate te njëpasnjëshme me atë qe keni ne krah dhe asgjë nuk do shkoje ashtu si ju e kishit menduar. Mos bëni gabimin te flisni me te për lidhjet qe keni pasur. Beqaret nuk duhet absolutisht te flirtojnë me koleget e punës. Ne planin financiar mos prisni qe situata te rregullohet fale lojërave te fatit.

Peshorja

Do i shihni gjerat me pesimizëm gjate kësaj dite dhe asgjë nuk do shkoje si e kishit menduar ne lidhjen tuaj. Debatet me partnerin do jene goxha te ashpra. Beqaret duhet te marrin kohen e duhur për ta njohur aq sa duhet personin qe do takojnë para se te heqin çdo hap. Ne planin financiar kontrolloni njëherë buxhetin para se te kryeni ndonjë shpenzim.

Akrepi

Dita pritet te jete e kënaqshme sot për te gjithë ata qe janë ne një lidhje. Do jeni me te dispozueshem ndaj partnerit dhe do bëni gjithçka qe atmosfera te qëndrojnë e ngrohte. Beqaret do ndihen mire ashtu si janë, prandaj nuk do tentojnë ta ndryshojnë jetën e tyre. Ne planin financiar do jeni goxha te tensionuar dhe mund te bëni gabime te renda.

Shigjetari

Nëse keni pakënaqësi ndaj partnerit tuaj mundohuni t'ia shprehni atij gjithçka sepse vetëm ne këtë mënyrë nuk do keni probleme me njeri-tjetrin. Beqaret do jene shume te pavendosur pe rate qe duan te bëjnë dhe nuk do i pranojnë ftesat qe do ju bëhen. Financat do jene ne një gjendje te qëndrueshme edhe pse shpenzimet qe do kryeni do jene te mëdha.

Bricjapi

Ju qe jeni ne çift, bëni kujdes nga Neptuni sot. Ai do ju nxite te mos keni besim ndaj partnerit dhe ta teproni me xhelozinë. Beni çmos qe te mos e humbni dialogun. Beqaret do jene me fat dhe mund te takojnë personin qe aq shume kane ëndërruar. Financat do jene mjaft te ekuilibruara. Ata qe janë treguar me te kujdesshëm mund te keni edhe përmirësime.

Ujori

Te dashuruarit do ndihen vetëm gjate kësaj dite dhe do e vuajnë pa mase këtë gjë. Mundohuni te flisni hapur me partnerin. Për beqaret gjerat do ndodhin si me magji sot. Përgatituni për ndryshime rrënjësore qe do ju sjellin emocione te papërshkrueshme. Sektori i financave do jete i mbrojtur gjate gjithë kohës. Mund te shpenzoni edhe pak me tepër dhe situata do jete e qëndrueshme.

Peshqit

Tension dhe debate do ketë ne jetën tuaj ne çift sot. Atmosfera do jete goxha e turbullt dhe asgjë nuk do shkoje ashtu si e kishit menduar. Kujdes! Beqaret do e gjejnë me ne fund partnerin ideal dhe di fillojnë një etape te re ne jetën e tyre. Financat do jene te mira. Nuk pritet asnjë problem ne këtë sektor kështu qe mund te kryeni edhe ndonjë shpenzim me tepër.

FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI **35** KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	

HORIZONTAL

1. Mbyll romanin.
-Një mund të jetë sheqeri.
-Eshtë klithmë.
2. Ishulli i Jules Verne.
-Luhen në teatër.
3. Ente Civile Italiane.
-Kaluar në krye.
-Pishtarë pa pishë.
4. Francesku kantautor.
-Ekstremet e ndeshjes.
-Eshtë... rrethinë.
5. Billy rockstar.
-Një garë me shumë disiplina.
6. Një ëmbëlsirë me qiri.
-Është makinë.
7. Kush ka... do të hajë.
-Ishte dikur një batalion.
8. Inicialet e Einstein.
-Thonë se kanë të gjithë një turi.
-Gjysma e inatit.
9. Kufijtë e rritjes.
-Qyteti i Robespierre.
-Thirrej Timonieri i Madh.
-Mbetenn në fund.
10. Të parat në sjellje.
-Çiftet e portës.
-Halili këngëtare.
11. Ka shtretër për derman një ti tillë.
-Ata të amerikës janë sioux.
12. Eshtë cilësi
-Claude, regjiosr francez.
-Qendër votimi.

VERTIKAL

1. Eshtë artistja që e ka hak... çmimin.
-Janë tek në suva.
2. Janë toreros mbi kuaj.
-Fillojnë një periudhë.
3. Shenjtori i Seviljes.
-Një pjesë e situatës.
4. Lidhet në skaje.
-Institucione Lokale Tiranë.
Eshtë mal i yni.
5. Organizta Ekonomike Korçë.
-Janë baballarët.
-Dy asa në dorë.
6. Par Prix në Formula 1.
-Flynn që qe aktor i famshëm.
7. Arturo i Brecht.
-Kanë dhëmbë të hekurta.
8. Janë në modë.
-Para park në një film të Steven Spielberg.
9. Ekstreme në këmbëz.
-Roland që qe koreograf.
-Ndodh në kufij.
10. Janë lagje segregacioni.
-Kthente në ar çdo gjë që prekte.
11. Qytet italian.
-Inicialet e Bergman regjisor.
12. Lind në ekstreme.
-Emri i Stravinskijt.
-Sharif aktor.
13. Në krye të armatës.
-Capello trainer.
-Koço dirigjent.
14. Eshtë gri ajo e trurit.
-Jacques që qe kantautor i famshëm.
15. Me magneti... në një firmë të njohur italiane
-Inicialet e Turgeniev.
16. Heather ish- showgirl.
-Rrjetë në tenis.
17. Në fund të fundit.
-Një pemë.
-Eshtë anë dollapi

M	I	L	A	N	I	N	T	E	R	■	C	A	D	D	I	E
E	T	I	M	O	L	O	G	U	■	B	I	R	A	■	N	D
M	A	R	O	N	I	T	E	■	P	A	L	A	M	E	D	I
O	■	A	N	D	R	E	■	D	E	L	E	G	A	T	E	T
R	T	■	A	A	E	■	M	A	L	E	S	O	R	E	T	■
I	R	I	S	■	■	M	O	N	O	T	O	N	E	■	■	K
A	I	■	R	O	■	D	R	I	T	A	R	E	T	■	P	R
■	U	F	O	■	S	■	G	E	A	■	E	S	■	P	R	A
A	M	I	■	V	I	R	A	L	■	■	■	■	P	O	E	T
■	F	E	N	O	M	E	N	E	T	■	P	I	E	R	R	E
M	A	R	A	T	O	N	A	■	M	I	N	I	S	T	E	R
A	L	I	M	A	N	I	■	S	A	R	T	R	E	■	S	I

Përgjigje e fjalëkryqit pa skemë

Sudoku

	9	4				7	8	
2		3	5		7	4		9
	7		9	4	2		6	
		9	6	7	5	2		
		7	8	3	1	5		
	4		7	1	8		5	
7		6	4		9	1		8
	5	8				9	4	

Përgjigje

5	2	4	9	7	3	1	8	6
8	1	3	5	4	6	9	2	7
9	6	7	8	1	2	3	4	5
2	3	1	6	5	8	7	9	4
7	5	9	4	3	1	8	6	2
6	4	8	7	2	9	5	3	1
3	8	5	2	6	7	4	1	9
1	7	2	3	9	4	6	5	8
4	9	6	1	8	5	2	7	3

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo rresht e kolonë të ketë numrat nga 1-9

FJALEKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

Përgjigje

L	O	J	A	■	T	A	M	■	B	A	R	K					
I	B	■	H	A	R	R	I	S	O	N	■	A					
N	■	H	A	M	E	S	D	J	E	T	■	N					
D	■	O	■	E	S	■	B	E	K	A	■	T					
J	A	Y	O	R	■	C	A	L	E	R	I	A					
A	P	E	L	■	■	A	S	L	■	E	J	T					
■	A	T	A	K	■	■	H	J	■	S	E	A					
M	R	■	E	A	K	T	■	A	G	■	T	■					
A	A	R	■	N	A	T	A	■	J	O	■	P					
U	T	A	■	E	M	I	L	I	O	■	A	L					
R	E	C	E	T	A	■	A	■	N	I	C	O					
O	T	A	■	■	T	U	N	D	I	M	E	T					


SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

6	4	12	2	3	1	7	■	■	1	8	2	12					
9	12	2	11	11	■	2	■	12	11	2	7	4					
■	8	■	12	4	2	12	4	11	■	12	2	7					
11	1	12	1	■	5	10	3	1	15	■	■	2					
11	2	12	■	5	10	3	4	6	1	7	2	12					
4	■	■	5	10	3	1	14	4	6	1	■	■					
9	9	9	■	16	10	7	2	12	2	11	4	12					
13H	2A	11R	7K	■	8	4	8	■	12	10	12	10					
1	17	1	■	6	1	■	12	■	■	8	2	11					
11	9	■	11	4	2	3	1	9	12	1	■	12					
2	1	10	■	12	■	10	■	10	13	■	3	2					
12	2	7	12	■	1	8	12	11	1	14	2	12					

FJALËKRYQI SPORTIV



			1	2			■	3		4	5	■	6	7	8	9	
			10			■	11		■	12		13					
				■	14	15		■	16	■	17						
			18	19				20		■	21			■	■	■	■
22	23		24	■	25						26				27	■	■
28		■	29	30													
31		■	32		■	33		■	34		■	■	■	■	■	■	■
35					36	■	37	38			39	40	41				
42		■	43			44	■	45		■	46						
	■	47					■		48				■				




HORIZONTAL

1. Dzeko bomber boshnjak.
3. Makina Uno.
6. Igli te Lazio.
10. Kaluar në krye.
11. Inicialet e Ribery.
12. Qyteti i Raptors në NBA.
14. Gjysma e afatit
17. Merret një nga kamerieri.
18. Gabriel te Parma.
21. Një pjesë e emisioneve.
22. Dovana ku luan Teuta.
25. Personazhi në foto.
28. Mbyllin krahun.
29. Personazhi në foto.
31. Kufizojnë mjetet.
32. Ekstreme në motel.
33. Fillojnë nazet.
34. Inicialet e Asimov.
35. Qyteti i Tomorit.
37. Ka shumë në një ndeshje dramatike.
42. Mbyllin një tender.
43. Lauda ish-pilot.
45. Fillojnë sefte.
46. Muhammnad i ringut.
47. Eshtë ndeshja e fundit.
48. Asllan... në pallation e sportit

VERTIKAL

1. Eshtë skuadra.

Përgjigje e fjalëkryqit sportiv



					G	A	R	Y	■	K			A	■	A	N	D
					O	R	A	■	R	O	M	■	R	E	N	Z	O
					■	L	■	S	H	A	H	I	S	T	E	T	■	R	O
					■	S	T	U	D	E	N	T	I	■	I	D	E	M
U	K	A	■	D	H	I	M	I	T	E	R	■	R	■	A	Z	A
M	A	L	L	I	■	■	■	■	■	■	■	■	B	E	L	■	A	R
A	N	D	R	E	A	P	I	R	L	O	■	■	O	D	■	■	■	■
■	A	O	■	M	J	■	■	E	■	F	A	R	■	■	■	■	■	■
O	L	■	■	■	R	Y	A	N	G	I	G	G	S	■	■	■	■	■
M	I	L	A	N	I	N	T	E	R	■	J	■	I	■	■	■	■	■

2. Fillojnë daljet.
3. Kufizojnë një faktor
4. Mbyllin portat.
5. Kryeqyteti i Kansas.
6. Luan derby me Juventus.
7. Pak anormalitet.
8. Teket e ritës.
9. Zanore heroi.
11. Terim trainer.
13. Abramovich padron i Chelsea.
14. Prost ish-pilot.
15. Janë vajza në... sport.
16. Qyteti i Žalgiris.
19. Hasmi pa kufij.
20. Një është Mirel Josa.
22. Një numër anglez.
23. Skuadra e Erick Thohir.
24. Një Tefik mbrojtës.
26. Johnny Depp.
27. I katërti në kapitull.
30. Rrakllí ish-bomber.
36. Pikat pa kufij.
38. Në fund të ndeshjes.
39. Inistitucione Autonome Sportive.
40. Tri të parat në olimpiadë.
41. Nisin nga kreu.
44. Inicialet e Lika trainer.

LAJME
nga bota

Kosovë, vështirësi për liberalizimin e vizave

Përfaqësues të partive politike dyshojnë nëse institucionet e Kosovës do të arrijnë të përmbushin detyrimet për liberalizimin e vizave dhe që ky proces të përmbyllet më 2014. Përveç ngecjeve, edhe kushtet e vëna nga Komisioni Evropian rrisin dyshimin se qytetarët e Kosovës shumë shpejt mund të lëvizin lirshëm në zonën Schengen. Integrimi i qëndrueshëm i personave të riatdhesuar, lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile me kod të sigurisë, lidhja elektronike e data-bazës së Agjencisë së Regjistrimit Civil me databazën e Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe trajnimi i Policisë Kufitare, janë disa nga rekomandimet e Misionit faktmbledhës të Komisionit Evropian për institucionet e vendit për përmbushjen e kritereve të dala nga udhërrëfyesi për liberalizim të vizave.

E majta evropiane kandidon Tsipras si kreun e KE

Kryetari i partisë më të madhe opozitare greke, SYRIZA, Aleksis Tsipras është zyrtarizuar si kandidati i partisë së të Majtës Europiane për postin e presidentit të Komisionit Europian, sipas vendimit që u mor dje në kongresin e së majtës evropiane. Vendimi për kandidimin e Tsiprasit u mor në kongresin e 4-t të së Majtës Europiane dhe në favor të tij votuan 84,1%. Pas zgjedhjes së tij, Tsipras theksoi se është koha për punë dhe luftë në një Europë të shpresës dhe solidaritetit. Tsipras vuri në dukje se në personin e tij përfaqësohet Greqia dhe Europa e Jugut, por u angazhua që kandidatura e tij do të jetë për gjithë qytetarët europianë.

Merkel prezanton qeverinë e re të Gjermanisë

Pasi social-demokratët vendosën t'i bashkoheshin kristian-demokrateve të Angela Merkel në koalicionin e madh, kancelarja gjermane shpalli emrat e qeverisë të cilët duhet të marrin aprovimin e presidentit të vendit. Udhëheqësi i SPD-së, Sigmar Gabriel foli për ndarjen e posteve ministrore dhe shpjegoi se do të jenë shtatë ministra të SPD-së, katër gra dhe tre burra, duke filluar nga Frank Valter Shtajnmajer, në postin e ministrit të Jashtëm. Vetë Sigmar do të mbajë postin e zv/kancelarit dhe superministrit të Ekonomisë dhe Energjitikës. Për herë të parë në historinë e Republikës Federale të Gjermanisë, pjesë e kabinetit është një grua me origjine turke, Ajdan Ozoguz, ministre e Shtetit për Migracionin



• Alba Malltezi
Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group

• Genc Kondi
Kryeredaktor

• Admirina Peçi,
Kryeredaktore e "Rilindasi"
Politika: Jakin Marena
Aktualitet: Elton Qyno

Sociale: Miranda Gjoni
Ekonomi: Ilir Sinanaj
Kulturë: Dhurata Hamzai
Sporti: Dylber Balla

Design: Altin Aliaj
Genti Manelli

Website: Suela Gera

Departamenti i Marketingut:
Vera Përleka
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Shpërndarja:
Spiro Meshini
cel: +355696088847
cel: +355696060418

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: A.K shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë